



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË



RAPORT VJETOR

Gjëndja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë Vitit 2013

Sektori i energjisë mban peshën kryesore në zhvillimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të një vendi. Ai influencon drejtpërdrejt në treguesit bazë të nivelit ekonomik dhe të mirqënies. Potencialet energjetike si një nga pasuritë më të mëdha të një vendi duhen shfrytëzuar në mënyrën më efçente të mundëshme për të marrë prej tyre produktin optimal. Ky sektor në vendin tonë përfaqësohet nga ai i energjisë elektrike dhe sektori i gazit natyror. Tregëtimi dhe konsumimi i këtyre produkteve mbështetur në rregulla të qarta e transparente, përfaqëson dhe objektivat e punës së Entit Rregullator të Energjisë.

Raporti që po paraqesim është një informacion i detajuar mbi gjëndjen e sektorit elektro energjetik, nivelin e shërbimeve të ofruara nga operatorët publik dhe privat në tregun e energjisë elektrike bazuar në të dhënat që ERE administron në kuadër të autoritetit të saj për, rregullimin dhe monitorimin e aktiviteteve që ushtrohen nga subjekte të licencuara në sektorin e energjisë .

Veprimtaria e Entit Rregullator të Energjisë gjatë vitit 2013 u lidh kryesisht me statusin juridik të kompanisë CEZ Shpërndarje sh.a. Po gjatë këtij viti u intensifikua më shumë angazhimi i rregullatorit në përgatitjen dhe përditesimin e bazës legislative rregullatore të tregut të gazit natyror në vendin tonë.

Këto kanë qënë dy drejtime bazë të punës së rregullatorit që lidhen si me zhvillimin e tregut të energjisë elektrike dhe gazit brenda vendit ashtu dhe pjesëmarrja në tregun rajonal të tyre.

Zhvillimet në sektorin e energjisë elektrike janë shoqëruar me hapa dhe procese të rëndësishme nga pikpamja e organizimit, menaxhimit dhe administrimit të tij.

ERE në zbatim të autoritetit ligjor ka ushtruar monitorim ndaj të licencuarve dhe veçanërisht ka monitoruar punën e kompanisë CEZ Shpërndarje për aktivitetin që ajo ushtron në sektorin e shpërndarjes së energjisë elektrike si një nga shërbimet bazë që kryhet tek konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë.

Nga këto monitorime rezultuan problematika të shumta dhe të ndryshme në lidhje me performancën e kompanisë dhe shërbimet që ajo duhej ti kryente në sasi dhe cilësi te konsumatorët e energjisë elektrike. U vu re një përkeqësim i rezultateve financiare të kompanisë, reduktim i ndjeshëm i investimeve për fuqizimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Në veçanti u vu re një përkeqësim i ndjeshëm i njerit prej treguesve më te rëndësishëm të aktivitetit të kompanisë që është treguesi i humbjeve të energjisë elektrike siç është rritja e ndjeshme e humbjeve joteknike.

Rrezultatet e kompanisë filluan të bien ndesh me kerkesat dhe kondicionet e paracaktuara gjatë procesit të privatizimit, të shprehura këto dhe në dokumentacionet përkatëse mbi bazën e të cilave u formalizua ky privatizim.

Në këto kushte, në ushtrim të autoritetit ligjor të saj ERE pasi analizoi situatën në të cilën ndodhej CEZ Shpërndarje (Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesi Publik me Pakicë) në datën 21 Janar 2013 mori vendimin për heqjen e licencës kompanisë CEZ Shpërndarje në aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë.

Nisur nga ky fakt kompania CEZ Shpërndarje në zbatim të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar u vendos në administrim të përkohshëm, status ky, në të cilën kompania vazhdon të qëndrojë edhe sot.

Në përputhje me këtë status në zbatim të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neni 18, ERE zhvilloi procedurat e përzgjedhjes së administratorit të kompanisë CEZ Shpërndarje sh.a.

Në vijim të këtij procesi ERE ushtroi monitorim të vazhdueshëm mbi shërbimet e kësaj kompanie duke u fokusuar në kontrollin e zgjidhjes së problemeve kryesore që çuan ndër të tjera në marrjen e vendimit për heqjen e licensave të aktivitetit të shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë.

Ndërprerjet kolektive, niveli i lartë i humbjeve në rrjet, arkëtimet e ulëta, mungesa e pagesave ndaj operatoreve publik KESH sh.a, OST sh.a dhe ndaj tregtarëve, sikurse dhe rritja e shpenzimeve të pajustificuara në dëm të gjëndjes financiare të kompanisë CEZ Shpërndarje shënuan problematikat kryesore të cilat ERE i evidentoi në monitorimet e kryera pranë kompanisë.

Gjatë vitit 2013 sikurse prezantohet më në detaj në këtë raport një pjesë e problematikave gjetën rrugën e zgjidhjes duke konkluduar në fund të vitit së pari me shmangien e ndërprerjeve kolektive të furnizimit me energji elektrike, frenimin e përkeqësimit të nivelit të humbjeve, rritjen e arkëtimeve, eliminimin e shërbimeve me të tretë (ku më shqetësues ishte arkëtimi i faturave të shitjes së energjisë elektrike përmes kompanive të tjera) dhe mbi të gjitha gjatë vitit 2013 u përmirësua dukshëm niveli i pagesave nga CEZ Shpërndarje për shërbimet e ofruara nga KESH sh.a, OST sh.a dhe Tregtarët e energjisë. Theksojmë se mospërmbushja e detyrimeve financiare nga

CEZ Shpërndarje sh.a të detyrimeve që lidhen me Furnizimin Publik me Shumicë (KESH sh.a) dhe Tregtarët bëri që gjatë vitit 2012 efektet negative të gjëndjes financiare të CEZ Shpërndarje sh.a të preknin edhe prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike. Nga ana tjetër në raport me Tregtarët e energjisë elektrike, përmirësimi i ndjeshëm i nivelit të pagesave çoi në rivendosjen e furnizimit me energji elektrike nga Tregtarët për nevoja të mbulimit të humbjeve në rrjet nga CEZ Shpërndarje sh.a

Gjithashtu gjatë vitit 2013 Enti Rregullator i Energjisë vijoi punën e tij në drejtim të rregullimit të aktiviteteve në sektor, mbrojtjes konsumatore, përmirësimin më tej të akteve nënligjore, trajtimit të aplikimeve të reja për licensim në aktivitetet e sektorit të energjisë elektrike etj.

Në sektorin e gazit natyror, ERE gjatë vitit 2013 ka realizuar procedurat që lidheshin me zhvillimin më tej të gazsjellësit TAP duke u bazuar në një bashkëpunim dhe harmonizim të procedurave me autoritetet rregullatore në sektorin e energjisë në Itali dhe Greqi .

Qëndrimet dhe vendimarrjet përkatëse kanë reflektuar në çdo rast qëllimin kryesor të ERE-s që është zbatimin e legjislacionit bazë si :

Ligjit nr.9072 datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar,

Ligjit nr. 9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”

Ligjit nr.138/2013 “Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme”

Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me VKM nr. 338, datë 19.03.2008, të ndryshuar.

Në analizë të karakteristikave, zhvillimeve dhe problematikave që shfaq sektori elektroenergjitik dhe ai i gazit natyror në vendin tonë, forcimi i kapaciteteve profesionale të ERE-s është një sfidë e rëndësishme e këtij institucioni më qëllim përmbushjen e detyrimeve sipas legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të veçantë në kuadër të implementimit të Paketës së Tretë të Energjisë miratuar nga Komisioni Europian. Kujtojmë se kjo e fundit bëhet e detyrueshme për zbatim duke filluar nga data 1 Janar 2015. Implementimi i Paketës së Tretë të Energjisë kërkon një angazhim të gjithë institucioneve politikëbërëse në vend dhe natyrisht një angazhim shumë të madh të Entit Rregullator të Energjisë i cili në këtë kuadër kërkohet të implementoj këtë paketë përmes miratimit apo përmirësimit të një sërë aktesh nënligjore të tillë si, Rregullat e

Tregut, Rregullat e Alokimit të Kapaciteve, Kodit të Transmetimit, Kodit të Shpërndarjes si dhe metodologjive të përcaktimit të tarifave dhe çmimeve të energjisë.

Në procesin e ristrukturimit dhe zhvillimit të tij, sektori i energjisë si ai i energjisë elektrike ashtu dhe ai i gazit janë përpara sfidash të mëdha dhe me përgjegjësi për të ardhmen e vendit.

Proçeset integrale si politike dhe ekonomike, në të cilat po kalon vendi ynë nuk mund të kuptohen pa një zhvillim të ndjeshëm e të qëndrueshëm të infrastrukturës energjetike të vendit.

Kryetari

Petrit Ahmeti

Përmbajtja e Lëndës

HYRJE.....	14
PJESA I	18
Kapitulli I	18
Rregullimi në Tregun e Energjisë Elektrike	18
1. Tregu i Energjisë Elektrike.....	19
2. Prodhimi i Energjisë Elektrike	22
2.1 Kapacitetet dhe Prodhimi i Energjisë Elektrike.....	22
2.2 Mbi Kriteret e Shfrytëzimit të Rezervës Hidroenergjetike në Kaskadën e Lumit Drin.....	28
2.3 Gjendja e TEC-it Vlorë	31
2.4 Prodhimi nga H/C Private/Koncesion të Energjisë Elektrike.....	32
2.5 Efiçenca e Prodhimit të Energjisë Elektrike	37
3. Transmetimi i Energjisë Elektrike.....	39
3.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit	39
3.1.1 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit.....	40
3.1.2 Veprimtaria e OST	42
4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes	50
4.1 Struktura e Sistemit të Shpërndarjes.....	50
4.2 Konsumi i Energjisë Elektrike	53
4.2.1 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike.....	56
4.2.2 Profili i Konsumit të Energjisë Elektrike	57
4.3 Importi i Energjisë Elektrike	58
4.4 Efiçenca e Tregtimit të Energjisë Elektrike.....	60
PJESA II	66
Kapitulli I	66

Rregullimi i Sektorit të Gazit Natyror	66
1. Prioritetet e ERE për Sektorin e Gazit Natyror gjatë vitit 2013.....	67
1.1 Projekti TAP, (Trans Adriatic Pipeline)	67
1.1.1 Disa nga Zhvillimet më të Rëndësishme në Lidhje me Projektin TAP gjatë vitit 2013.....	68
1.2 Miratimi i Metodologjise së Gazit.....	70
PJESA III	72
Kapitulli I	72
Aktiviteti i Entit Rregullator të Energjisë.....	72
1. Çmimet dhe Tarifat e Energjisë.....	73
1.1 Lënia në Fuqi e Tarifave Egzistuese deri në datë 31 Dhjetor 2013.	73
1.2 PVE dhe ndikimi tyre në Tarifën e Furnizuesit Publik me Shumicë.....	77
1.3 Çmimet dhe Tarifat e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit, viti 2013	80
Kapitulli II	82
Licensimi dhe Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike.....	82
1. Licensimet dhe Kërkesat për Kualifikim Impiantesh të Trajtuar gjatë vitit 2013	83
2. Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike.....	85
2.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike	85
2.1.1 Parimet e Monitormit të Tregut të Energjisë Elektrike.....	85
2.1.2 Monitorimi i KESH sh.a.....	88
2.1.3 Monitorimi i OST sh.a.....	91
2.1.4 Monitorimi i CEZ Shpërndarje sh.a	101
2.1.5 Monitorimi i Operatorëve të tjerë të Energjisë Elektrike	105
Kapitulli III	109
Aktiviteti i ERE në Zhvillimin e Legjislacionit Sekondar dhe Ndryshimet e tjera Ligjore të Ndodhura gjatë vitit 2013	109

1. Aktet nënligjore të Miratuara nga ERE	110
1.1 Miratimi i Rregullores “Mbi Proçedurat e Emërimit të Administratorit dhe Kompetencat e tij”	110
1.2 Miratimi i disa ndryshimeve në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike	111
1.3 Miratimi i Skedulimit të Pagesave të CEZ Shpërndarje sh.a (në Administrim të Përkohshëm).....	112
1.4 Ndryshimi i Rregullave dhe Proçedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Energjisë së Rinovueshme	112
1.5 Miratimi i Metodologjisë së Tarifave (Tap Tariff Code), të propozuar nga TAP AG, sipas Detyrimeve të Përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion”	113
1.6 Miratimi i Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit	114
2. Zhvillimet në legjislacionin primar në Sektorin e Energjisë Elektrike	114
2.1 Ligj Nr. 138/2013, “Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme”	114
3. Trajtimi i Proçeseve Gjyqësore	116
Kapitulli IV	119
Veprimtaria e ERE në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit	119
1. Trajtimin dhe Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve.	120
2. Informacioni në Faqen Zyrtare të Internetit	129
3. Marrëdhëniet me Publikun Median e Shkruar dhe Vizive	130
4. Komunikime me Pjesëtarët e Tregut	131
5. Seancat Dëgjimore	131
6. Treguesit e Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe Shitjes së Energjisë Elektrike	133
Kapitulli V	135
Marrëdhëniet Ndërinstitucionale dhe Ndërkombëtare të ERE-s	135
1. Veprimtaria Ndërinstitucionale dhe Ndërkombëtare e ERE-s	136
1.1 Marrëdhëniet e ERE-s me Kuvendin e Shqipërisë.....	136
1.2 Marrëdhëniet e ERE-s me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI).....	137
1.3 Marrëdhëniet e ERE-s me Ministrinë e Integritimit.....	137

1.4 Marrëdhëniet e ERE-s me Autoritetin e Konkurrencës	138
1.5 Marrëdhëniet e ERE-s me Avokatin e Popullit.....	138
2. Marrëdhëniet Ndërkombëtare	138
2.1 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare	139
2.2 Presidenca e ECRB-s në vitin 2013.....	140
2.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s.....	141
2.4 Pjesëmarrja në Konferenca dhe Aktivitete Ndërkombëtare	141
Kapitulli VI	143
Administrimi i Burimeve Financiare dhe Burimeve Njerëzore të ERE-s	143
1.Administrimi i Burimeve Financiare të ERE-s.....	145
PJESA IV	147
Kapitulli I	147
Raporti i Auditimit nga Eksperti Kontabël për Vitin 2013	147
Shtojca 1 Rregjistri i Vendimeve të ERE-s për Vitin 2013	156

Treguesi i Figurave

Figure 1 Struktura e Modelit Shqiptar të Tregut	20
Figure 2 Skema e Sistemi Elektroenergjitik	21
Figure 3 Prodhimi Energjisë Elektrike gjatë Vitit 2013	24
Figure 4 Krahasimi i Prodhimit Neto Vendas ne periudhën 2007-2013	25
Figure 5 Prodhimi i Energjisë Elektrike ne Shqipëri 1985 - 2013.	26
Figure 6 Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga H/C-et E Kaskadës së Drinit	28
Figure 7 Niveli i Liqenit te H/C Fierzes gjate vitit 2013 (m).....	29
Figure 8 Krahasimi i Nivelit të Liqenit të Fierzës me mesataren historike.....	30
Figure 9 Prurjet mujore ne liqenin e H/C Fierza gjate vitit 2013	30
Figure 10 Rezerva energjetike në Kaskadën e Drinit në fund të muajve 2011 dhe 2012	31
Figure 11 Ecuria e Prodhimit nga HEC-et e vegjël të dhënë me koncesion dhe private.....	35
Figure 12 Detyrimet e KESH.sh.a ndaj subjekteve Private për Energjinë Elektrike	36
Figure 13 Çmimet e blerjes së energjisë elektrike nga FPSH prej HEC-eve Private, me Koncesion dhe Koncesionet e reja	37
Figure 14 Shkarkimet e Ujit nga H/C-et e Kaskadës së Drinit (2002-2013).....	38
Figure 15 Konsumi i përgjithshëm në vite	53
Figure 16 Ngarkesa Orare 2013	55
Figure 17 Piku i Ngarkesës gjatë Muajve të Vitit 2013	56
Figure 18 Raportet e Faturimit sipas Kategorive	56
Figure 19 Peshat Specifike që zënë grupimet e konsumatorëve të energjisë elektrike	57
Figure 20 Balanca Imp/Eksp e energjisë elektrike në Vite (OST)	59
Figure 21 Ecuria e vlerës së Importit të Energjisë Elektrike 2002-2013	60
Figure 22 Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes 2007-2013	61
Figure 23 Niveli i Arkëtimeve Mujore 2012-2013.....	61
Figure 24 Ecuria e Gjëndjes Debitore	62
Figure 25 Efektiviteti Mujor i Shitjes.....	63
Figure 26 Humbjet Totale kundrejt Energjisë së Futur në Rrjet	64
Figure 27 Faturimi/Arkëtimi 2002-2012	64
Figure 28 Arkëtimi, Humbja dhe Mosarkëtimi Mesatar në % të Energjisë në Sistem	65
Figure 29 Struktura e Çmimit të Shitjes me Pakicë të Energjisë Elektrike aprovuar nga ERE.....	77
Figure 30 Ecuria e Prodhimit nga PVE dhe Ashta	78

Figure 31 Struktura e të Ardhurave të Realizuara në vitin 2013 nga PVE dhe HEC Ashta	79
Figure 32 Çmimet e Miratuara nga ERE për periudhën 2008-2014.....	80
Figure 33 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve jo familjarë në vendet e rajonit sipas raportimit me te fundit ERRA.....	81
Figure 34 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve familjarë në vendet e rajonit sipas raportimit me te fundit ERRA.....	81
Figure 35 Investimet në total, të realizuara nga KESH sh.a për periudhën Janar – Tetor 2013	89
Figure 36 Disbalancat brenda zones $\pm 4\%$	92
Figure 37 Disbalancat jashtë zonës $\pm 4\%$	93
Figure 38 Grafiku i të Ardhurave nga Ankandet 2013	96
Figure 39 Grafiku në përqindje sipas Drejtimit të Ankandëve 2013.....	96
Figure 40 Konsumi Mjor i Klientëve të Kualifikuar gjatë vitit 2012 deri shtator 2013.....	99
Figure 41 Statusi i Ankesave të trajtuara nga ERE	123
Figure 42 Grafiku i Trajtimit të Ankesave pranë CEZ Shpërndarje gjatë 2013.....	128

Treguesi i Tabelave

Table 1 Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik	22
Table 2 Të Dhënat e Përgjithëshme nga OST.....	23
Table 3 Derdhjet nga Hec-et të Kaskadës së Drinit.....	28
Table 4 Prodhimi nga H/C –et që kanë filluar prodhimin gjatë 2013	32
Table 5 Prodhimi i Energjise Elektrike nga Subjektet Private/Koncesion per vitin 2013	33
Table 6 Tregues të tregut të Energjisë.....	38
Table 7 Bilanci Energjitik i OST sh.a për vitin 2013 (GWh) dhe parashikimi 2014	43
Table 8 Te Ardhurat, Shpenzimet dhe Rezultati Financiar	44
Table 9 Konsumi për Faturat e Transmetimit për vitin 2013.....	45
Table 10 Tabela e të Ardhurave nga Furnizuesi i Kualifikuar (Tarifa e Transmetimit)	45
Table 11 Ndarja Administrative e Rrjetit të Shpërndarjes dhe Pesha Specifike në Konsumin e Energjisë Elektrike.....	50
Table 12 Të dhënat mbi Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes	51
Table 13 Tregues të Sintetizuar nga të tre Operatorët Kryesore të Sistemit Energjitik në Shqipëri	54
Table 14 Importi i Energjisë nga KESH dhe CEZ gjatë vitit 2013	58
Table 15 Faturim/Arkëtim dhe Ndryshimi i Gjëndjes Debitore gjatë vitit 2013	62
Table 16 Tarifat e Shërbimeve dhe të Shitjeve me Pakicë të Energjisë Elektrike 2012-2014 (sipas vendimit nr.148 date 7.12.2011).....	76
Table 17 Licensimet e Miratuara nga Bordi i Komisionerëve sipas Aktiviteteve të Ndryshme gjatë 2013	84
Table 18 Monitorimet gjatë Vitit 2013	85
Table 19 Realizimi i Investimeve Janar-Tetor 2013	89
Table 20 Investimet ne OST sh.a.....	91
Table 21 Disbalancat Positive dhe Negative të Pjesëmarrësve të Tregut për vitin 2013	92
Table 22 Penalizimet e Disbalancave Pozitive dhe Negative të Pjesëmarrësve të Tregut për vitin 2013	93
Table 23 Të dhënat e ankandit vjetor Qershor – Dhjetor 2013.....	95
Table 24 Të dhënat e ankandeve Vjetore dhe Mujore për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor 2013.....	95
Table 25 Konsumi i Klientëve të Kualifikuar në Raport me Konsumin e Përgjithshëm	99
Table 26 Totali i ankesave të paraqitura në ERE për vitin 2013	122
Table 27 Të dhëna Lidhur me Ankesat e Trajtuara prej Kompanisë CEZ Shpërndarje	127
Table 28 Informacion Lidhur me Gjenerimin e Burimit te Ankesave.....	128
Table 29 Detajimi i Kërkesave dhe Ankesave pranë CEZ Shpërndarje 2013.....	129
Table 30 Treguesit e Cilësisë së Vazhdueshmërisë së Furnizimit me Energji Elektrike 2013	133

Table 31 Treguesit e Cilësisë të Pasqyruar e Sintetizuar134

HYRJE

Sektori i energjisë elektrike dhe ai i gazit natyror në vendin tonë rregullohen në bazë të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Në bazë të këtyre ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore është përcaktuar autoriteti i ERE-s për trajtimin e aplikimeve për licensim, monitorimin e të licencuarve, mbrojtjen e konsumatorit, përcaktimin e tarifave në tregun e rregulluar të energjisë elektrike, miratimin e akteve nënligjore që lidhen me rregullimin e sektorit të energjisë.

Në bazë të Ligjit nr.9072 datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, ERE ka detyrimin që jo më vonë se data 31 Mars të raportoj ne Kuvend mbi gjëndjen e sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror si dhe aktivitetet e ERE-s për vitin paraardhës.

I. Struktura organizative e ERE-s

ERE ushtron përgjegjësitë e saj në zbatim të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjin nr.9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, përmes organit vendimarrës Bordit të Komisionerëve i cili ndihmohet në punën e tij nga nje staf teknik , staf mbështetës dhe specialist të jashtëm, struktura dhe organograma e të cilit është miratuar me Vendimi të Kuvendit Nr. 181 datë 05.05.2008.

II. Bordi i Komisionerëve

Bordi i Komisionerëve të ERE-s në bazë të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjit nr.9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar është organi vendimarrës për të gjitha çështjet nën juridiksionin dhe kompetencën e ERE-s. Bordi i Komisionerëve përbëhet nga Kryetari dhe 4 anëtarë, të cilët emërohen në detyrë nga Kuvendi i Shqipërisë me një mandat 5 vjeçar.

Gjatë vitit 2013 kanë ushtruar detyrën si antarë të Bordit të Komisionerëve:

Z. Sokol Ramadani	Kryetar
Zj. Entela Shehaj	Anëtare
Z. Adriatik Bego	Anëtar
Z. Shkelqim Bozgo	Anëtar
Z. Abaz Aliko	Anëtar

Mbas dorëheqjes së Z.Sokol Ramadani dhe të Z.Shkelqim Bozgo në detyrën e Kryetarit të Bordit u zgjodh Z.Petrit Ahmeti dhe në detyrën e anëtarit të Bordit për çështjet e gazit u zgjodh Z.Maksim Shuli.

Për qëllime të vendimmarrjeve në përputhje me autoritetin e dhënë sipas legjislacionit në fuqi Bordi i Komisionerëve zhvillon mbledhje formale, takime konsultative, si dhe seanca dëgjimore publike.

Gjatë vitit 2013, Bordi i Komisionerëve ka zhvilluar 53 mbledhje formale, në të cilat janë marrë 150 vendime. Në shtojcat e këtij raporti janë paraqitur vendimet e marra gjatë vitit 2013 me përjashtim të vendimeve që lidhen me funksionimin e brendshëm të ERE-s.

Për sa përcaktohet në legjislacionin në fuqi në këtë raport Bordi i Komisionerëve edhe për vitin 2013 është mbështetur në punën e tij nga këshilltari, dhe një personel teknik të organizuar në 4 drejtori si vijon:


- Drejtoria e Administrimit Financës dhe Burimeve Njerëzore me 8 punonjës.
- Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave të Energjisë Elektrike, me 5 punonjës.
- Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit, me 7 punonjës.
- Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me 5 punonjës.

Gjatë vitit 2013 është synuar forcimi i kapaciteteve administrative të ERE përmes kualifikimeve të ndryshme të mbështetura nga rregullatori dhe nga organizmat ndërkombëtare të tillë si:

- ERRA - Energy Regulators Regional Association
- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
- NARUC - National Association of Regulatory Utilities
- MEDREG - Mediterranean Energy Regulators
- E-Control - Energy Control Austria
- AEEG – Autorita per Energia Elettrica, il Gas ed i Servizi idrici in Italia

Marrëdhëniet e bashkëpunimit shkëmbimit të eksperiencave të ERE-s me këto institucione datojnë që në fillimet e punës së rregullatorit.

Organograma e ERE-s



PJESA I

Kapitulli I

Rregullimi në Tregun e Energjisë Elektrike

1. Tregu i Energjisë Elektrike

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.338 datë 19.03.2008 është miratuar Modeli Shqiptar i Tregut të Energjisë Elektrike (MSHTEE). Ky model veç të tjerash ka përcaktuar pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike (TEE), si dhe, rolin dhe përgjegjësitë e secilit pjesëmarrës në treg.

Për të adresuar dhe zgjidhur problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të këtij Vendimi si dhe në kuadër të harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me aktet e Bashkimit Europian, Modeli i Tregut gjatë viteve ka pësuar disa shtesa dhe ndryshime.

Në ndryshimet më të rëndësishme ligjore sa I takon TEE ishin: shtesat në ligjin nr.9072 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, ku u vendos që ti jepet statusi i “Klientit të kualifikuar” çdo konsumatori të energjisë elektrike, i lidhur në rrjetin e energjisë elektrike me tension 110 kV e sipër, si dhe çdo konsumatori tjetër të energjisë elektrike që, pavarësisht nivelit të tensionit të rrjetit në të cilin është lidhur, ka një konsum vjetor të energjisë elektrike më të madh se 50 milionë kwh”si dhe ndryshimet në Modelin e Tregut për sa i përket nivelit të lejuar të disbalancave nga pjesëmarrësit e tregut.

Nga ana tjetër këto ndryshime dhe shtesa nuk kanë ndryshuar strukturën bazë të funksionimit të këtij tregu si për efekt të flukseve të energjisë elektrike, marrëveshjeve të lidhjes në rrjet dhe të shërbimit të transmetimit përfshirë shërbimet ndihmëse, marrëveshjeve të furnizimit me energji elektrike dhe Fluksit të Fondeve.

Struktura e Tregut të Energjisë Elektrike dhe Skema e Sistemit elektroenergjitik skematikisht jepen në figurat e mëposhtëme.




Figure 1 Struktura e Modelit Shqiptar të Tregut

(Burimi ERE VKM nr.338 datë 19.03.2008 Shtojca C)

SKEMA E SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJITIK




Figure 2 Skema e Sistemi Elektroenergjitik

(Burimi ERE)

2. Prodhimi i Energjisë Elektrike

Në bazë të Ligjit nr.9072 datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, prodhimi i energjisë elektrike prej shoqërive prodhuese realizohet si një aktivitet i licensuar nga ERE. Shoqëria kryesore prodhuese është KESH sh.a, Shoqëria e vetme prodhuese me kapital tërësisht shtetëror. Numri më i madh i shoqërive prodhuese është i lidhur në rrjetin e shpërndarjes, dhe shoqëritë prodhuese me kapacitetin më të madh prodhues janë të lidhura në sistemin e transmetimit. Këto subjekte të licensuara në vite nga ERE shfrytëzojnë centralet egzistuese apo dhe të reja kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të koncesionit të nënshkruara me qeverinë Shqiptare dhe një pjesë e vogël shfrytëzojnë centrale deri në 2 MW të privatizuara në kuadër të Ligjit nr.8527, datë 23.09.1999. KESH sh.a shfrytëzon centrale ekzistuese.

2.1 Kapacitetet dhe Prodhimi i Energjisë Elektrike

Prodhimi publik i energjisë elektrike kryhet nga Shoqëria Aksionere KESH Sh.a. me 100% të aksioneve nga shteti si dhe nga Shoqëria "TEC-Vlora" gjithashtu me 100% të aksioneve nga shteti, e cila është pjesë e KESH sh.a.

Përbërja e parkut të centraleve të zotëruara nga KESH sh.a dhe fuqia e instaluar e secilit prej tyre të cilët realizojnë prodhimin publik është paraqitur në Tabelën -1-. Fuqia e përgjithshme e instaluar arrin në 1,531 MW, nga të cilat fuqia e instaluar e HEC-ve është 1,433 MW dhe e TEC-eve 98 MW.

Table 1 Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik

Karakter. e Centralit	Centrali								
	HEC Fierz	HEC Koman	HEC V.Dejes	HEC Ulez	HEC Shkopet	HEC Bistr1	HEC Bistr2	HEC Lana-breg	TEC Vlore
Nr.Agregat.	4	4	5	4	2	3	1	2	2
Fuqia e Ag. MW	125	150	50	6.3	12	7.7	5	2.5	70+28
Fuqia Instaluar e centralit MW	500	600	250	25	24	24	5	5	98
Fuqia Totale MW	1,531								

(Burimi KESH sh.a.)

Duke marrë parasysh edhe fuqinë e përgjithshme të instaluar të prodhuesve privatë të energjisë elektrike prej 347 MW, fuqia e përgjithshme e instaluar në vendin tonë rezulton 1 878 MW. Në këtë vlerësim nuk është marrë në konsideratë TEC-i i Fierit, mbasi ai është hequr nga shfrytëzimi që në vitin 2008. Prodhimi publik i energjisë elektrike në vitin 2013 u realizua 100% nga centralet hidroelektrike (HEC-et).

Në tabelën -2- jepen të dhëna të përgjithshme të prodhimit, shkëmbimeve dhe energjisë elektrike të blerë për nevoja të vendit të matura nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

Gjithashtu jepen disa parametra kryesore të HEC- eve të kaskadës së Drinit.

Table 2 Të Dhënat e Përgjithëshme nga OST

TE DHENA TE OST sha 2013													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	2013
Prodhimi total	672,348	555,249	693,302	845,430	886,840	700,026	461,964	412,410	327,430	359,492	385,365	519,558	6,819,414
prodhimi me HEC-e	672,348	555,249	693,302	845,430	886,840	700,026	461,964	412,410	327,430	359,492	385,365	519,558	6,819,414
prodhimi me TEC-e	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shkëmbimi në MWh	-107,928	-144,734	-15,698	266,868	330,752	132,177	-147,907	-199,254	-220,571	-223,012	-255,020	-297,978	-882,305
Programi ditor i shkëmbimit	-107,195	-145,076	-21,964	258,783	333,219	131,533	-147,898	-200,637	-222,761	-217,378	-253,893	-295,027	-888,294
gsa+atel+gen+rdn+ezpd+ret	-73,604	-24,480	-90,779	48,846	93,742	-16,875	-90,798	-32,400	-50,640	-75,000	-57,580	-51,620	-421,188
me EFT	-9,004	-60,984	11,274	167,760	182,928	106,700	-36,096	-148,801	-130,560	-106,473	-142,080	-166,060	-331,396
KEK	-15,556	-17,565	57,792	0	0	0	-20,951	-5,117	-19,730	-5,556	-5,231	-5,550	-37,464
EGL+ylliad	-9,031	-42,047	-251	42,177	56,549	28,337	80	145	6,512	0	-20,871	-2,976	58,624
htso+gen+mn+ex	0	0	0	0	0	13,371	-133	-14,464	-28,343	-30,349	-28,131	-68,821	-156,870
Nevoja vendi (prodh+shkëmb)	780,276	699,983	709,000	578,562	556,088	567,849	609,871	611,664	548,001	582,504	640,385	817,536	7,701,719
Piku i ngarkesës MWh	1,385	1,389	1,293	1,116	1,001	1,028	1,038	1,079	1,034	1,090	1,204	1,455	1,455

Gjatë vitit 2013 prodhimi i përgjithshëm neto i energjisë elektrike është si me poshtë.

$$\text{Totali 2013} = 6\,956 \text{ GWh}$$





Figure 3 Prodhimi Energjisë Elektrike gjatë Vitit 2013





Figure 4 Krahasimi i Prodhimit Neto Vendas ne periudhën 2007-2013

(Burimi OST)

Siç duket dhe nga grafikët e mësipërm, në analizë të historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, viti 2013 ka shënuar një prodhim të energjisë elektrike nga burimet vendase

mbi nivelin mesatar. Po ashtu vlerësohet edhe shkalla e sigurisë nga pikpamja hidrologjike.

Prodhimi maksimal mujor për vitin 2013, është shënuar në muajin Prill me 881 405 MWh. Ky prodhim i larte është realizuar nga hidrocentralet në administrim të KESH sh.a.

Prodhimi mujor minimal gjatë vitit 2013 është realizuar në muajin Shtator me 306 877 MWh.

Në grafikun e figurës -5- është paraqitur prodhimi i energjisë elektrike në vendin tonë gjatë periudhës 1985 deri në 2013. Sikurse vihet re nga krahasimi me rezultatet e prodhimit neto vendas të treguar më lart, prodhimi për vitin 2013 është 6 956 GWh pra një prodhim mbi mesataren shumë vjeçare.





Figure 5 Prodhimi i Energjisë Elektrike ne Shqipëri 1985 - 2013.

(Burimi KESH,OST)

Për periudhën 2007-2013, ERE nga administrimi i të dhënave nga Operatorët publik ka evidentuar në mënyrë të detajuar të dhënat e prodhimit të energjisë elektrike për çdo ditë të secilit vit. Nga krahasimi i prodhimit të energjisë elektrike gjatë periudhës 2007 – 2013 vërehen diferenca jashtëzakonisht të mëdha. Prodhimi më i ulët vjetor gjatë kësaj periudhe është ai i vitit 2007 me 2,918 milion kWh ose me një prodhim mesatar ditor prej 7.9 milion kWh. Ndërsa prodhimi më i madh vjetor mbetet ai i vitit 2010 me 7,743.295

milion kWh ose me një prodhim mesatar ditor prej 21.2 milion kWh. Sikurse vihet re diferenca ndërmjet këtyre dy prodhimeve ekstreme arrin në 2.7 herë. Një tregues i tillë shpreh në mënyrë sinjifikative shkallën e lartë të riskut hidrologjik në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga sistemet elektroenergjetike të mbështetur vetëm në HEC-e.

Në tabelën -3- janë paraqitur sasitë e prodhuara nga secili hidrocentral, kurse në figurën -6- janë paraqitur grafikisht këto parametra për H/C-et e Kaskadës së Drinit.






Figure 6 Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga H/C-et E Kaskadës së Drinit

Në punën e hidrocentraleve evidentohet gadishmëri e lartë e të gjithë agregateve të centraleve. Është me rëndësi të theksohet se në sajë të kësaj gadishmërie është bërë e mundur që të derdhen vetëm sasi të vogla uji nga portat e centraleve pa ju marrë më parë energjia. Këto derdhje rezultojnë të kenë qenë të paevitueshme dhe janë kryer për ruajtjen e parametrave të sigurisë së digave.

Table 3 Derdhjet nga Hec-et të Kaskadës së Drinit

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershori	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	2013
Fierze derdhje (milion m3)	0	0	0	118	17	6	0	0	0	0	0	0	141
Koman derdhje (milion m3)	0	0	281	778	369	74	0	0	0	0	0	0	1,502
Vau Dejesderdhje (milion m3)	0	0	553	559	232	67	0	0	0	0	0	0	1,411
Ulez derdhje (milion m3)	90	21	250	133	32	13	0	0	0	0	0	0	538

2.2 Mbi Kriteret e Shfrytëzimit të Rezervës Hidroenergjetike në Kaskadën e Lumit Drin

Sikurse dihet baseni i HEC-it të Fierzës është një central me rregullim vjetor të prurjeve, çka ndikon drejtpërsëdrejti dhe në shfrytëzimin e HEC-eve të Komanit dhe të Vaut të Dejës të cilët furnizohen kryesisht me ujë nga prurjet e rregulluara të HEC-it të Fierzës.

Në figurat -7- dhe -8- është paraqitur grafikisht për çdo muaj të vitit 2013 niveli i ujit në metra, në rezervuarin e Fierzës dhe për krahasim edhe nivelet mesatare historike mujore të ujit për vitet 1991– 2013.

Në figurën -9- paraqiten Prurjet 2013 në Liqenin e Fierzës krahasuar me Prurjet mesatare historike.




Figure 7 Niveli i Liqenit te H/C Fierzes gjate vitit 2013 (m)




Figure 8 Krahasimi i Nivelit të Liqenit të Fierzës me mesataren historike




Figure 9 Prurjet mujore ne liqenin e H/C Fierza gjate vitit 2013

(Burimi OST sh.a)

Në grafikun e figurës -10- është paraqitur shfrytëzimi i rezervës hidroenergjetike gjatë vitit 2013.

Kriteret e përpunimit të rezervës hidroenergjetike janë pothuajse analoge edhe në vitet paraardhëse, ato janë mbështetur në tre parimet themelore të Rregullores së Shfrytëzimit të Digave, të cilat konsistojnë:

- Respektimin e kushteve të sigurisë së digave.
- Shfrytëzimin optimal të rezervës hidroenergjetike.
- Minimizimin e efekteve të përmbytjes




Figure 10 Rezerva energjetike në Kaskadën e Drinit në fund të muajve 2011 dhe 2012

(Burimi OST sh.a)

2.3 Gjendja e TEC-it Vlorë

Gjate vitit 2013 nuk është prodhuar energji elektrike nga TEC Vlora. Ky TEC ishte parashikuar të vihej në punë gjatë vitit 2011, por për shkak të problemeve teknike të konstatuara gjatë testimeve u vonua futja në punë i këtij burimi.

2.4 Prodhimi nga H/C Private/Koncesion të Energjisë Elektrike

Prodhimi dhe kapacitetet e H/C-eve Private dhe me Koncesion janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën -5-. Gjatë vitit 2013 kanë prodhuar energji elektrike 80 centrale hidrike , me fuqi të përgjithshme të instaluar prej rreth 240 MW nga të cilat rreth 44 MW përbëjnë H/C që kanë filluar prodhimin gjatë vitit 2013. Prodhimi i përgjithshëm për vitin 2013 nga gjeneruesit privatë/koncesion ishte 759 GWh ose 11.1 % e prodhimit të përgjithshëm neto vendas të vitit 2013.

Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2013 kemi edhe shkëputjen e H/C–eve Ulez, Shkopet dhe Bistrice 1, 2 nga prodhuesi publik KESH sh.a. Gjatë gjashtëmujorit të dytë këto HEC-e janë administruar nga Kurum International sh.a dhe kanë realizuar një prodhim prej 126 GWh nën administrimin e shoqërisë Kurum International.

Në tabelën -4- është paraqitur prodhimi vjetor i energjisë elektrike i hec-eve që kanë hyrë në prodhim në vitin 2013.

Table 4 Prodhimi nga H/C –et që kanë filluar prodhimin gjatë 2013

HIDROCENTRALE PRIVATE/KONCESION QE KANE HYRE NE PRODHIM GIJATE VITIT 2013															
	KAPACITET (MW)	Tensioni lidhjes	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	2013
HEC Pobreg	2.00	35kV						4,601	1,525	259	976	2,332	1,891	2,104	13,687
HEC Koka 1	2.10	35kV						3,556	135	121	214	195	259	243	4,723
HEC-et Bele 1, 2 (Kukës)	30.70	110kV			8	1,458	5,622	6,852	3,986	341	1,599	4,834	5,063	5,574	35,336
HEC Kaskada Cerruje	12.60	110kV				284	1,712	561	(4)	(3)	313	341	218	223	3,645
HEC Rrapuni	4.00	110kV						56	580	471	1,343	2,912	2,782	2,394	10,538
HEC Lurë (Dibër)	0.75	10kV					130	283	93	0	149	0	47	84	785
HEC Mollaj (Korçë)	0.32	10kV				338	67	0	0	0	49	0	34	160	648
HEC Kryezi	1.20	10kV				565	256	250	0	0	0	246	236	166	1,720
HEC Mguil	0.40	10kV						55	0	0	0	156	0	152	364
Gjanci (Korçë)	2.96	35 kV		600	1,210	1,840	1,043	744	951	1,696	1,159	0	0	1,348	10,591
HEC Tuçep (Bulqizë)	0.40	10kV						57	41	0	73	89	97	97	454

Table 5 Prodhimi i Energjise Elektrike nga Subjektet Private/Koncesion per vitin 2013

HIDRO CENTRALET PRIVATE/KONCESION 2013					
	Centrali	Kapaciteti Kw	Prodhimi MWh 2013	Shoqeria	
Kane hyre ne pune deri ne dhjetor 2011					
1	HC Lenie 400 kW	400	2,832	EMIKEL 2003 sh.p.k	
2	HC Çorovode 200 kW	200	842		
3	HC Smokthine 9,2 MW	9,200	36,295	Albania Green Energy sh.p.k	
4	Bulqize, Bulqize 600 Kw	600	1,666	Balkan green energy shpk	
5	Homesh, Bulqize 330kw	330	723		
6	Zerqan, Bulqize 630kw	630	1,443		
7	Arras, Diber 4800	4,800	14,640		
8	Orgjost, Kukes 1200	1,200	4,251		
9	Lekbibaj, Tropoje 1400kw	1,400	5,953		
10	Dukagjin, Shkoder 640kw	640	1,820		
11	Marjan, Korce 200kw	200	433		
12	Lozhan, Korce 100kw	100	321		
13	Barmash, Kolonje 630kw	630	1,523		
14	Treske 2, Korce 250kw	250	708		
15	Nikolice, Korce 700	700	1,827		
16	Funarras, Librazhd 1920kw	1,920	6,726		
17	Lunik, Librazhd 200kw	200	1,225		
18	Kerpice, Gramsh 420kw	420	1,012		
19	Ujanik, Skrapar 630kw	630	1,612		
20	Borsh, Sarande 250kw	250	1,063		
21	Leshnice, Sarande 380kw	380	243		
22	Velcan, Korce 1200kw	1,200	2,804		
23	Muhur, Diber 250kw	250	1,041		
24	Rajan, Kolonje 1020kw	1,020	2,775		
25	HC Bogove 2500 kW	2,500	9,904		Wonder power sha
26	HC Xhyre 250 kW	250	2,315		Amal sh.p.k
27	HEC Stranik 1.6 MW	1,600	13,678		Hidroinvest 1 shpk
28	HEC Zall Tore 2.6 MW	2,600			
29	HEC Cernaleve 2.95 MW	2,950	15,272	Hidro Albania Energy	
30	HEC Bishnica II 2.5 MW	2,500	11,336	HEC Bishnica II 2.5 MW	
31	Dishnice 0.2 MW	200	607	"Dishnica Energy" shpk	
32	Lubonje 0.3 Mw	300	503	Elektro Lubonje" shpk	
33	Hec Labinot –Mal –Elbasan 0.25 MW	250	311	"Ansara Koncesion" shpk	
34	Hec FAQE KUQ 1 dhe 2 me fuqi 3 MW dhe 3.4 MW	6,400	19,376	HP OSTROVICA	
35	Hec Gizavesh	500	2,135	Dosku-Energy shpk	
36	Hec"Carshove" me fuqi 1.5 Mw	1,500	3,226	ERMA MP	
37	Hec"Picar 1" me fuqi 0,2 MW	200	740	Peshku Picar 1	
38	Hec"Qafezeze" me fuqi 0,4 MW	400	1,460	Caushi Energji	
39	Hec"TUCEP 2" me fuqi 1,7 MW	1,700	0	DUKA T2	
40	HC Shpelle 117 kW	117	1,183	sarolli sh.p.k	
41	HC Rehove 100 kW	100	0	Projeksion Energji sh.a.	
42	HC Treska 1 130 kW	130	0		
43	HC Bicaj 3,1 MW	3,100	107	EN-KU	
44	HC Leskovik1 1072 kW	1,072		maksi Elektrik sh.p.k	
45	HC Leskovik2 1100 kW	1,100	1,128		
46	HC Orenjë 75 kW	75	517	Juana sh.p.k	
47	HC Tamarë 150 kW	150	947	WTS Energji shpk	
48	HC Benë 125 kW	125	1,470	Marjakaj shpk	
49	HC Vithkuq 2115 kW	2,115	12,766	Favina 1 shpk	
50	HEC Selce 400 kW	400	2,275	Selca Energji shpk	
51	HC Sasaj 7MW	7,000	27,821	Energo – Sas shpk	
52	Tervol Librazhd 10.6 MW	10,600	39,782	HEC Tervoli shpk	
TOTAL		77,484	262,637		

Kane hyre ne pune gjate 2012

1	HEC Ashta 45 MW	45,000	211,190	Energji Ashta shpk
2	HEC Sllabinje 13,8 MW	13,800	37,654	Power Elektrik Sllabinje shpk
3	Hec Dardhe 5,8 MW	5,800	15,764	"Wenerg " shpk
4	Hec Peshke 3.43 MW	3,430	11,980	"Koka & Ergi Energy Peshk" shpk
5	Hec –Klos me fuqi 2.6 Mw	2,600	4,457	Malido Energy
6	Hec – Belesova 1 me fuqi 0.150 MW	150	249	"Korkis 2009" shpk
7	Hec- Selisht me fuqi 2 MW	2,000	2,886	Selisht
8	Hec"Martanesh" me fuqi 10,5 MW	10,500	12,479	Albanian Power
9	Hec"Verba 1" me fuqi 2 MW	2,000	5,404	Hydro power Plant Of Korca
10	Hec"FTerra" me fuqi 1,08 MW	1,080	13,842	Hidro Borshi
11	Hec"FTerra 2" me fuqi 2 MW	2,000		
12	Hec"Llapaj" me fuqi 13,62 MW	13,620	43,179	Gjo.Spa.POWER
13	Hec"Lura 1" me fuqi 6,54 MW	6,540	53,296	Erdat Lura
14	Hec"Lura 2" me fuqi 4,02 MW	4,020		
15	Hec"Lura 3" me fuqi 5,66 MW	5,660		
16	Hec" Kumbull- Merkurth" me fuqi 0.83 Mw	830	1,822	DN& NAT Energy
TOTAL		119,030	414,201	

Kane hyre ne pune gjate 2013				
1	Lure, Diber 750kw	750	785	Balkan Green Energy
2	HC Gjanç 3700 kW	3,700	10,591	Spahiu Gjanç sh.p.k.
3	HEC Rapuni I 4 MW	4,000	10,538	C & S Construction Energy shpk
4	Hec Pobreg 9 MW	12,300	13,687	"Energy Plus" shpk
5	Hec –Cerunje1 me fuqi 2.3 MW;	2,300	3,645	
6	Hec –Bele 1 me fuqi 5Mw	5,000	35,336	
7	Hec – Bele 2 me fuqi 11 MW	11,000		
8	Hec-Mgulle me fuqi 0.28 MW	280	364	Erald Energjitik
9	Hec- Kryezi 1 me fuqi 0.6 Mw	600	1,720	Bekim Energjitik
10	Hec "Koka 1" me fuqi 3,2 MW	3,200	4,723	Snow Energy
11	Hec" Mollaj" me fuqi 0,6 MW	600	648	Energji Xhaci
12	Hec" Tucep" me fuqi 0,4 MW	400	454	Tucep
TOTAL		44,130	82,492	

TOTAL H/C Priv/Konc 2013 240,644 759,330

H/C-et qe kane prodhuar per KESH sha gjate vitit 2013				
	Hec"Ulez" me fuqi 24 MW	24,000	81,232	Hec Ulez-Shkopet
	Hec"Shkopet" me fuqi 24 MW	24,000	63,344	
	Hec"Lanabregas" me fuqi 5 MW	5,000	33,943	HEC Lanabregas
	Hec"Bistrica 1" me fuqi 22,5 MW	22,500	60,162	HEC Bstrica 1,2
	Hec"Bistrica 2" me fuqi 5 MW	5,000	22,968	
TOTAL		80,500	261,649	

H/C-et qe kane prodhuar per "KURUM" gjate vitit 2013 (Gusht-Dhjetor)				
	Hec"Ulez" me fuqi 24 MW	24,000	126,586	
	Hec"Shkopet" me fuqi 24 MW	24,000		
	Hec"Bistrica 1" me fuqi 22,5 MW	22,500		
	Hec"Bistrica 2" me fuqi 5 MW	5,000		
TOTAL		75,500	126,586	

(Burimi ERE)

Në grafikun e figurës -11-është paraqitur ecuria e prodhimit nga HEC-et e vegjël privatë ose të dhënë me konçension (deri 15 MW) si dhe HEC Ashta gjatë periudhës 2004 – 2013. Duke marrë parasysh që prodhimi maksimal i vitit 2010 përveç rritjes së kapaciteteve të instaluar në një masë të madhe u ndikua nga kushtet shumë të favorshme hidrike, nga grafiku vihen re tempet e larta të rritjes së prodhimit nga HEC-et e dhënë me konçension veçanërisht gjatë periudhës 2008-2013. Një rritje e konsiderueshme u vërejt gjatë vitit 2013 ku prodhimi nga këto HEC-e ishte 2.5 herë më i madh në krahasim me vitin e mëparshëm. Kontribut të rëndësishëm në këtë rritje të prodhimit ka HEC Ashta, i cili gjatë vitit 2013 prodhoi 211 GWh ose 28% të totalit të prodhimit nga këto HEC-e.




Figure 11 Ecuria e Prodhimit nga HEC-et e vegjël të dhënë me koncesion dhe private

(Burimi ERE)

Në grafikun e figurës -12- janë paraqitur detyrimet e Furnizuesit Publik me shumicë ndaj subjekteve private për energjinë elektrike të shitur tek KESH sh.a. e cila që nga viti 2012 pati rritje në mbi 2.5 Miliard lekë dhe për vitin 2013 ka arritur në 6.6 Miliard lekë.




Figure 12 Detyrimet e KESH.sh.a ndaj subjekteve Private për Energjinë Elektrike

(Burimi KESH sh.a)

Çmimet për blerjen e prodhimit të energjisë elektrike nga ana e FPSH prej HEC-eve të reja të ndërtuara me konçension, bazuar në metodologjinë për përcaktimin e tyre për këtë kategori, mbështeten mbi çmimet e importit të realizuara nga KESH sh.a një vit më parë. Duke nisur nga viti 2010, për shkak të një çmimi të itur të importit të energjisë elektrike të realizuar nga KESH sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a, këto çmime kanë ardhur në rritje. Sipas Vendimit nr. 161, datë 07.12.2012 të ERE-s, cmimet për HEC-et e reja me konçesion për vitin 2013 ishin të njëjta me ato të vitit 2012 pra në nivelin 9.3 leke/kWh.

Për HEC-et egzituese të privatizuara apo të dhëna me konçesion, mbështetur në vlerësimin e çmimit sipas metodologjisë së këtyre Hec-eve, çmimet për blerjen e prodhimit të energjisë elektrike nga ana e FPSH, për periudhën 2010-2013, nuk paraqesin luhatje te theksuara. Keshtu në vitin 2013, në zbatim të Vendimit 161, datë 07.12.2012, çmimi ishte i njëjtë me atë të vitit 2012 pra 7.77 lek/kWh. Kjo diferencë e çmimit midis këtyre dy grupeve vjen si rezultat i aplikimit të dy metodologjive të ndryshme: për HEC-et private/konçension të vjetër, bazë e llogaritjes është çmimi mesatar për klientët tariforë për vitin përkatës, ndërsa për HEC-et me konçensionet e reja, bazë e llogaritjes është çmimi i importit dhe kursi i këmbimit për vitin paraadhës sikurse përcaktuar në VKM nr.27 datë, 19.01.2007 “Për rregullat e dhënies të konçesioneve” i ndryshuar.

Në figurën -13- paraqitet ecuria e cmimeve të HEC-eve me kapacitet deri 15MW, gjatë periudhës 2004 - 2013.




Figure 13 Çmimet e blerjes së energjisë elektrike nga FPSH prej HEC-eve Private, me Koncension dhe Koncensionet e reja

(Burimi ERE)

2.5 Efienca e Prodhimit të Energjisë Elektrike

Sikurse evidentuar edhe në vitet e tjera efienca e prodhimit të energjisë elektrike të sistemit tonë elektroenergjetik vlerësohet nga analiza e treguesve kryesore të paraqitura më poshte:

1. Aftësia e akumulimit të energjisë elektrike në formë rezerve potenciale hidroenergjetike,
2. Aftësia për rregullimin e prurjeve në mënyre vjetore.
3. Optimizimi i kombinimit të prodhimit me importin e energjisë elektrike.
4. Fleksibiliteti i lartë ndaj ngarkesës, ç'ka i lejon të mbulojë lehtësisht pikun e ngarkesës,
5. Varësia e theksuar e prodhimit të energjisë elektrike nga kushtet hidrologjike të motit.
6. Shkarkimet e ujit nga rezervuarët.
7. Investime relativisht më të mëdha për ndërtimin e tyre dhe kohë më e gjatë për përfundimin dhe futjen e objektit në shfrytëzim në krahasim me TEC-et
8. Shpenzime më të vogla shfrytëzimi dhe mirëmbajtje.

Table 6 Tregues të tregut të Energjisë

Emertimi	Viti											
	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Prodhimi (GWh)	3,204	4,974	5,467	5,409	5,516	2,933	3,770	5,201	7,702	4,158	4,725	6,959
Importi nga KESH & CEZ (GWh)	2,072	937	567	365	633	2,828	2,417	1,884	1,911	3,262	2,538	1,424
Çmimi mesatar i importit (Euro/MWh)	30.18	30.15	35.57	40.04	47.81	69.00	79.00	48.69	45.50	60.49	63.63	51.51
Vlera e Importit nga KESH & CEZ (milion Euro)	62.53	28.26	20.17	14.63	30.25	195.13	190.94	91.74	86.95	197.34	161.52	73.36
Furnizimi (GWh)	5,430	5,900	5,945	5,933	6,121	5,719	6,300	6,593	6,970	7,342	7,617	7,961

(Burimi KESH, OST)

Në shifrën e Furnizimit me energji elektrike është paraqitur në mënyrë të përmbledhur e gjithë sasia e energjisë elektrike të përdorur, apo konsumi i përgjithshëm në vend.

Lidhur me pikën 6, shkarkimet e ujit pa kaluar në turbina nga basenet e kaskadës së Drinit për disa vite paraqiten si më poshtë:




Figure 14 Shkarkimet e Ujit nga H/C-et e Kaskadës së Drinit (2002-2013)

(Burimi OST sh.a)

Gjate vitit 2013 vërehen shkarkime jo shumë të mëdha të ujrave të realizuara për sigurinë e digave në kushtet e rritjes së nivelit të liqeneve.

Në figurën -14- janë paraqitur në mënyrë grafike shkarkimet e ujit nga HEC-et e Kaskadës së lumit Drin, për secilin vit të periudhës 2002-2013. Eksportet apo shitjet me çmime tregu nga KESH sh.a janë realizuar gjatë muajve Mars deri Qershor 2013 në sasinë e përgjithshme 952 899 MWh bazuar në rregulloren e shfrytëzimit të kaskadës së lumit Drin në muajt përkatës.

3. Transmetimi i Energjisë Elektrike

3.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit

Veprimtaria e transmetimit të energjisë elektrike kryhet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a), një shoqëri publike me 100% të aksioneve shtetërore. OST është krijuar në vitin 2004, si rezultat i reformimit dhe ndarjes së Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, nga një shoqëri e organizuar vertikalisht që kryente funksionet e gjenerimit, transmetimit dhe Shpërndarjes së energjisë elektrike, në tre shoqëri të veçanta.

Në zbatim të Ligjit Nr.9072 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, OST kryen funksionet e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Dispecerimit dhe Operatorit të Tregut.

OST garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për: (i) furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes (CEZ Shpërndarje) dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit, (ii) transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit, (iii) si dhe për tranzitimin dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

Në këtë kuadër ai zhvillon sistemin e transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me energji elektrike, me planet e zhvillimit të burimeve të reja të energjisë elektrike dhe koordinon zhvillimin e rrjetit të interkoneksionit me vendet fqinje.

OST dispeceron sistemin elektroenergjetik nëpërmjet menaxhimit të flukseve të energjisë në sistem duke marrë parasysh realizimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me qëndrueshmërin e sistemit si dhe shkëmbimet me sistemet e tjera.

Një rol i rëndësishëm është dhe ai i Operatorit të tregut të energjisë elektrike, funksionet e të cilit po zgjerohen gradualisht me hapat që po hidhen për krijimin dhe konsolidimin e një tregu të lirë dhe konkurrues të energjisë elektrike në rajon.

3.1.1 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit

Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike përfshin bashkësinë e linjave elektrike, nënstationeve dhe instalimeve të tjera (mjeteve kompensuese, etj), me tension nga 110 kV deri në 400 kV, që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike dhe interkoneksionin ndërkombëtar.

Rrjeti elektrik kryesor përbëhet nga linjat e transmetimit me tension 220 kV që lidhin burimet kryesore të prodhimit të energjisë elektrike (kaskada e Drinit në Veri të vendit) me qendrat më të mëdha të konsumit (kryesisht në pjesën qendrore). Rrjeti i linjave me tension 110 kV, gjithashtu ka një shtrirje në të gjithë zonat urbane të vendit dhe furnizon nënstationet 110/TM kV (TM- Tensioni i mesëm), që i përkasin sistemit të shpërndarjes . Rrjeti me tension 400 kV është zhvilluar kohët e fundit, veçanërisht nëpërmjet linjave të interkoneksionit me vendet fqinje.


Gjatësitë e linjave të sistemit të transmetimit, sipas nivelit të tensionit janë si më poshtë:

- Linjat e transmetimit 400 kV 293.6 km
- Linjat e transmetimit 220 kV 1145.5 km
- Linjat e transmetimit 150 kV 34.4 km
- Linjat e transmetimit 110 kV 1349.5 km


Në përbërje të linjave të mësipërme përfshihen dhe linjat e interkoneksionit me vendet fqinje :

- Linja e interkoneksionit 220 kV Fierze (Shqipëri) – Prizren (Kosovë)
- Linja e interkoneksionit 220 kV Koplik (Shqipëri) – Podgorice (Mali i Zi)
- Linja e interkoneksionit 400 kV Zemblak (Shqipëri) – Kardia (Greqi)
- Linja e interkoneksionit 400 kV Tirane (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)
- Gjithashtu një linjë me tension 150 kV funksionon midis Shqipërisë dhe Greqisë

Kapaciteti i shkëmbimit me vendet fqinje është i mjaftueshëm për të realizuar shkëmbimet e nevojshme dhe tranzitimet e kërkuara në çdo kohë.



OST ka në administrim 14 nënstacione transformuese me fuqi të përgjithshme 3756 MVA. Nënstacionet kryesore janë n/stacionet 220/110 kV pranë qyteteve kryesore me kapacitet të instaluar 2240 MVA si dhe N/stacionet transformuese 400/220 kV që lidhin rrjetin e brendshëm 220 kV me rrjetin e interkoneksionit 400 kV me kapacitet të instaluar 1200 MVA. Janë dy N/stacione 400/220 kV: N/st Tirana2 dhe N/st Elbasan2, secili me fuqi të instaluar 2x300 MVA.



Ndërtimi i Linjave 220 dhe 110 kV që përbëjnë edhe pjesën kryesore të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike ka filluar që para 30-60 vjetësh. Si pasojë e kohës së gjatë të shërbimit, e terreneve të vështira nga kalojnë këto linja si dhe e punimit në kushte të rënduara të ngarkesave elektrike, konstatohen amortizime të shtyllave, përciellësve, morseterive, etj.

Një fenomen mjaft negativ i shfaqur gjatë 20 viteve të fundit është dëmtimi i linjave me armë zjarri dhe veçanërisht ndërtimet e paligjshme poshtë dhe në zonën mbrojtëse të trasesë së linjave.

Trasetë e linjave pranë zonave të banuara po zihen gjithnjë e më shumë nga ndërtime të paligjshme që rrezikojnë jetën e vet atyre që banojnë nën to dhe pengojnë mundësinë e remonteve dhe riparimeve.

3.1.2 Veprimtaria e OST

Bilanci i energjisë elektrike të transmetuar nga OST sh.a

Në tabelë jepet bilanci energjistik i OST sh.a për vitin 2013 (GWh) dhe parashikimi 2014.

Table 7 Bilanci Energjitik i OST sh.a për vitin 2013 (GWh) dhe parashikimi 2014

Nr.	Bilanci Energjitik i OST sh.a (GWh)	FAKT 2013	PARASHIKIM 2014
I	ENERGJI TOTALE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT	9,035	7,849
1	- Prodhimi vendas	6,712	4,638
2	- Energji në marrje (importi bruto)	2,323	3,211
II	ENERGJIA TOTALE E TRANSMETUAR	8,825	7,654
1	- Energji në dhënie (exporti bruto)	1,425	
2	- Energji e transmetuar për CEZ Shpërndarje sh.a.	6,797	6,969
3	- Energji e transmetuar për klientët e kualifikuar	603	685
III	HUMBJE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT	210	196
		2.3 %	2.5%

Në total, pritet që konsumi bruto për vitin 2014 të jetë i rendit 7.85 TWh.

Mënyra e mbulimit të kësaj kërkesë të pritshme prej 7.85 TWh, është bërë në bazë të eksperiencës tashmë shumë vjeçare, duke konsideruar prurjet në kaskadë me 75% siguri, nivelin e liqenit në Fierzë (të pritshëm) në fillim të vitit, rritjen e mundshme modeste të numrit dhe volumit të gjenerimit të PPE-ve dhe centraleve të vogla të lidhura me rrjetin e shpërndarjes, dhe sigurisht pjesa më e madhe e rritjes së kërkesës i është ‘ngarkuar’ importit të energjisë, i shtrirë gjatë të gjithë vitit. Është treguar kujdes gjithashtu për optimizimin e kaskadës së Drinit, ruajtjen e kuotës në Fierzë, pra eficientë të gjenerimit, si dhe fillimin e vitit tjetër me një kuotë dhe rezervë energjetike optimale për të përballuar kërkesën për energji elektrike.

Në procesin e përcaktimit të prodhimit të vendit dhe importit, OST i ka dhënë KESH-it gjithmonë sugjerimet përkatëse dhe ka kryer me përpikëri transmetimin e energjisë elektrike sipas programeve të përcaktuara, duke operuar me një numër të madh operatorësh të tregut, prej të cilëve KESH dhe OSSH blejnë energjinë elektrike të nevojshme nga importi.

Vlerësime Financiare

Në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat për të ardhurat dhe shpenzimet jepen në tabelën Nr.8.

Table 8 Te Ardhurat, Shpenzimet dhe Rezultati Financiar

TË ARDHURAT, SHPENZIMET DHE REZULTATI FINANCIAR (ne milion Leke)			
T r e g u e s i t	Programi i vitit 2013	I Pritshmi i vitit 2013	Programi i vitit 2014
Të ardhurat gjithsej	5,154	5,418	5,560
Nga transmetimi i energjisë elektrike	4,684	4,883	4,975
Nga alokimi i kapaciteteve të transmetimit	440	510	560
Të tjera	30	25	25
Shpenzimet gjithsej	3,192	3,355	3,963
Personeli	878	744	976
Materiale të para	110	81	110
Furnitorët dhe Shërbimet	346	300	470
Pagesë CBT	350	212	350
Zhdëmtim për shpronësim ndërtimi			
Amortizimi	1,100	1,611	1,620
Pagesa Interesi	200	200	241
Blerja e humbjeve	208	208	196
Rezultati financiar bruto	1,963	2,063	1,597
Rezultati financiar neto	1,766	1,856	1,437
Investime me fondet e veta	2,163	848	2,306
Nëpërmjet prokurimeve	1,626	621	2,040
Pagese kosto lokale	370	71	266
Financim kredie	167	156	-
Investime me financime të huaja	4,500	2,812	3,336

Tarifa e Transmetimit

OST aplikon tarifën e transmetimit sipas çmimit të miratuar nga ERE, mbi përdorimin e sistemit të transmetimit nga Pjesëmarrësit e Tregut.

Marrëdhëniet midis OST dhe pjesëmarrësve të tregut bëhen mbështetur në Rregullat e Tregut dhe kontratën Tip midis OST dhe Tregtarëve apo Furnizuesve. Faturimi i energjisë së transmetuar bëhet në faturë mujore, mbi bazën e të dhënave të marra nga sistemi i matjes i OST sh.a.

Në Tabelën Nr. 9 paraqitet një përmbledhje e konsumeve të Pjesëmarrësve të Tregut për gjithë vitin 2013, ndërsa në Tabelën Nr. 10 kemi një përmbledhje të gjithë faturave për shërbimin e transmetimit të emetuara nga OST sh.a, për periudhën Janar – Dhjetor 2013.

Table 9 Konsumi për Faturat e Transmetimit për vitin 2013

FATURA E TRANSMETIMIT	Viti 2013	CEZ Shperndarje	K. Kualifikuar	Totali
		MWh	MWh	MWh
	Janar	708,496	38,435	746,931
	Shkurt	632,726	38,307	671,032
	Mars	632,792	43,477	676,269
	Prill	500,466	47,364	647,830
	Maj	464,702	60,751	525,433
	Qershor	474,966	67,689	542,656
	Korrik	526,006	60,874	586,880
	Gusht	551,711	38,227	589,939
	Shtator	479,861	53,186	533,047
	Tetor	513,688	51,869	565,556
	Nentor	565,654	55,785	621,438
	Dhjetor	746,429	47,009	793,438
	Totali	6,797,497	602,973	7,400,470

Table 10 Tabela e të Ardhurave nga Furnizuesi i Kualifikuar (Tarifa e Transmetimit)

FATURA E TRANSMETIMIT	Viti 2013	CEZ Shperndarje	K. Kualifikuar	Totali
		Mlek	Mlek	Mlek
	Janar	460.522	24.983	485.505

Shkurt	411.272	24.899	436.171
Mars	411.315	28.260	439.575
Prill	325.303	30.786	356.090
Maj	302.056	39.488	341.545
Qershor	308.728	43.998	352.726
Korrik	341.904	39.568	381.472
Gusht	358.612	24.848	383.460
Shtator	311.910	34.571	346.480
Tetor	333.897	33.715	367.612
Nentor	367.675	36.260	403.935
Dhjetor	485.179	30.556	515.735
Totali	4,418.3728	391.9324	4,810.3052

Invesitimet Kryesore për Zhvillimin e Sistemit të Transmetimit

Zhvillimi i rrjetit të transmetimit në përputhje me parashikimet afatgjata dhe me planet e zhvillimit të sektorit elektroenergjetik në tërësi është një nga funksionet themelore të OST sh.a dhe përbën një domosdoshmëri për kryerjen e funksioneve të saj. Vitet e fundit janë vënë në operim projekte të rëndësishme që kanë rritur së tepërmi qëndrueshmërinë e funksionimit të sistemit elektroenergjetik, kapacitetin e shkëmbimit me vendet fqinje si dhe cilësinë e shërbimit kundrejt klientëve të sistemit të transmetimit. Ndërkohë projekte të tjera të rëndësishme janë në fazë implementimi. OST ka një plan të qartë afatmesëm të zhvillimit të sistemit të transmetimit.

Projekte në fazë implementimi

Ndërtimi i Qëndres së re Kombëtare Dispecer

“Sistemi i Ri i kontrollit SCADA/EMS i Qendrës Kombëtare Dispecer” është një nga projektet më të rëndësishme të Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Njësia qëndrore e sistemit të ri SCADA/EMS dhe facilitetet për shfrytëzimin e tij, së përqëndruar provizorisht në sallën e kontrollit të N/st 400 kV Tirana2. Ky projekt është tepër kompleks dhe përfshin:

Sistemin e Telekomunikacionit

ku përfshihet shtrirja e rreth 450 km fibër Optike (OPGW) dhe paisjet e tjera të telekomunikacionit si RTU, PLC, MUX, PABX, që realizojnë marrjen e të dhënave për sistemin SCADA dhe EMS nga N/stacionet e Sistemit të Transmetimit, Centralet e KESH dhe N/stacionet kryesore të CEZ Shpërndarje.

Sistemin SCADA

me funksionet e Grumbullimit të dhënave, Përpunimit e ngjarjeve, Llogaritjen e të dhënave, Monitorimin e kufirit të parametrave, Raportimet, Komandimin në distancë, etj.

Sistemin e Menaxhimit të Energjisë (EMS)

me funksionet e Parashikimit të ngarkesës, menaxhimit të rezervës hidraulike, Angazhimin e gjeneratorëve, Vlerësimin e transaksioneve, Vlerësimin e gjëndjes, Kalkulimin e flukseve të fuqisë, Analizën e pasigurisë, etj

Kontrollin automatik te gjeneratoreve (AGC)

Kaskades sw Drinit, per kontrollin fuqi –frekuence dhe ruajtjes sw balancit te shkembimit me fqinjet.

Ndërtesën e Re të Qendrës Dispecer dhe OST

Fuqizimi i Rrjetit të Transmetimit 110 kV të Jugut të Shqipërisë

Përfshin ndërtimin e:

linjës dyfishe 110 kV Vlorë – Sarandë, rreth 105 km e gjatë

linjës 110 kV Ersekë – Përmet ,rreth 55 km e gjatë

Rikonstruksionin e linjës 110 kV Korçë – Ersekë, 36 km e gjatë

Rikonstruksionin e linjës 110 kV Përmet – Këlcyrë – Memaliaj- Ballsh –Fier.

qarkun e dytë të linjës 110 kV Zemblak - Korçë

fuqizimin e nënstationit 400/110 kV Zemblak, 150 MVA

Projekti, është në fazën e implementimit dhe pritet të jetë në operim të plotë në fund të vitit 2015. Projekti financohet nga një kredi e qeverisë gjermane, nëpërmjet bankës KfW

Ndërtimi i Linjës së Interkonjeksionit 400 kV Tirana2 – Kosova B

Linja 400 kV do të ketë nje gjatësi prej 242 km (162.5 km linjë e re dhe 80.5 km plotësim i qarkut të dytë në pjesën e parë të linjës së përfunduar Tiranë – Podgoricë), 155.5 km në territorin e Shqipërisë. Projekti është në fazën e fillimit të implementimit dhe mendohet të ketë një kohëzgjatje prej 24 muajsh. Financimi i projektit bëhet nga qeveria gjermane nëpërmjet bankës KfW.

Projekte të planifikuara dhe të pa mbuluara me investime.

- Ndërtimi i linjës 220 kV me dy qarqe Tiranë2 – Rrashbull dhe N/stacioni 220/110 kV Rrogozhinë.

Përfshin ndërtimin e një linje 220 kV me dy qarqe Tiranë – Rrashbull, rreth 20 km së bashku me daljet përkatëse 220 kV në N/st Tiranë dhe Rrashbull.

- Fuqizimi i rrjetit unazor 110 kV të qytetit të Tiranës dhe ndërtimi i N/stacionit 220/110 kV (opsion 400/110 kV) Tiranë3.

Projekti parashikon:

Demontimin e linjave ekzistuese 110 kV Tiranë – U.Traktora dhe U.Traktora – Selitë dhe ndërtimin e tyre në trase të reja dhe pjesërisht kabllorë, rreth 23 km (linja ajrore me përcjellës ACSR 300 mm² dhe linja kablore me përcjellës XLPE AL 1000 MM²).

Ndërtimin e n/stacionit 220/110 kV, 2x120 MVA (opsion 400/110 kV, 2x150 MVA) Tiranë3.

Lidhjen e n/stacionit të ri me rrjetin ekzistues të transmetimit.

- Ndërtimi i linjës së interkonjeksionit 400 kV Elbasan – Bitola (Maqedoni) si dhe nënstacionit të ri 400/220 kV Elbasan 3.

Ky projekt përfshin ndërtimin e linjës 400 kV Elbasan – Bitola, 151 km e gjatë, nga të cilat 56 km në territorin e Shqipërisë. Ndërtimin e një pike komutimi 400 kV në Elbasan

Mbi anëtarësimin e OST në ENTSO-E (European Network of Transmission System Operatos for Electricite)

Siç dihet OST ka aplikuar për anëtarësim në ENTSO-E (European Network of Transmission System Operatos for Electricite). Në kuadër të aplikimit për anëtarësim në ENTSO-E nga OST, është ngritur një grup pune i përbashkët me përfaqësues të OST dhe të operatorëve të transmetimit të rajonit. Është punuar një kohë të gjatë për plotësimin e kushteve teknike të kërkuara për anëtarësimin në këtë organizatë dhe konkretisht:

- Është vënë në funksionim sistemi i matjes tregtare në të gjithë kufijtë ndarës të OST me gjeneruesit dhe konsumatorët.

- Eshtë vënë në funksionim një sistem i reduktuar Mini SCADA për operimin e sistemit Elektroenergjetik dhe rregullimin fuqi-frekuencë (LFC).
- Eshtë ndërtuar dhe vënë në operim linja e interkoneksionit 400 kV Elbasan – Tiranë – Podgoricë.
- Eshtë ndërtuar dhe vënë në operim N/st 400/220/110 kV Tirana2.
- Po përfundon plotësisht vënia në operim e sistemit të ri full SCADA/EMS dhe ACG.
- Eshtë realizuar sistemi i telekomunikacionit me Malin e Zi për shkëmbimin e të dhënave dhe është në përfundim telekomunikimi me Greqinë.
- Janë nënshkruar marrëveshjet bilaterale me OST fqinje dhe pritet nënshkrimi i marrëveshjes me KOSTT Kosovë.

Këto plotësime kanë sjellë OST në të njëjtin stad me operatorët e tjerë anëtare të ENTSO E dhe janë më se të mjaftueshme për anëtarësimin e OST në organizatën ENTSO E. Praktikisht sistemi ynë elektroenergjetik funksionon prej kohësh në paralel sinkron me rrjetin europian duke plotësuar të gjitha kërkesat teknike dhe ligjore.


4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

4.1 Struktura e Sistemit të Shpërndarjes

Në Tabelën -11- është paraqitur harta e Republikës së Shqipërisë dhe shtrirja gjeografike e secilës zonë së shpërndarjes. CEZ Shpërndarje është organizuar në 10 Zona Shpërndarje dhe 40 Agjensi sipas emërtimeve të mëposhme:

Table 11 Ndarja Administrative e Rrjetit të Shpërndarjes dhe Peshat Specifike në Konsumin e Energjisë Elektrike

STRUKTURA MENAXHUESE E CEZ SHPERNDARJE 2013																																								
ZONA	Zona Berat				Zona Burrel			Zona Durres			Zona Elbasan			Zona Fier			Zona Gjirokastrer			Zona Korce			Zona Kukës			Zona Shkoder			Zona Tirane											
AXHENSI	Berat	Kuçove	Lushnje	Skrapar	Bulqize	Burrel	Lac	Mirdite	Peshkopi	Durrës	Kavajë	Krujë	Shijak	ELBASAN	GRAMSH	LIBRAZH	PEQIN	Ballsh	Fier	Patos	Vlora	Delvine	Gjirokastrer	Permet	Saranda	Tepelene	BILISHT	ERSEKE	KORCE	POGRADEC	HASI	KUKESI	TROPOJA	Koplik	Lezhe	Puke	Shkoder	Tirane 1	Tirane 2	Tirane 3



(Burimi CEZ Shpërndarje)

Në tabelën -12- janë paraqitur të dhëna mbi asetet dhe numrin e konsumatorëve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Table 12 Të dhënat mbi Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes

TE DHENA MBI OSSH 2013	
NUMRI I ZONAVE	10
NUMRI I AXHENSIVE	40
Konsumatore (nr)	1 194 705
Linja 35 kv (km)	1 122
Transformatore TL (nr)	312
Nenstacione (nr)	172
Kabina TM	23 714
Gjatesia e rrjetit TM (km)	15 300
Gjatesia e rrjetit TU (km)	29 695

(Burimi CEZ Shpërndarje)

TABELA ME TE DHENA TE CEZ SHPERNDARJE 2013		2013
Energji Totale ne CEZ Shperndarje (MWh)		7,145,061
Energji e transmetuar nepermjet OST per llogari te OSSH		6,743,241
	Nga KESH - Gen nepermjet OST	3,602,490
	Nga OST si import i humbjeve (perfshire energjine nga ASHTA)	3,140,751
	Nga OST per llogari klienteve te CEZ Shperndarje ne TL	-
	Nga TEC VLORA nepermjet OST	n/a
	Nga Bistrica 1,2 nepermjet OST	n/a
Energji e transmetuar direkt ne rrjetin e OSSH		401,820
	HEC Ulez, Shkopet, Lanabregas	64,427
	Impjantet Private/me Koncesion	337,393
Energji Totale ne Rrjetin e Shperndarjes (MWh)		7,145,061
Humbjet Totale ne CEZ Shperndarje (MWh)		3,217,967
	Humbje Teknike njesite e TL (MWh)	201,689
	Humbje Teknike ne Zona (MWh)	884,360
	Humbje JoTeknike ne Zona (MWh)	2,131,918
Humbjet Totale ne CEZ Shperndarje (%)		45.04%
	Humbje Teknike njesite e TL (%)	2.82%
	Humbje Teknike ne Zona (%)	12.74%
	Humbje JoTeknike ne Zona (%)	30.72%
Energjia e shitur per te gjithë konsumatorët e CEZ Shperndarje		3,927,094
Shitur Klienteve Private (MWh)		1,211,887
	Shitur nga rrjeti i Transmetimit per llogari te CEZ Shperndarje	-
	Shitur per nevoja te veta te CEZ Shperndarje	3,872
	Shitur Klienteve Private (pa ate per nevoja te veta dhe Ne TL)	1,208,016
Shitur Klienteve JoBuxhetore (MWh)		262,175
Shitur Klienteve Buxhetore (MWh)		191,719
Shitur Klienteve Familjare (MWh)		2,261,313
	Shitur Klienteve Familjare deri 300 kwh/muaj (MWh)	1,725,152
	Shitur Klienteve Familjare mbi 300 kwh/muaj (MWh)	479,660
	Shitur Klienteve Familjare per Ambientet e Perbashketa	56,501
Faturuar muaji Parardhes (000/leke)		48,156,068
Arketimet e muajit aktual (000 leke)		38,378,301
	Arketuar per faturat korrente te vitit aktual	19,912,711
	Arketuar per faturat e tjera te vitit aktual	11,375,208
	Arketuar per faturat e tjera te viteve te kaluara	7,090,381
Arketimet e muajit aktual (%)		79.7%
	Arketuar per faturat korrente te vitit aktual (%)	41.4%
	Arketuar per faturat e tjera te vitit aktual (%)	23.6%
	Arketuar per faturat e tjera te viteve te kaluara (%)	14.7%
Faturuar muaji Raportues (000/leke)		48,399,742
Energji e pa faturuar nga muajt paraardhes (MWh) (UBE-1)		-
Energji e pa faturuar per muajin aktual (MWh) (UBE)		-
Nr. Konsumatoreve gjithsej (Nr.)		1,194,705
Fatura te emetuara me lexim konsumi (Nr.)		10,291,652
Sasia e energjise se faturuar me lexim konsumi (MWh)		3,890,427
Fatura te emetuara me lexim "0" (Nr.)		3,322,785
Nr.Faturave te emetuara pa lexim (energji e pa matur) (Nr.)		7,138
Sasia e energjise se faturuar si energji e pamatur (MWh)		49,706
Nr.Faturave te emetuara pa lexim (dem ekonomik) (Nr.)		2,156
Shuma e faturuar si dem ekonomik (000/leke)		529,686
Nr.Faturave per te cilat eshte arketuar kamat vonese (Nr.)		5,220,825
Vlera e Kamat vonesave te arketuara (000/leke)		273,688

4.2 Konsumi i Energjisë Elektrike

Strukturimi i kërkesës për energji elektrike është karakterizuar edhe gjatë këtij viti nga diferenca parashikim/fakt, dhe vështirësi në rakordime mes operatorëve e cila ka çuar në vështirësi të përcaktimit të konsumit të energjisë elektrike. Në figurën -16- paraqiten në menyrë grafike konsumi total vjetor i energjisë elektrike (duke përfshirë edhe konsumin e klienteve të kualifikuar) në Shqipëri për periudhën 2002 deri në 2013.




Figure 15 Konsumi i përgjithshëm në vite

Në tabelat e mëposhtme jepen treguesit e sintetizuar nga të tre operatorët kryesore të sistemit energjitik në Shqipëri.

Table 13 Tregues të Sintetizuar nga të tre Operatorët Kryesore të Sistemit Energjitik në Shqipëri

TABELA PËRMBLEDHESE E RAPORTIMEVE PERIODIKE NGA OPERATORËT E SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJITIK SHQIPTAR - VITI 2013												
		Janar	Shkurt	Mars	Priil	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor
Energji Totale per CEZ Shpërndarje	T=6+TL	743,846	665,392	673,578	545,600	502,945	511,390	546,696	565,789	493,056	532,555	589,808
Energji nga OST tek CEZ Shpërndarje	1	703,661	628,040	623,206	486,124	453,983	469,949	525,522	551,664	479,563	512,804	563,752
Energji per klientet e lidhur ne TL	TL	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Energji e transmetuar ne CEZ Shpërndarje	2=1-TL	703,661	628,040	623,206	486,124	453,983	469,949	525,522	551,664	479,563	512,804	563,752
Produhimi i injektuar ne rrjetin e CEZ Shpërndarje	P=a+b	40,985	37,352	50,372	59,476	48,952	41,441	21,174	14,125	13,493	19,752	26,056
Produhimi i Produesve te mesem	a	7,374	6,141	7,579	6,780	6,628	6,984	6,301	5,397	2,350	2,776	2,887
Produhimi nga prodhues private e koncesionare	b	32,811	31,211	42,793	52,700	42,324	34,458	14,873	8,728	11,143	16,975	23,169
Energji Totale ne rrjetin e CEZ Shpërndarje	3=2+P+5	743,846	665,392	673,578	545,600	502,945	511,390	546,696	565,789	493,056	532,555	589,808
Humbjet totale ne CEZ Shpërndarje	4=7	380,233	324,141	325,251	216,362	198,781	206,241	236,895	217,853	172,982	244,893	283,557
Humbjet totale ne CEZ Shpërndarje (%)	4/3	51.12%	48.71%	48.29%	39.66%	39.52%	40.33%	43.33%	38.50%	35.08%	45.98%	48.08%
Energji e konsumuar nga kliente te kualifikuar	5	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Energji per klientet e CEZ Sh. lidhur ne rrjetin e shpërndarjes	6=2+P	743,846	665,392	673,578	545,600	502,945	511,390	546,696	565,789	493,056	532,555	589,808
Humbjet ne CEZ Shpërndarje	7=8+10	380,233	324,141	325,251	216,362	198,781	206,241	236,895	217,853	172,982	244,893	283,557
Humbjet ne CEZ Shpërndarje (%)	7/6	51.12%	48.71%	48.29%	39.66%	39.52%	40.33%	43.33%	38.50%	35.08%	45.98%	48.08%
Humbjet teknike ne rjesile e TL	8=6-9-13	22,872	17,006	14,493	11,983	11,711	15,866	16,412	16,994	14,308	16,328	18,046
Humbjet teknike ne rjesile e TL (%)	8/3	3.07%	2.56%	2.15%	2.56%	2.33%	3.10%	3.00%	3.00%	2.90%	3.07%	3.06%
Energji per Zonat e CEZ Shpërndarje	9	720,571	648,039	658,727	531,362	491,038	495,338	530,097	548,586	478,553	515,987	571,472
Humbjet ne Zonat e CEZ Shpërndarje	10	357,362	307,135	310,758	212,378	187,070	190,375	220,483	200,859	158,673	228,566	265,511
Humbjet ne zonat e CEZ Shpërndarje (%)	10/9	49.59%	47.39%	47.18%	38.09%	38.10%	38.43%	41.59%	36.61%	33.16%	44.30%	46.46%
Humbjet Teknike	11=10-12	90,193	84,134	87,891	88,940	64,737	61,865	66,686	69,006	60,636	64,621	71,605
Humbjet Teknike (%)	11/9	12.52%	12.98%	13.34%	12.98%	13.18%	12.49%	12.58%	12.58%	12.67%	12.52%	12.53%
Humbjet Jo Teknike	12	267,169	223,002	222,868	133,438	122,333	128,510	153,798	131,853	98,037	163,945	193,907
Humbjet Jo Teknike (%)	12/9	37.08%	34.41%	33.83%	25.11%	24.91%	25.94%	29.01%	24.03%	20.49%	31.77%	33.93%
Energji e shitur nga rrjeti i CEZ Shpërndarje	5=9-10	363,219	340,903	347,969	328,033	303,968	304,963	309,614	340,737	319,880	287,422	305,961
Energji e shitur per konsumin veçak ne TL	13	403	348	358	236	197	186	187	199	194	240	290
Energji e shitur nga CEZ Shpërndarje	5/1=5+13	363,613	341,251	348,327	328,269	304,164	305,149	309,801	341,937	320,074	287,662	306,251
Energji e shitur per te gjithë klientet e CEZ Shpërndarje	TS=S/1+TL	363,613	341,251	348,327	328,230	304,164	305,149	309,801	341,937	320,074	287,662	306,251
Energji e shitur Klienteve Familjare	FS	226,209	212,016	198,916	209,917	176,520	167,382	164,211	182,282	175,764	162,394	178,823
Energji e shitur klienteve jo familjare	FS=TS-FS	137,404	129,235	151,411	128,313	127,645	137,867	145,590	165,735	144,311	124,918	127,228
Importuar nga OSSH		0	0	448,136	0	0	0	79,236	173,932	178,040	186,250	212,400

		Janar	Shkurt	Mars	Priil	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor
Produh. Bruto nga Karkada e Dimnit dhe HEC Theth (KESH Gen.)	A	507,826	468,389	572,285	710,889	762,880	613,880	419,121	372,286	273,828	291,888	322,546
Humbjet ne Produhimi (KESH)	L	3,161	2,842	3,168	2,502	2,462	2,116	1,978	637	1,071	1,312	1,820
Konsumi Veçak (KESH)	M	338	295	347	388	273	294	253	287	272	288	318
Produh. Neto nga Karkada e Dimnit dhe HEC Theth (KESH Gen.)	A1	504,665	465,547	569,117	708,387	760,418	611,764	417,143	371,649	272,757	290,576	320,726
Produh. Neto nga HEC e shpërndarje nga KESH	B1	52,740	47,840	52,114	44,927	37,406	6,979	6,381	3,185	2,343	2,776	2,420
Produhimi neto nga TEP-Vlora	D	-261	-289	-340	-241	-230	-223	-233	-238	-286	-226	-222
Produhimi neto nga HEC-et Private/Konc	E	48,139	44,819	78,475	120,913	111,741	86,885	42,287	27,245	33,853	51,829	68,297
Produhimi Neto vendas (përgjithësi humbjet ne transmetim)	S	684,163	557,822	691,189	881,086	900,672	784,381	488,153	481,252	388,877	343,893	382,911
Energji e shitur Eksporti-Gasin Tregu	O	0	0	84,428	38,332	387,136	175,812	0	0	0	0	0
Humbje-Konc veçak (OST)	N	28,791	17,415	28,382	23,176	22,714	18,551	15,215	14,585	11,312	11,943	14,836
Energji nga produhimi vendas per FFSH		655,372	540,407	562,807	551,886	488,823	518,738	444,938	388,747	295,565	331,716	368,075
Import nga KESH	F	63,823	107,840	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Energji disponibel e FFSH Produhimp (përshtetje)		743,848	665,393	525,442	545,881	582,344	511,388	467,888	391,837	314,816	348,385	378,348
Morre si shëmbim	G	15,858	17,985	6,185	0	0	2,887	28,558	42,753	28,385	12,879	14,874
Diçka si shëmbim	P	0	0	63,887	0	0	2,887	7,887	7,836	8,885	7,323	8,843
Hyrje per Balancim	J	1,297	381	0	0	4,121	631	1,511	0	0	9,833	2,843
Dalje per Balancim	K	0	0	2,463	6,297	0	0	0	27	1,278	0	0
Energji Tot e venduar nga FFSH		743,848	665,393	525,442	545,881	582,344	511,388	467,888	391,837	314,816	348,385	378,348
Importuar nga OSSH	H	0	0	448,136	0	0	0	79,236	173,932	178,040	186,250	212,400
Energji Tot per OSSH		743,848	665,392	525,442	545,881	582,345	511,388	467,888	391,837	314,816	348,385	378,348

Nr.	Përshkrimi	Njësia e matjes	Progresive
I	ENERGJI TOTALE QE HYN NË SISTEMIN E OST	kWh	9,034,945,598
1	- Prodhimi vendas	"	6,712,417,336
2	- Energji në marrje	"	2,322,528,262
II	ENERGJIA TOTALE E TRANSMETUAR	kWh	8,825,290,459
1	- Energji në dhënie	"	1,424,820,931
2	- Energji e transmetuar për CEZ Shpërndarje sh.a.	"	6,797,496,585
3	- Energji e transmetuar për klientet e kualifikuar	"	602,972,943
a.	GSA sh.p.k.	"	348,442,179
b.	YLLIAD sh.p.k.	"	25,845,331
c.	EFT ALBANIA sh.p.k.	"	50,684,618
d.	GEN-I TIRANA sh.p.k.	"	136,324,410
e.	KURUM INTERNATIONAL sh.a.	"	41,676,405
III	Humbje në rrjetin e Transmetimit	kWh	209,655,140
	- Nga kjo: Nevoja vetjake	kWh	1,575,929
IV	Humbje në rrjetin e Transmetimit	%	2.3

Piku në vitin 2013 shënon 1540 MW në dhjetor 2013.




Figure 16 Ngarkesa Orare 2013




Figure 17 Piku i Ngarkesës gjatë Muajve të Vitit 2013

(Burimi ERE)

4.2.1 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike

Në vendin tonë konsumi familjar në raport me konsumin e përgjithshëm të faturuar për konsumatorët tariforë për vitin 2013 përbën rreth 57.6 %. duke shfaqur të njëjtin trend sikurse edhe në vitet e tjera.




Figure 18 Raportet e Faturimit sipas Kategorive

**Pesha specifike qe zene grupimet e konsumatoreve te energjise aktive
(sipas cmimeve ne %)**




Figure 19 Pesha Specifike që zënë grupimet e konsumatorëve të energjisë elektrike

Një peshë të rëndësishme në konsumin e energjisë elektrike zënë edhe konsumatorët buxhetorë dhe jo buxhetorë, te këta të fundit bëjnë pjesë kryesisht ujësjellësit dhe hidrovorët.

Duhet theksuar se sipas nivelit të konsumit, domethënës është fakti se rreth 76.3% e gjithë konsumatorëve familjare i përkasin bllokut të konsumit deri 300kWh/muaj me një rritje rreth 1% në krahasim me vitin 2012.

4.2.2 Profili i Konsumit të Energjisë Elektrike

Struktura e konsumit të energjisë elektrike ndikon drejtpërsëdrejti edhe në profilin e ngarkesës ose të konsumit të energjisë elektrike. Në dallim nga profili i ngarkesës në një ditë me konsum maksimal, në profilin e një dite me konsum minimal, spikat një pik

ngarkese në orët e mbrëmjes 19.00 -22.00 e cila ka të bëjë kryesisht me intensifikimin e veprimtarisë familjare në këto orë, gjatë stinës së verës.

Nga studimi i profilit vjetor të konsumit të energjisë elektrike, tipari karakteristik i këtij profili është simetria thuajse e plotë e konsumit dimër – verë. Gjatë periudhës së ngrohtë Prill – Shtator ka një konsum mesatar pothuajse konstant kurse në tre muajt paraardhës dhe pasardhës ka një rritje simetrike të ngarkesës e cila shpjegohet me ftohjen/ngrohjen e motit dhe përdorimin gradual të energjisë elektrike për ngrohje/ftohje.

Ashtu sikurse në raportimet e viteve të mëparëshme edhe këtë vit vërehet e njëjta problematikë e përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje. Çdo ndryshim i temperaturës së mjedisit reflektohet menjëherë në konsumin ditor të energjisë elektrike, pikërisht të efektit nga përdorimi ose mospërdorimi i ngrohjes elektrike të banesës.

Gjatë stinës së verës, në muajt Korrik dhe Gusht merr formë një pik i ri ngarkese, i cili nga viti në vit po bëhet më evident dhe lidhet me përdorimin gjithnjë e në shkallë më të gjerë të pajisjeve klimatizuese.

4.3 Importi i Energjisë Elektrike

Në zbatim të kërkesave të Modelit Shqiptar të Tregut, importet e energjisë elektrike për nevojat e konsumatorëve në vendin tonë, kryhen nga furnizuesi publik me shumicë (FPSH) në përbërje të KESH sh.a. Ndërsa FPSH importon energji për të plotësuar nevojat e klientëve tariforë, CEZ Shperndarje sh.a importon energji elektrike për mbulimin e plotë të humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e Shpërndarjes.

Table 14 Importi i Energjisë nga KESH dhe CEZ gjatë vitit 2013

	2012	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	2013
Importi i CEZ-Shperndarje sha	1,655,440	0	0	148,136	0	0	0	79,296	171,720	179,040	186,250	212,400	274,536	1,251,378
Importi i KESH sha	880,745	63,623	107,040	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	170,663
Importi i Klienteve te Kualifikuar	596,818	38,435	38,307	43,477	47,364	60,751	67,689	60,874	38,227	53,186	51,869	55,785	47,009	602,973

Vlerat e sipërpermendura përfshijnë edhe blerjet me çmime tregu.

Në grafikun e figurës -20- është paraqitur ballanca import-eksport e energjisë elektrike për periudhën 1985 – 2013. Sikurse vihet re deri në vitin 1998, (me përjashtim vetëm të vitit 1990) vendi ynë ka qenë një vend eksportues neto i energjisë elektrike. Siç

shihet edhe për vitin 2013 vendi ynë rezultoi një importues neto. Sqarojmë se vlerat e paraqitura përfaqësojnë të gjitha flukset hyrëse e dalëse nga të gjithë aktorët e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.




Figure 20 Balanca Imp/Eksp e energjisë elektrike në Vite (OST)

(Burimi OST)




Figure 21 Ecuria e vlerës së Importit të Energjisë Elektrike 2002-2013

(Burimi KESH, CEZ Shpërndarje)

4.4 Efienca e Tregtimit të Energjisë Elektrike

Gjatë vitit 2013 efienca e tregtimit të energjisë ka vijuar të jetë e ulët krahasuar me periudhat e mëparëshme në referencë gjithnjë të faktorëve përcaktues në nivelin e efiençës së konsumit të energjisë elektrike të cilët janë:

- Niveli i lartë i humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje.
- Niveli i ulët i arkëtimit të energjisë elektrike të faturuar

Humbjet e përgjithshme të raportuara nga Kompania për vitin 2013, arrijnë në 45.04%.




Figure 22 Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes 2007-2013

Niveli i arkëtimeve i raportuar nga CEZ Shpërndarje për vitin 2013 është 83 % të energjisë elektrike të faturuar. Kjo shifër përfshin edhe arkëtimet e prapambetura të periudhës 2007-2012 në vlef tën 8.996 miliard leke.




Figure 23 Niveli i Arkëtimeve Mujore 2012-2013

Table 15 Faturim/Arkëtim dhe Ndryshimi i Gjëndjes Debitorë gjatë vitit 2013

FATURIM-ARKËTIMET DHE NDRYSHIMI I GJËNDJES DEBITORE GJTE VITIT 2013 (000/LEKE)							
Viti 2013	Te arkëtueshme sipas 31.12.2012 CEZ Shperndarje	Faturuar 2013	arkëtimi per faturat e 2013	Arkëtimi per faturat e 2007-2012	Arkëtimi total	Te Arkëtueshme per energjine e faturuar ne vitin 2013	Ndryshimi i gjëndjes se Llogarive te arkëtueshme gjate vitit 2013
	61,353,007						
		2	5	7	6=5+7	9=(2-5)	10=(2-5-7)
Janar	63,683,901	4,992,058	31,905	2,629,258	2,661,163	4,960,152	2,330,894
Shkurt	64,715,455	4,211,554	2,054,750	1,125,250	3,180,000	2,156,804	1,031,554
Mars	65,317,352	4,234,130	2,755,407	876,826	3,632,233	1,478,722	601,897
Prill	65,820,874	4,001,750	2,963,254	534,974	3,498,228	1,038,496	503,522
Maj	66,301,623	3,644,471	2,929,316	234,405	3,163,722	715,155	480,749
Qershor	67,397,416	3,632,138	2,342,521	193,823	2,536,344	1,289,616	1,095,793
Korrik	67,994,329	3,789,587	2,981,697	210,977	3,192,674	807,890	596,913
Gusht	68,844,876	4,264,835	3,130,818	283,470	3,297,639	1,134,017	850,547
Shtator	69,298,701	3,800,018	3,117,068	229,125	3,346,193	682,950	453,825
Tetor	69,589,432	3,492,927	3,028,766	173,430	3,202,196	464,161	290,731
Nentor	70,354,893	3,755,718	2,738,237	252,020	2,990,258	765,460	765,461
Dhjetor	71,257,799	4,580,556	3,299,657	377,993	3,677,650	902,906	902,906
Total		48,399,742	31,373,399	7,121,550	38,378,301	16,396,329	9,904,793




Figure 24 Ecuria e Gjëndjes Debitorë

Koefiçienti vjetor i efektivitetit për sistemin e shpërndarjes (i cili merr parasysh nivelin vjetor të humbjeve dhe të arkëtimeve) rezulton edhe më i ulët se viti paraardhës.




Figure 25 Efektiviteti Mujor i Shitjes

(Burimi CEZ Shpërndarje)

Për vitin 2013, niveli i humbjeve i raportuar nga CEZ Shpërndarje sh.a. është 45.04% pra ka një përmirësim prej 1.31% nga humbjet e konstatuara nga ERE në vitin 2012 (46.35%).

Në sistemin e transmetimit humbjet e energjisë elektrike janë në vleftën 209.6 GWh ose 2.32% nga 2.21% të raportuara në vitin 2012 siç demonstron në tabelen nr. 7.




Figure 26 Humbjet Totale kundrejt Energjisë së Futur në Rrjet

(Burimi ERE)

Në figurën -26- është paraqitur ecuria e humbjeve totale përfshirë ato në sistemin e transmetimit, gjatë periudhës 2002 – 2013, kurse në grafikun e figurës -27- është paraqitur marrëdhënia e faturim-arkëtimeve gjatë së njëjtës periudhë.




Figure 27 Faturimi/Arkëtimi 2002-2012

(Burimi CEZ Shpërndarje)




Figure 28 Arkëtimi, Humbja dhe Mosarkëtimi Mesatar në % të Energjisë në Sistem

PJESA II

Kapitulli I

Rregullimi i Sektorit të Gazit Natyror

1. Prioritetet e ERE për Sektorin e Gazit

Natyror gjatë vitit 2013

Viti 2013 ka vijuar të ketë angazhime intensive dhe shumë të rëndësishme për ERE në raport me sektorin e gazit natyror. Ato kanë qënë kryesisht të lidhura me projektin TAP, si dhe bashkëpunimet në nivelin e Komunitetit të Energjisë.

1.1 Projekti TAP, (Trans Adriatic Pipeline)

Projekti i Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) është pjesë e sistemit të transmetimit të gazit të prodhuar nga vendburimi Shah Deniz 2 (SD 2) në Azerbajxhan drejt Tregut European të Gazit. Transportimi përmes Azerbajxhanit dhe Gjeorgjisë do të kryhet me anë të tubacionit South Caucasian Pipeline, ndërsa transportimi përmes Turqisë do të kryhet me anë të tubacionit TANAP deri në kufirin Turko-Grek. Transportimi i mëtejshëm do të kryhet me anë të tubacionit Trans Adriatic Pipeline (TAP). TAP do të shtrihet përmes Greqisë, Shqipërisë, në tabanin e detit Adriatik për tu bashkuar me Sistemin Italian të Transmetimit të Gazit në zonën e San Foca në Italinë Jugore çka mundëson lëvizjen e mëtejshme drejt tregjeve evropiane. Projekti është projektuar fillimisht të transportojë 10 bcm/vit, me mundësinë për zgjerimin më vonë të kapacitetit deri në 20 bcm/vit nëpërmjet shtimit të stacioneve të reja të kompresorëve. TAP është i projektuar gjithashtu që të mundësojnë rrjedhjen fizike të gazit në drejtim të kundërt.

Projekti TAP është zhvilluar nga kompania TAP AG. Aksionerët fillestare të kompanisë kanë qënë; kompania zvicerriane Axpo (42.5%), kompania norvegjeze Statoil (42.5 %) dhe kompania gjermane E.ON Ruhrgas (15%). Statoil është gjithashtu aksionere (25,5 %) në Konsorciumin Shah Deniz që është kompania që shfrytëzon SD2.

Në 30 korrik 2013 struktura e aksionereve të TAP ndryshoi si vijon; BP (20%), SOCAR (20%), Statoil (20%), Fluxys (16%), Total (10%), E.ON (9%) dhe Axpo (5%).

TAP, ka një gjatësi rreth 870 kilometra. Gjurma e tij fillon në kufirin Turko-Grek, kalon nëpër territorin grek dhe hyn në Shqipëri në zonën e Bilishtit. Ai përshkon 204 kilometra në Shqipëri (nga Bilisht- Qendër në kufirin greko shqiptar deri në zonën

bregdetare në Seman në veri te Fierit), shtrihet 105 kilometra nëpër Detin Adriatik, del në Melendugno dhe vazhdon edhe 5 kilometra në territorin Italian.

1.1.1 Disa nga Zhvillimet më të Rëndësishme në Lidhje me Projektin TAP gjatë vitit 2013.

Miratimi i përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP – AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të Direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline” dhe dokumentit “Opinion i Përbashkët i Rregullatorëve për Aplikimin e TAP AG për Përjashtime”

ERE me Vendimin Nr. 27, datë 01.03.2013, miratoi përjashtimin e kushtëzuar të kompanisë TAP – AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të Direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline” dhe dokumentin “Opinion i Përbashkët i Rregullatorëve për Aplikimin e TAP AG për Përjashtime”.

Pas komenteve dhe sygjërimeve të bëra nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, dhe Vendimit të Komisionit Evropian (C(2013)2949, ERE me Vendimin Nr. 64, Datë 13.06.2013 , amendoi Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s , Nr. 27, datë 01.03.2013 dhe vendosi miratimin e dokumentit “Opinion Perfundimtar i Përbashkët i Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përjashtim”.

Versioni Final i Opinionit Perfundimtar mbi përjashtimin e TAP AG nga Rregullat e Aksesit të Paleve të Treta dhe parashikime të tjera të Paketës së Tretë të Energjisë u publikua në datën 25 Korrik 2013, pas miratimit edhe nga Rregullatorët Italian dhe Grek . Marrja e këtij Vendimi është rezultat i një bashkepunimi të shkëlqyer të nisur dy vjet me parë të dy Autoriteteve Kombëtare të Greqisë dhe Italisë, si shtete anëtare të BE dhe Shqipërisë, si pjesë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë.

Ky dokument paraqet vlerësimin më të fundit lidhur me aplikimin e TAP AG për përjashtime, duke marrë në konsideratë rezultatet e testit të tregut. Ai gjithashtu përfshin kushtet që vendos Komisioni Evropian, nën Vendimin C(2013)2949 final të datës 16 Maj 2013 dhe gjithashtu Opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë të datës 14 Maj 2013. Vendimi Final i Autoriteteve vendos një kuadër rregullator për zhvillimin dhe operimin e Gazesjellesit TAP, si transportues i gazit në Evropë.

Vendosja e një kuadri të tillë rregullator rrit besimin e TAP si transportues i gazit nga Azerbaxhani në Evropë. Pas perfundimit të projektit Gazësjellësi TAP do të jetë interkonektori më i madh që do të hapë Korridorin Jugor të Gazit për furnizimin e Evropës me gaz nga Kaspiku. Keto volume të reja gazi që do të transportohen në Evropë do të reduktojnë varësinë e Bashkimit Evropian nga Rusia, Algjeria dhe Norvegjia.

Nga ana tjetër, kuadri rregullator i krijuar, veçanërisht mundësia e shtimit të pikave të hyrjes dhe daljes së gazit, lejon TAP të jetë një rrugë thelbësore për furnizimin me gaz të Evropës Juglindore (SEE), dhe do të bëjë gazifikimin e vendeve në rajon, do të zvogelojë varësinë nga një burim i vetëm furnizimi dhe do të kontribuojë në zhvillimin e infrastrukturës së gazit në Evropë. Gjithashtu TAP do të kontribuojë në zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri, duke siguruar lidhjen me Tregun Evropian të Gazit, do të kontribuojë në pjekurinë e tregut grek të gazit, duke bërë lidhjen e gazit lindor me tregun evropian të gazit.

Pranimi i kërkesës së TAP AG's për përjashtime shoqërohet me një sërë kushtesh si:

Aksesi i të gjithë blerësve të ardhshëm të Gazit Shah Deniz II në tubacionin TAP lejohet me të njëjtat terma dhe kushte (per të gjithë); Transportimi i kapacitetit maksimal të gazit, nëpërmjet TAP duhet të bëhet në mënyrën më të leverdisshme teknikisht dhe ekonomikisht, bazuar në testimin e tregut të gazit, duke ndjekur praktikën më të mirë evropiane; Tregu i Gazit në Evropën Juglindore do të ketë akses direkt nëpërmjet tubacionit të Gazesjellesit TAP që do të kalojë në Shqipëri dhe Greqi, me furnizuesit e gazit nga Italia në mënyrë plotësisht të rregulluar; Ndërveprueshmëria e TAP me infrastrukturën egzistuese dhe atë të ardhme në Itali, Greqi dhe Shqipëri, garantohet nëpërmjet zhvillimit të pikave të reja të hyrjes dhe të daljes (new entry and exit points), duke ndjekur nevojat e tregut në të tre vendet; TAP AG do të veprojë si Operator Sistemi i Pavarur për gjithë periudhën e përjashtimit (25 vjet), masat konkurruese parandalojnë zhvillimin e pozicioneve dominuese në treg për të tre vendet.

1.2 Miratimi i Metodologjise së Gazit

Enti Rregullator i Energjisë miratoi Metodologjinë e Tarifave për Gazin me anë të Vendimit Nr. 127, datë 7.11.2013, “Mbi miratimin e Metodologjisë së Tarifave (TAP Tariff Code), të propozuar nga TAP AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion”

Në datën 8 Nëntor 2013, tre Rregullatorët e Shqipërisë (ERE), Greqisë (RAE) dhe Italisë (Aereg)1 aprovuan Kodin e Tarifave të propozuar nga kompania TAP AG për TAP, tubacionin e gazit që do të sjellë gazin e Azerbajxhanit në Itali, nëpërmjet Greqisë dhe Shqipërisë.

Kodi i Tarifave për Gazin përshkruan metodologjitë e përdorura për percaktimin e termave dhe kushteve të cmimeve që do të aplikohen për transportuesit e ardhshëm të gazit që do të transportojnë gazin nëpërmjet TAP dhe do të aplikohen si për kapacitetet subjekt i aksesit të detyrueshëm të paleve të treta, edhe për kapacitetet e përjashtuara nga këto kërkesa.

Metodologjia e tarifave të propozuar nga TAP AG është transparente, jo diskriminuese dhe me kosto efçente. Kodi i Tarifave parashikon një zvogelim të tarifës në rast të rritjes së kapacitetit të rezervuar në të ardhmen. Nga ana tjetër, në përputhje me Opinionin Final të Përbashkët, struktura e tarifave merr në konsideratë nivelin e ndryshëm të rriskut ndërmjet investimit në kapacitetin fillestar dhe investimit për zgjerim në të ardhmen.

TAP ka paraqitur për shqyrtim, komente e sugjerime pranë tre autoriteteve rregullatore draftin e parë të metodologjisë së tarifave të TAP (TAP Tariff Code) që në datën 24.04.2013.

Drafti i Metodologjisë së Tarifave ka qenë objekt i nje sërë takimesh, diskutimesh, conference calls dhe shkembimi komentesh ndërmjet të tre rregullatoreve si dhe ndërmjet rregullatorëve dhe TAP. Duke qene se tarifat e transmetimit janë gjithashtu edhe objekt i Marrëveshjeve të Transportimit të Gazit të nënshkruara ndërmjet TAP dhe transportuesve të gazit (shippers), të cilët në pjesën e kapaciteteve fillestare objekt i Vendimit të Perjashtimit do të transportojnë gazin e aksionerëve të Konsorciumit Shah Deniz 2, Metodologjia e Tarifave është pjesë përberëse e këtyre Marrëveshjeve. Për

pasojë në diskutimin e një sërë çështjesh së Metodologjisë së Tarifave ka patur edhe pjesëmarrje te perfaqësuesve të Konsorciumit Shah Deniz 2.

Metodologjia e Tarifave ka ëësuar një sërë ndryshimesh që prej versionit të saj fillestar në sajë të komenteve të bëra prej të tre Rregullatorëve në mënyrë që dokumenti të reflektojë parimet bazë të përmendura në Final Joint Opinion.

Versioni përfundimtar i metodologjisë së Tarifave është paraqitur në ERE për miratim në datën 14 tetor 2013.

Në përmbajtjen e kësaj metodologjie zbatohen kërkesat themelore të përcaktuara në Opinionin e Përbashkët në lidhje me tarifën; reflektimi në tarife i kostove efikase, që ato të jenë transparente dhe jo diskriminuese; mekanizmi që tarifën të jenë zbritëse në vijim të rritjes së kapaciteteve transportuese që do të përdoren; marrja në konsideratë e nivelit të ndryshëm të riskut të investimit fillestar dhe zgjerimit të mëtejshëm; tarifa të njëjta për të njëjtin produkt pavarësisht nëse ai është i ofruar prej kapacitetit të përjashtuar nga aksesit i palëve të treta apo prej kapacitetit jo të përjashtuar.

PJESA III

Kapitulli I

Aktiviteti i Entit Rregullator të Energjisë

1. Çmimet dhe Tarifat e Energjisë

Bazuar në ligjin nr.9072 datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (i ndryshuar), përkatësisht në nenet 26, 27 dhe 28 si dhe akteve të tjera nënligjore, që burojnë prej tij, ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e tarifave të aktiviteteve të rregulluara që realizohen në sektorin e energjisë.

1.1 Lënia në Fuqi e Tarifave Egzistuese deri në datë 31 Dhjetor 2013.

Në vitin 2013, për shkak së CEZ Shpërndarje sh.a. kaloi në kushtet e statusit juridik të një shoqërie nën administrim të përkohshëm, përparësi për ERE-n ishte ndjekja nga afër e aktivitetit të kësaj shoqërie, veçanërisht shqyrtimi i planeve mujore të shpenzimeve dhe skedulit të pagesave si dhe vlerësimi i realizimit të këtyre planeve. Monitorimi i CEZ Shpërndarje sh.a nëpërmjet ndjekjes së realizimit të planeve mujore të shpenzimeve e pagesave u konsiderua prioritar për rolin që kanë aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit në mbarëvajtjen ekonomiko- financiare të të gjithë aktiviteteve në sistemin elektro-energjitik.

Në kuadër të procesit të perditesimit të tarifave për të gjitha aktivitetet e rregulluara u analizuan të ardhurat e kërkuara për të gjithë operatorët dhe ne perfundim u konstatuan këto problematika kryesore:

- Operimi në treg i aktiviteteve të shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë nga shoqëria CEZ Shpërndarje në statusin e administrimit të përkohshëm për shkak të heqjes së licensave përkatëse, si dhe të zbatimit të akteve ligjore që janë të lidhura drejtpërsëdrejti me aktet ligjore të privatizimit. Statusi juridik i kompanisë në administrim të përkohshëm i CEZ Shpërndarje sh.a. bënte të pamundur vlerësimin e tarifave për keto aktivitete sepse treguesit e performacës të vendosur në Deklaratën Rregullatore i adresohen të licensuarit dhe investitorit përkatës. Këta tregues të përcaktuar sipas Deklartës Rregullatore jo vetëm që nuk u arritën por edhe u përkeqësuan duke sjellë një efekt të ndjeshëm në të ardhurat e kompanisë për të cilët nuk mund të merrej vendim nga ana e ERE për sa kohë që statusi juridik i CEZ Shpërndarje sh.a. vazhdonte të mbetej i përkohshëm dhe ndërkohë Deklarata Rregullatore vazhdonte të ishte në fuqi.

- Përcaktimi i tarifës së shpërndarjes është i lidhur me vlerësimin e komponentëve të tillë si niveli i humbjeve të pranuar në tarifë si kosto e arsyeshme, sasia e lëvruar në rrjetin e shpërndarjes, investimet e kryera të cilat janë të lidhur me treguesit e performancës së kompanisë së shpërndarjes të cilat janë të fiksuara në Deklaratën Regullatore.
- Mosrakordime midis CEZ Shpërndarje dhe KESh sh.a për periudhën 2011 -2012 për blerjet dhe shitjet e energjisë elektrike të dhënë më tepër për mbulimin e humbjeve, për shkak të statusit juridik të CEZ Shpërndarje sh.a.. Objekt i këtij mosrakordimi ishin faturat e papranuara nga administrimi i mëparshëm i kompanisë CEZ Shpërndarje sh.a. të cilat pritet të zgjidhen gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe konfliktit me CEZ a.s.
- Vendimi nr. 87 datë 29.06.2012 i Bordit të Komisionerëve të ERE përcakton tarifën e furnizuesit publik me shumicë për periudhën 2012-2014 në vlerën 2.2 lekë.
- Paqartësi e mënyrës së përlogaritjes së treguesve të Furnizuesit Publik me Shumicë për efekt të të ardhurave të tepërta të krijuara përgjatë vitit 2013 si pasojë e prodhimit përtej parashikimeve të tarifës.
- Ligji 138/2013 “Për burimet e Energjisë së Rinovueshme” i miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë në datë 2.5.2013 përcakton se *Këshilli i Ministrave, me propozim të ERE-s, miraton metodologjinë e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë elektrike, që do t'i paguhet prodhuesit me përparësi, për të gjitha llojet e centraleve, që shfrytëzojnë burime të rinovueshme energjise.* Hartimi i kësaj metodologjie dhe përcaktimi i tarifave përkatëse ishte i pamundur në kushtet e problematikave të shpjeguara në kapitullin III të këtij Raporti. Informacioni tekniko-ekonomik i kërkuar nga ERE për prodhuesit e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të cilët do të jenë subjekt i zbatimit të këtij ligji dhe metodologjisë përkatëse nuk ishte paraqitur nga të gjitha subjektet dhe shpesh herë të dhënat ishin të ndryshme nga raportimet e paraqitura më parë në ERE. Mosdisponimi i të dhënave të plota e të sakta sikurse edhe vështirësitë e tjera në zbatim, që do të mundësonin llogaritjet paraprake për të finalizuar Metodologjinë e sipërcituar, e bëri të pamundur përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për hidrocentralet me fuqi të instaluar deri 15 MW për vitin 2014.

Për sa më lart si dhe duke pasur parasysh që:

- Miratimi i çmimit mesatar trevjeçar bazohet në mesatarizimin e të ardhurave të kërkuara për tre vite, duke krijuar kështu mundësi për një operim në kushte normale për gjatë periudhës rregullatore 2013-2014.
- Gjatë vitit 2013 miratimi i skedulit të pagesave dhe ndjekja e tij në vazhdimësi solli stabilizim të gjëndjes së likuiditeteve të operatorëve në treg përfshirë KESH sh.a, OST, Prodhuesit e Vegjël apo Prodhuesit e Pavarur të Energjisë, dhe bëri të mundur krijimin e burimeve të brendshme për shoqërinë e shpërndarjes në kryerjen e një aktiviteti normal.

Për sa më sipër, ERE, me Vendimin nr. 54 datë 03.05.2013, dhe më pas me Vendimin nr. 149 datë 24.12.2013 vendosi të lërë në fuqi deri në datën 31 Dhjetor 2014 tarifat e miratuara me vendimet nr. 144,146, 147,148, 149, 151, 153, datë 07.12.2011 si dhe vendimin nr. 87, datë 29.06.2012, “Për rishikimin e tarifës për Furnizuesin Publik me Shumicë për Periudhën e Tretë Rregullatore për akomodimin e efekteve financiare të vendimit nr. 80 datë 15.06.2012 të Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Përditësimi dhe kompesimi i të gjitha efekteve financiare për operatorët e rregulluar do të kryhet brenda të njëjtës periudhë rregullatore 2012-2014, apo në periudhën rregullatore pasardhëse, periudhë e cila do të shërbejë për qartësimin e gjëndjes juridike të kompanisë së shpërndarjes, duke i krijuar kështu mundësinë rregullatorit për qartësimin, verifikimin dhe përcaktimin sa më të drejtë të treguesve të të ardhurave të kërkuara për aktivitetet e gjenerimit publik, furnizimit me shumicë, transmetimit, shpërndarjes së energjisë elektrike dhe furnizimit me pakicë të konsumatorëve tariforë.

Table 16 Tarifat e Shërbimeve dhe të Shitjeve me Pakicë të Energjisë Elektrike 2012-2014 (sipas vendimit nr.148 date 7.12.2011)

Tarifat e shërbimeve dhe të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014

Niveli i Tensionit	Kategoritë e Konsumatoreve	Viti 2012-2014	
		Cmimi (leke/kWh)	Cmimi i energjisë në pik (leke/kWh)
TENSION I MËSHEM	Kliente të furnizuar në 35 kV		
	Industri	8.50	9.78
	Tregëti & shërbime	8.50	9.78
	Bujqësi	8.50	9.78
	Te tjere	8.50	9.78
	Kliente të furnizuar në 20/10/6 kV		
	Industri	9.10	10.47
	Tregëti & shërbime	10.00	11.50
	Furra buke, prodhim mielli	7.10	8.17
	Bujqësi	8.70	10.01
	Te tjere	9.70	11.16
	Budhetore	11.50	13.23
	TENSION I ULËT	Kliente të furnizuar në TU	
Industri		10.50	12.08
Tregëti & shërbime		12.20	14.03
Furra buke, prodhim mielli		7.60	8.74
Bujqësi		10.50	12.08
Te tjere		12.00	13.80
Budhetore		14.00	16.10
Familjare			
Biloku I për deri në 300 kWh		7.70	
Biloku I dytë mbi 300 kWh		13.50	
Tarifa fikse e shërbimit për leximin "zero" (leke/muaj)		200	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (shkallë, pompe, ashensor, etj (leke/kWh)		8.00	
* Cmimi i energjisë reaktive do të jetë 15% e cmimit të energjisë aktive			

Grafiku në vijim paraqet strukturën e tarifave sipas Vendimeve të Bordit të Komisionerëve, nr. 144,146, 147,148, 149, 150, 151, 152, 153, 154, datë 07.12.2011 si dhe sipas përllogaritjeve të kryera në dhjetor 2012:




Figure 29 Struktura e Çmimit të Shitjes me Pakicë të Energjise Elektrike aprovuar nga ERE

1.2 PVE dhe ndikimi tyre në Tarifën e Furnizuesit Publik me Shumicë

Gjatë vitit 2013 kanë hyrë në operim gjithsej 10 shoqëri me fuqi të instaluar gjithsej të impianteve gjenerues 54 MW. Prodhimi i realizuar nga këto shoqëri gjatë 2013 është rreth 73 GWh. Gjithashtu HEC Ashta me fuqi të instaluar 48MW gjatë vitit 2013 prodhoi rreth 211 GWh duke çuar totalin e energjisë që KESH sh.a. (në funksionin e Furnizuesit Publik me Shumicë) ka detyrim të blejë nga HEC-et e vegjël në rreth 760 GWh. Grafiku në vijim paraqet ecurinë e energjisë së prodhuar nga PVE në vite.




Figure 30 Ecuria e Prodimit nga PVE dhe Ashta

Prodhimi në vitin 2013 nga këto HEC-e u rrit me rreth 2.5 herë më shumë krahasuar me vitin paraardhës ndërkohë që vendimi për tarifën e FPSH për vitin 2013 parashikonte që sasia e blerë nga këto HEC-e të ishte 280 GWh ose 2.7 herë më e madhe nga ajo e pranuar. Po ashtu edhe çmimi mesatar i ponderuar në fakt është 8.74 leke/kWh nga 8.2 leke/kWh të parashikuar në tarifë për vitin 2013. (Kjo për shkak të rritjes së sasisë së prodhuar nga HEC-et e reja me konçension që kanë çmim të shitjes së energjisë më të lartë).

Sipas informacionit të KESH sh.a për vitin 2013, të ardhurat e realizuara nga PVE për energjinë e shitur tek FPSH kapen shifrën prej 6,629 milion lekë nga 2,241 milion lekë të parashikuara në tarifën e Furnizuesit Publik me Shumicë për vitin 2013. Kjo shifër përbën rreth 62% të të ardhurave të kërkuara për FPSH të pranuar në tarifën për vitin 2013.

Të ardhurat e realizuara nga PVE dhe HEC Ashta ndahen midis kategorive të ndryshme të prodhuesve sipas grafikut në vijim:




Figure 31 Struktura e të Ardhurave të Realizuara në vitin 2013 nga PVE dhe HEC Ashta

Vërehet që 26% e totalit të shpenzimeve të FPSH për blerjen e energjisë nga prodhuesit e vegjël ka shkuar për HEC Ashta. Për shkak të garancisë së prodhimit të siguruar nëpërmjet kontratës me qeverinë shqiptare do të ishte ndoshta më e përshtatshme që energjia e prodhuar nga Ashta të shkonte për mbulimin e humbjeve të sistemit të shpërndarjes.

Sfidë në të ardhmen mbetet gjetja e një zgjidhje të përshtatshme për nxitjen e investimeve në drejtim të burimeve të rinovueshme të energjisë (RES) me qëllim të ndikimit sa më minimal në tarifat për konsumatorët fundorë.

Në grafikun e figurës -32- është paraqitur ecuria e çmimeve të energjisë elektrike të miratuara nga ERE gjatë periudhës 2008-2014.




Figure 32 Çmimet e Miratuara nga ERE për periudhën 2008-2014

1.3 Çmimet dhe Tarifat e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit, viti 2013

Baza e të dhënave e Shoqatës Rajonale të Rregullatorëve të Energjisë (ERRA) për tarifat e energjisë është burimi kryesor i të dhënave zyrtare të energjisë elektrike në vendet e Europës Qëndrore / Lindore. Ajo përmban të dhënat tremujore nga viti 2000 deri më sot dhe mbulon 28 vende (Shqipëria, Bullgaria, Kroacia, Estonia, Gjeorgjia, Hungaria, Moldavia, Polonia, Rumania, Rusia, Turqia, Ukrainë, etj).

Në grafikun ne vazhdim janë paraqitur tarifat e energjisë elektrike para taksimit (TVSH-se) për konsumatorët jo familjarë, për të gjitha vendet e ERRA-s, në Euro cent/kWh. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët jo familjarë për vendet e rajonit është 9.1 Eurocent/KWh.




Figure 33 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve jo familjarë në vendet e rajonit sipas raportimit me te fundit ERA

Në grafikun më poshtë janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike për konsumatorët familjarë, për të gjitha vendet e ERA-s, në eurocent/kWh. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët familjarë për vendet e rajonit është 8.8 Eurocent/KWh.




Figure 34 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve familjarë në vendet e rajonit sipas raportimit me te fundit ERA

Kapitulli II

Licensimi dhe Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike

1. Licensimet dhe Kërkesat për Kualifikim Impiantesh të Trajtuara gjatë vitit 2013

Gjatë vitit 2013, ERE ka kryer një veprimtari të gjërë për licensimin e subjekteve në aktivitetet e ndryshme të sektorit të energjisë elektrike në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

Gjatë këtij viti vihet re një ulje e numrit të aplikimeve për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, nga 18 që ishin në vitin 2012, në 11 gjatë vitit 2013. E njëjta situatë paraqitet edhe me aplikimet për licensim në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike. Vazhdon me ritme të njëjta aplikimi për kualifikimin e impianteve prodhuese si burim i rinovueshem energjie. Ndërsa ka një rritje të aplikimeve për modifikim license, nga 5 ne vitin 2012 , në 8 gjatë vitit 2013.

Edhe gjatë këtij viti është respektuar me rigorozitet transparencën e parashikuar në procedurat për licensim, sikurse edhe zbatimi i afateve të shqyrtimit të aplikimeve dhe miratimit të paisjes me licencë të subjekteve aplikues, në zbatim të Ligjit Nr. 9072 datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe të “Rregullores për Procedurat e Licensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesshëm dhe Rinovimit të Licensave“. Gjithashtu në përputhje me kuadrin ligjor të mësipërm së zbatuar me korrektesë afatet e publikimit në median e shkruar të Vendimeve të Bordit të Komisionerëve për njohjen e të gjitha palëve të interesuara me këto Vendime. Çdo aplikim për licencim i është nënshtruar analizës së rregullshmërisë dhe plotësimit me korrektesë të dokumentacionit ligjor, administrativ, financiar, teknik dhe marrjes së lejeve përkatëse të përdorimit të ujrave apo leje mjedisore, të dhëna nga institucionet e tjera në përputhje me aktivitetin që subjektet kanë kërkuar të licensohen.

Gjatë vitit 2013 në ERE, nga subjektet, janë paraqitur 57 aplikime të ndryshme në aktivitetet e sektorit të energjisë elektrike.

Nga këto, 40 aplikime janë paraqitur për tu pajisur me licensë në aktivitetet e ndryshme të sektorit të energjisë elektrike, ndërsa 17 aplikime për kualifikim të impianteve prodhues si burim i rinovueshem energjie.

Për 33 aplikime për licensim Bordi i Komisionerëve ka vendosur licensimin e tyre, ndërsa 7 aplikime të tjera kanë vijuar të trajtohen gjatë vitit 2014 ne përputhje me afatet dhe procedurat e ERE-s.

Për 16 aplikime për kualifikim të impianteve prodhues si burim i rinovueshëm energjie, Bordi i Komisionerëve, ka vendosur kualifikimin e tyre, ndërsa një aplikim është në proces.

Në tabelën -17- paraqiten licensimet e miratuara nga Bordi i Komisionerëve sipas aktiviteteve të ndryshme gjatë viti 2013.

Table 17 Licensimet e Miratuara nga Bordi i Komisionerëve sipas Aktiviteteve të Ndryshme gjatë 2013

AKTIVITETI I LICENSUAR	Nr. I LICENSAVE TE MIRATUARA
Prodhim i energjisë elektrike	11
Furnizues i kualifikuar i energjisë elektrike	4
Tregtues i energjisë elektrike	9
Modifikim i Licences ekzistuesë	7
Rinovim i Licences ekzistuesë	2

Licensimet në Aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike

Janë licensuar për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike 11 shoqëri private për prodhimin e energjisë elektrike nga 17 impjante hidro (Hec-e) me një fuqi totale të instaluar 20.534 MW. Nga këto impiante :

- 9 prej tyre janë me kapacitet deri në 1Mw
- 8 prej tyre janë me kapacitet deri në 5 MW

Një subjekt tjetër është në proces licensimi për prodhimin e energjisë elektrike nga një impjant hidrik (Hec), me fuqi të instaluar 2,5 MW.

2. Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike

2.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike

Në zbatim të ligjit Nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, neni 8, pika 2 gërmat f) dhe g) si dhe neni 63, shërbimet e operatorëve të licencuar nga ERE-ja janë objekt i monitorimit në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore si dhe zbatimin e rregullave, vendimeve dhe urdhërave të ERE-s.

2.1.1 Parimet e Monitorimit të Tregut të Energjisë Elektrike

Monitorimet janë kryer bazuar në Rregullat e Tregut si dhe të rregulloreve përkatëse që veprojnë pjesëmarrësit e tregut.

Këto monitorime janë kryer bazuar në plane tematike paraprake dhe organizuar në mënyrë të tillë që të monitorohen në vazhdimësi rezultatet e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike.

Proçesi i monitorimit është kryer duke ndjekur periodikisht hapat e mëposhtme:

- Mbledhja dhe përpunimi i rezultateve periodike (muajore) dhe informacioneve.
- Përpunimi i rezultateve dhe përcaktimi i vlerave të indikatorëve të performancës.
- Raportimi i analizës së treguesve të performancës së pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike pranë Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Diskutimi i zgjeruar i problematikave në mbledhjet periodike të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
- Përcaktimi i qëndrimit të ERE-s lidhur me performancën e operatoreve si dhe përgatitja e qëndrimeve dhe rekomandimeve për to.
- Identifikimi i çështjeve për monitorim në terren.
- Kryerja e monitorimeve në terren dhe analizimi i tyre.
- Përcaktimi i qëndrimit dhe rekomandimeve të ERE-s lidhur me konstatimet nga monitorimet.

Table 18 Monitorimet gjatë Vitit 2013

Monitorimet gjatë Vitit 2013			
Urdhëri i Monitorimit	Objekti I Monitorimit	Periodha	Kompania
Urdhër Nr 10, date	Numri I ndërprerjeve për muajt Dhjetor, Janar, Shkurt 2013, numri I	Fillon në datën 06/02/2013	CEZ Shpërndarje sh.a(në administrim të

05/02/2013	konsumatorëve të prekur nga ndërprerjet e energjisë elektrike, numri I konsumatorëve pa matësa, të dhëna lidhur me SAIDI dhe SAIFI		përkohshëm)
Urdhër Nr 11, date 06/02/2013	Fluksi i parave të shoqërisë Cez Shpërndarje sh.a për periudhën Dhjetor 2012-Janar 2013.	07-30/02/2013	CEZ Shpërndarje sh.a(në administrim të përkohshëm)
Urdhër Nr 15, date 11/02/2013	Gjendja aktuale e ankesave dhe problematikave për periudhën Qershor-Dhjetor 2012 dhe gjendja aktuale e ankesave dhe problematikave për periudhën Janar-Shkurt 2013.	16-25/02.2013	CEZ Shpërndarje sh.a(në administrim të përkohshëm)
Urdhër Nr 25, date 28/05/2013	Verifikimi I volumit të punimeve të kryera për fuqizimin dhe rehabilitimin e HEC-eve Vithkuq, Barmash, Rajan, Borsh dhe Arras.	6/3/2013	Abanian Green Energy sh.p.k, Ballkan Green Energji sh.p.k dhe Favina 1 sh.p.k.
Urdhër Nr 28, date 07/03/2013	Verifikim I gjendjes së rrjetit në Cez Shpërndarje sh.a.	Fillon ne daten 10/03/2013	CEZ Shpërndarje sh.a(në administrim të përkohshëm)
Urdhër Nr 42, date 10/04/2013	Investimet e realizuara për vitin 2012 dhe investimet e realizuara deri tani për 2013.	15-19/04/2013	OST sh.a
Urdhër Nr 41, date 10/04/2013	Mekanizmi I përlogaritjes së disbalancave , zhvillimi I ankandëve ditore.	15-16 Prill 2013	OST sh.a
Urdhër Nr 42, date 10/04/2013	Investimet e realizuara për vitin 2012 dhe ato të realizuara deri tani për vitin 2013	15-19 Prill 2013	CEZ Shpërndarje sh.a(në administrim të përkohshëm)
Urdhër Nr 43, date 10/04/2013	Investimet e realizuara për vitin 2012 dhe ato të realizuara deri tani për vitin 2013	15-19 prill 2013	KESH sh.a
Urdhër Nr 45, date 24/04/2013	Realizimi I kushteve të vendosura nga ERE në aktivitetin e “ndërtimit, Instalimit, Shfrytëzimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga central me erë.	25 Prill-3 Maj 2013	HERA sh.p.k
Urdhër Nr 47, date 12/05/2013	Realizimi I aktivitetit të licensuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.	13-15/05/2013	Projeksion Energji
Urdhër Nr 54,	Prokurimet e kryera në vitin 2013 dhe	20/05-	CEZ Shpërndarje

date 20/05/2013	realizimi I investimeve, gjëndja e matësive, cash flow, dëmin ekonomik	31/05/2013	sh.a(në administrim të përkohshëm)
Urdhër Nr 65, date 12/07/2013	Transaksionet e eksport/importit dhe shkëmbimet e energjisë për gjashtëmujorin e parë të viti 2013.	17-30 Korrik 2013	KESH sh.a
Urdhër Nr 66, date 12/07/2013	Verifikimi I Cash Flow për periudhën Janar-Qershor 2013	17-30 Korrik 2013	KESH sh.a
Urdhër Nr 67, date 12/07/2013	Realizimi I Investimeve për periudhën Janar-Qershor 2013.	17-30 Korrik 2013	KESH sh.a
Urdhër Nr 70, date 16/07/2013	Shkëmbimi I informacionit ndërmjet KESH dhe Hec Ashta.	Fillon ne 18/07/2013	HEC ASHTA
Urdhër Nr 73, date 01/08/2013	Verifikimi I të ardhurave që rezultojnë nga aktiviteti I prodhimit, tregtimit dhe furnizimit me Energji elektrike.	05-10/08/2013	GSA dhe Hec LANabregas
Urdhër Nr 81, date 20/09/2013	Verifikimi I ecurisë së punimeve në sistemin skada	23.09/2013- 20.10/2013	OST sh.a
Urdhër Nr 87, date 07/10/2013	Konsumi I energjisë elektrike nga konsumatorët e kualifikuar.	29.10- 06.11/2013	OST sh.a, Cez Shperndarje sh.a
Urdhër Nr 88, date 07/11/2013	Zbatimi I vendimeve të ERE-s lidhur me energjinë mbifaturuar, dëmin ekonomik, faturat afrofe trajtimi I ankesave	06-08/11/2013	CEZ Shpërndarje sh.a(në administrim të përkohshëm)
Urdhër Nr 101, date 22/11/2013	Transaksionet e eksport/importit dhe shkëmbimet e energjisë për periudhën Janar Shtator -2013	25.11.2013- 06.12.2013	KESH sh.a
Urdhër Nr 102, date 22/11/2013	Realizimi I Planit të Investimeve për periudhën Janar-Tetor 2013	25.11.2013- 06.12.2013	KESH sh.a

2.1.2 Monitorimi i KESH sh.a.

Gjatë vitit 2013, ERE ka kryer monitorime kryesisht lidhur me import/eksportin dhe shkëmbimet e energjisë elektrike, realizimin e investimeve si dhe verifikimin e fluksit të parasë të shoqërisë KESH sh.a.

Nga monitorimet e transaksioneve që kanë të bëjnë me import/eksportin dhe shkëmbimet e energjisë elektrike është vënë re se:

Blerja dhe shitja energjisë elektrike është bërë duke iu referuar:

- Plotësimin të kërkesës për energji elektrike për klientët tariforë CEZ Shpërndarje sh.a, FPP;
- Parashikimin të prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a për çdo muaj;
- Parashikimin të prodhimit të HEC-eve të vegjël;

dhe në përputhje me “Rregullat dhe Procedurat e Blerjes së Energjisë Elektrike” miratuar nga ERE me Vendimin e Nr. 30, datë 23.03.2011, si dhe me “Rregullat dhe Procedurat e Shitjes së Energjisë Elektrike” miratuar nga ERE me Vendimin Nr. 1, datë 10.01.2011.

Përsa i përket shkëmbimeve të energjisë elektrike për vitin 2013 u konstatua se shkëmbimi i energjisë elektrike që KESH sh.a ka kryer me tregtarët është bërë në bazë të kontratave të nënshkruara. Këto kontrata janë në harmoni me dispozitat e përcaktuara në Modelin Shqiptar të Tregut të energjisë elektrike miratuar me VKM nr. 338, datë 19.03.2008 dhe me Rregullat e Tregut të miratuara me Vendimin nr. 68, datë 23.06.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Nga monitorimi i kryer për efekt të realizimit të investimeve në KESH sh.a për periudhën Janar – Shtator 2013, është konstatuar se niveli i realizimit të investimeve është i ulët, në masën rreth 17.49%. Arsyeja kryesore e këtij mosrealizimi ishte gjendja e vështirë financiare e Shoqërisë KESH sh.a si rezultat i mungesës së likuiditeteve, e cila erdhi si rezultat i situatës së krijuar në tregun e energjisë elektrike në vend (mungesa e pagesave nga CEZ Shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm dhe mosrakordimi i këtij të fundit me shoqërinë KESH sh.a), si dhe blerjes së humbjeve në rrjetin e shpërndarjes që kjo kompani u ka kryer.

Investimet në total, të realizuara nga KESH sh.a për periudhën Janar – Tetor 2013, me kosto të huaj dhe me kosto vendase të prokuruar rezultojë në vlerën 706.399.000 LEKE (pa tvsh), sipas tabelës dhe grafikut në vijim:

Table 19 Realizimi i Investimeve Janar-Tetor 2013

REALIZIMI I INVESTIMEVE JANAR-TETOR 2013 (000 LEKE)	PLANI I MIRATUAR NGA ERE	REALIZIMI NE VLERE ABSOLUTE	REALIZIMI NE %
KOSTO VENDASE	2,336,000	511,863	21.91
KOSTO E HUAJ	1,703,969	194,536	11.42
TOTAL	4,039,969	706,399	17.49




Figure 35 Investimet në total, të realizuara nga KESH sh.a për periudhën Janar – Tetor 2013

Nga monitorimi i kryer pranë shoqërisë KESH sh.a mbi fluksin e parasë për periudhën Janar – Shtator 2013 vërehet:

- Mosrakordim të dhënash midis KESH sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a për shlyerjen e detyrimeve për pagesat e energjisë elektrike;
- KESH sh.a nuk kryen pagesat ndaj prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike në mënyrë proporcionale.

Gjithashtu ERE ka kryer monitorim mbi transparencën e Operatorëve në Tregun e Energjisë Elektrike për vitin 2013 përfshirë KESH sh.a në të cilën vërehet se në faqen e internetit të KESH Sh.a nuk janë publikuar sipas kuadrit ligjor pikat si më poshtë vijojnë:

- ✓ Kërkesa për shitjen e energjisë elektrike (sasinë e energjisë elektrike MWh që ofrohet për shitje, grafikun ditor të lëvrimit, kohëzgjatjen e lëvrimit në ditë/javë/muaj, kriterin e vlerësimit të ofertave) që u drejtohet shoqërive të ndryshme, *bazuar në nenin 10, pika 2 të Rregullave dhe Proçedurave të shitjes së Energjisë Elektrike, miratuar nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s me vendimin nr. 1, datë 10.01.2011.*
- ✓ Çdo ftesë (sasinë e energjisë elektrike në MWh që kërkohet për t'u blerë, grafikun ditor të lëvrimit, kohëzgjatjen e lëvrimit në ditë/muaj/javë, periudhën e plotë kohore të lëvrimit të energjisë elektrike të përcaktuar në marrëdhëniet kontraktuale, pikën e lëvrimit të energjisë elektrike, kërkesat për kualifikimin në proçedurën e blerjes) për blerjen e energjisë elektrike në të njëjtën ditë që fton kompanitë e listuara prej tij, për të marrë pjesë në proçesin e blerjes së energjisë *bazuar në nenin 9, pika 2 të Rregullave dhe Proçedurave të blerjes së energjisë elektrike nga Tregtarët, miratuar nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s me vendimin nr. 30, datë 23.03.2011.*
- ✓ Ftesa/kërkesa për ofertë, raport përmbledhës ose njoftime të tjera me anë të të cilëve KESH sh.a njofton tregtarët e interesuar për pjesëmarrje në proçedurën e blerjes së energjisë elektrike si dhe shpallja e ofertave fituese/jo fituese *bazuar në nenin 19 të Rregullave dhe Proçedurave të blerjes së Energjisë Elektrike.*
- ✓ Të dhënat lidhur me proçedurën e shkëmbimit të energjisë (kërkesa për shkëmbimin e energjisë elektrike) *bazuar në nenin 9, pika 2 të Rregullave dhe Proçedurave të shkëmbimit të energjisë, miratuar nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s, vendim nr. 100, datë 27.12.2006, i ndryshuar.*

ERE ka kërkuar nga shoqëria KESH sh.a zbatimin e kuadrit ligjor për rritjen e Transparencës në Tregun e Energjisë Elektrike.

2.1.3 Monitorimi i OST sh.a

Gjatë vitit 2013 ERE ka kryer monitorime për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga liçensimi si dhe Rregullat e Tregut dhe akte të tjera ligjore në fuqi.

Plani i Investimeve

Realizmi i investimeve ka qenë një nga objektet e monitorimit të ERE-s. Nga monitorimi i investimeve në këtë kompani është vënë re se investimet në përgjithësi janë realizuar duke ndjekur planet afat-mesme me fonde të huaja si dhe planin e investimeve 2012-2014 miratuar nga ERE. Siç shihet nga tabela e mëposhtme, planet nuk janë realizuar sipas parashikimit për shkak të mos sigurimit në kohë të fondeve si dhe ka patur shmangie nga zërat e planeve për shkak të investimeve të detyrueshme për të realizuar sigurinë e sistemit.

Table 20 Investimet ne OST sh.a

Investimet ne OST sh.a (Million leke)	Programi i vitit 2013	I Pritshmi i vitit 2013	Programi i vitit 2014
Investime me fondet e veta	2,163	848	2,306
Investime me financime të huaja	4,500	2,812	3,336

Disbalancat

Duke marrë shkas nga rishikimi i Rregullave të tregut përsa i përket trajtimit të çështjes së tregut balancues, ERE ushtroi monitorim për këtë qëllim për vitin 2013. Në zbatim të ndryshimeve, mbi bazën e të dhënave orare të marra nga sistemi i matjeve i OST-së, janë bërë llogaritjet e disbalancave për secilin Pjesmarrës Tregu, në bazë orare. Çdo 10 ditë janë informuar nga OST sh.a Palët për disbalancat e kryera në mënyrë që të planifikojnë kompensimet përkatëse. Janë vlerësuar disbalancat e Palëve në bazë mujore, të cilat më pas u janë faturuar pjesmarrësve të tregut. Po kështu, në bazë mujore janë llogaritur dhe është kompensuar edhe shoqëria KESH sh.a për balancimin e Sistemit të Transmetimit. Në Tabelat dhe grafikët e mëposhtëm paraqitet një përmbledhje në total të volumeve të Devijimeve brenda tolerancës prej $\pm 4\%$ të Pjesmarrësve të Tregut, për periudhën Janar –

Dhjetor 2013. Disbalancat në këto kufi nuk penalizohen në vlera monetare por kompensohen nga të dy palët në energji.

Table 21 Disbalancat Positive dhe Negative të Pjesëmarrësve të Tregut për vitin 2013

		DISBALANCAT												
Muaji		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	SHUMA
Negative/MWh		290	331	169	35	69	348	97	148	411	31	801	723	3,454
Positive/MWh		11	99	309	11	1	240	536	521	244	1,744	737	1,121	5,613




Figure 36 Disballancat brenda zones ±4%

Ndërsa në Tabelën -22-dhe në Grafikun Nr.37 paraqiten penalizimet për Devijimet që kanë shkaktuar Pjesëmarrësit e Tregut, jashtë intervalit ±4% në MWh. Këto disbalanca

paguhen sipas Rregullave të Tregut të ndryshuara në bazë të vendimeve të Bordit të ERE-s.

Table 22 Penalizimet e Disbalancave Pozitive dhe Negative të Pjesëmarrësve të Tregut për vitin 2013

DISBALANCAT		
VITI 2013		
	DIS NEGATIVE	DIS POZITIVE
	MWh	MWh
Janar	1,114	380
Shkurt	734	433
Mars	672	1,837
Prill	252	427
Maj	351	375
Qershor	1,774	2,306
Korrik	1,435	1,842
Gusht	347	824
Shtator	531	663
Tetor	659	1,726
Nentor	580	1,612
Dhjetori	618	1,145
SHUMA	9,069	13,568




Figure 37 Disbalancat jashtë zonës ±4%

Alokimi i Kapaciteteve të Interkonjeksionit

Në lidhje me alokimin e kapaciteteve në interkonjeksione, për vitin 2013 janë bërë ndryshime tejet të rëndësishme, pasi ERE me Vendim nr 140, datë 22.11.2013 ka miratuar “Rregulloren mbi Alokimin e Kapacitetit në Interkonjeksione”. Për këtë arsye ERE ka kryer monitorime lidhur me alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit.

Në përputhje me vendimet e ERE-s, janë zhvilluar ankandet Mujore të ATC në interkonjeksion si edhe ankandi Vjetor i ATC, për periudhën 1 Qershor deri në 31 Dhjetor 2013.

Në Tabelën nr. 23 janë përmbledhur disa nga të dhënat e ankandit Vjetor, për periudhën 1 Qershor deri në 31 Dhjetor të vitit 2013.

Në ankandin vjetor paraqitën ofertat e tyre subjektet EFT, GEN-I, GSA, CEZ Albania, AXPO dhe DANSKE Commodities.

Në ankand janë paraqitur dhe vlerësuar 121 oferta, me një total prej 4.725.120 MWh, me një vlerë totale të ofertave prej 2.855.857 Euro, me një çmim mesatar të ofertave 0.68 Euro/MWh.

Kanë rezultuar fituese në ankand 52 oferta, me një total prej 1.766.400 MWh, me një vlerë totale prej 1.290.576 Euro, me një çmim mesatar prej 0.73 Euro/MWh.

Evidentojmë se kërkesa e pjesëmarrësve ka qenë më e shprehur në drejtimin export në Shqipëri, me një vlerë të ofertave prej 1.677.859 Euro, (58.7% e totalit të ofertave) me një çmim mesatar të ofertave 0.76 Euro/MWh.

Dominon kërkesa për export nga interkonjeksioni me Greqinë me një total prej 852.288 MWh (kundrejt 332.200 MWh të ofruar në ankand nga OST), me një vlerë totale të ofertave prej 1.410.691 Euro, me një çmim mesatar të ofertave prej 1.55 Euro/MWh.

Tendenca në çmimet e ankandit tregon preferencë të theksuar të pjesëmarrësve për drejtimin eksport në Shqipëri, me një çmim mesatar të ofertave prej 1.75 Euro/MWh përkundër çmimit mesatar të ofertave në drejtimin import për Shqipërinë prej 0.88 Euro/MWh. Në përfundim të ankandit nuk ka patur asnjë rezervë të shprehur të pjesëmarrësve, për procedurat dhe rezultatet e ankandit.

Table 23 Të dhënat e ankandit vjetor Qershor – Dhjetor 2013

Ankand Vjetor (Qershor-Dhjetor 2013)										
		AL-ME		AL-RS		AL-GR		TOTAL OST		
Vlera e Ofertave te Pjesmarresve	Euro	imp	exp	imp	exp	imp	exp	imp	exp	imp + exp
		899'715	201'192	253'522	65'975	24'759	1'410'691	1'177'997	1'667'859	2'859'857
Vlera e Ofertave Fituese	Euro	imp	exp	imp	exp	imp	exp	imp	exp	imp + exp
		485'760	70'656	115'920	25'392	13'248	579'600	314'928	675'648	1'290'576
Çmimi	Euro/MWh	1.10	0.16	1.05	0.23	0.04	1.75	Mesatar 0.70	Mesatar 0.88	Mesatar 0.78
Numri Ofertave te Pjesmarresve	Nr	26	20	18	16	15	26	59	52	121
Numri Ofertave Fituese	Nr	11	8	6	6	10	11	27	25	52

Në Tabelën nr. 24 janë përmbledhur të dhënat e ankandëve Vjetore dhe Mujore për periudhën 1 Janar deri në 31 Dhjetor 2013.

Table 24 Të dhënat e ankandëve Vjetore dhe Mujore për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor 2013

TOTAL-2013 (Ankande Mujore + Vjetor)										
		AL-ME		AL-RS		AL-GR		TOTAL OST		
Vlera e Ofertave te Pjesmarresve	Euro	imp	exp	imp	exp	imp	exp	imp	exp	imp + exp
		2'356'920	469'942	1'983'712	467'075	135'580	4'331'727	4'476'213	5'268'745	9'744'959
Vlera e Ofertave Fituese	Euro	imp	exp	imp	exp	imp	exp	imp	exp	imp + exp
		937'582	136'632	674'857	177'746	42'429	1'690'143	1'654'869	2'004'521	3'659'390

Çmimi	Euro/MWh	0.48	0.06	0.70	0.25	0.05	1.60	0.47	0.62	0.54
Numri Ofertave të Pjesmarresve	Nr	277	172	395	226	167	287	839	685	1'524
Numri Ofertave Fituese	Nr	148	144	193	116	110	125	451	385	836

Në grafikët e mëposhtëm janë përmbledhur të ardhurat për secilin kufi si dhe pesha në përqindje që ka zënë importi dhe eksporti në ankandet e kapaciteteve për vitin 2013.




Figure 38 Grafiku i të Ardhurave nga Ankandet 2013



Figure 39 Grafiku në përqindje sipas Drejtimit të Ankandëve 2013

Në ankandet mujore të zhvilluara nga shoqëria OST sh.a, nga 20 pjesëmarrësit e tregut të rregjistruar në OST, kanë marrë pjesë subjektet: Alpiq Al, Axpo Al, CEZ Al, EFT Al, Energy Supply, Danske Commodities, GEN-I Tirana, GSA dhe YLLIAD.

Në ankand janë paraqitur dhe vlerësuar 1.524 oferta, me një total prej 12.991.371 MWh, me një vlerë totale të ofertave 9.744.959 Euro, me një çmim mesatar të ofertave 0.85 Euro/MWh.

Kanë rezultuar fituese në ankand 836 oferta, me një total prej 6.293.526 MWh, me një vlerë totale prej 3.659.390 Euro, me një çmim mesatar prej 0.54 Euro/MWh.

Evidentojmë se kërkesa e pjesëmarrësve ka qenë më e shprehur në drejtimin eksport në Shqipëri, me një vlerë të ofertave prej 5.268.745 Euro, (54 % e totalit të ofertave) me një çmim mesatar të ofertave prej 0.99 Euro/MWh.

Janë fituar pa koxhestion, me çmim 0.00 Euro/MWh, në drejtimin export për Shqipërinë 65 oferta, me një total prej 390.946 MWh ndërsa në drejtimin Import për Shqipërinë 86 oferta, me një total prej 512.626 MWh.

Tendenca në çmimet e ankandit mujor tregon preferencë më të shprehur të pjesëmarrësve për drejtimin eksport në Shqipëri, me një çmim mesatar të ofertave prej 0.99 Euro/MWh kundrejt çmimit mesatar të ofertave në drejtimin import për Shqipërinë prej 0.73 Euro/MWh.

Ankandet e kapaciteteve në interkonjeksion janë zhvilluar nga komisioni përkatës i OST-së, në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara, si edhe me procedurat dhe udhëzimet apo vendimet përkatëse të ERE-s. Vlen të theksojmë në këtë kontekst se nuk ka pasur asnjë ankesë apo kundërshtim të Pjesëmarrësve të Tregut, pjesëmarrës në ankand, për: afatet, procedurat, procesin e zhvillimit të ankandit, procesin e vlerësimit të ofertave, përcaktimin e fituesve dhe çmimeve të ankandit, komunikimin dhe publikimin e njoftimit të ankandit dhe rezultateve të tyre. Nuk rezulton asnjë faturë e papaguar nga llogaritë e Pjesëmarrësve për kapacitetet e transmetimit në interkonjeksion të alokuara në ankand.

- Gjatë monitorimit mbi mekanizmin për llogaritjen e disbalancave të shkaktuara nga pjesëmarrësit e tregut si dhe zhvillimi i ankandëve ditore të kryer në OST sh.a gjatë 3 – mujorit të parë të vitit 2013, u evidentua se llogaritja e disbalancave është kryer

konform Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike në të cilën OST sh.a në fund të muajit përgatit faturat e detyrimeve të FK (Furnizuesve të Kualifikuar) dhe KESH sh.a.

Problem i vërejtur në ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë OST sh.a ka konsistuar në mos zhvillimin e ankandeve ditore dhe publikim të të dhënave që lidhen me kapacitetet ditore të interkonjeksionit në faqen e internetit të kompanisë për arsye të mungesës së platformës elektronike (*Soft-it*), por jepen në formën e alokimit ditor të kapaciteteve të mbetura nga ankandi mujor, të cilat publikohen çdo ditë në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë OST sh.a.

- Gjatë monitorimit mbi verifikimin e ecurisë së punimeve në sistemin SCADA u konstatua se:

Projekti është në fazën e kolaudimit, ndërkohë që ndërtesa e re e qendrës dispeçer dhe OST-së ka mbetur e pa përfunduar për shkak të falimentimit të kontraktorit. Sipas tratativave të kryera, ndërtesa është parashikuar të përfundojë në fillim të vitit 2015.

Monitorimi i ecurisë lidhur me këtë projekt është tepër i rëndësishëm pasi sistemi SCADA/EMS është një mjet i domosdoshëm për operimin në tregun rajonal të energjisë elektrike, për të cilin qeveria Shqiptare ka marrë angazhimet përkatëse pranë institucioneve të BE-së.

Sistemi mundëson marrjen dhe dërgimin e të dhënave në kohë reale me sistemet fqinje me të cilat OST sh.a ka lidhje interkoneksioni.

Vënia në operim e këtij projekti është kusht i domosdoshëm për operimin e sistemit tonë elektroenergjitik në paralel sinkron me rrjetin evropian të transmetimit në përputhje me të gjitha kriteret teknike, dhe është kushti i fundit teknik për antarësimin e OST sh.a në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për energjinë elektrike (ENTSO-E)

- Gjatë monitorimit mbi analizimin e furnizimit/konsumit të energjisë elektrike nga Konsumatorët e Kualifikuar u konstatua se:

Konsumi i klientëve të kualifikuar në raport me konsumin e përgjithshëm paraqitet si me poshtë vijon:

Table 25 Konsumi i Klientëve të Kualifikuar në Raport me Konsumin e Përgjithshëm

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	2013
Nevojat e vendit (MWh)	780,276	699,983	709,000	578,662	556,088	567,849	609,871	611,665	548,001				5,661,395
Konsumi i klienteve te Kualifikuar (MWh)	38,435	38,307	43,477	47,364	60,751	67,689	60,874	38,227	53,186		0	0	448,311
Pesha Specifike e kosumit te KK ne konsum (%)	4.9	5.5	6.1	8.2	10.9	11.9	10.0	6.2	9.7				7.9

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet krahasimi i konsumit të klientëve të kualifikuar gjatë vitit 2012 dhe 2013.




Figure 40 Konsumi Mujor i Klientëve të Kualifikuar gjatë vitit 2012 deri shtator 2013

Vihen re ndryshime të konsumit sipas muajve por duke krahasuar mesataret nuk vërehen ndryshime thelbësore. Gjatë monitorimit të kryer nuk u evidentua asnjë klient i furnizuar nga shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a që të kalonte konsumin vjetor prej 50 GWh dhe për pasojë të konsiderohej Klient i Kualifikuar.

- Gjithashtu në kuadër të monitorimit që ERE ka kryer mbi transparencën e Operatorëve të tregut të Energjisë Elektrike u konstatua se në faqen e internetit të OST Sh.a nuk janë publikuar sipas kuadrit ligjor pikat si më poshtë vijojnë:

1. Lista e palëve të regjistruara me informacion mbi emrin, numrin e identifikimit, datën e regjistrimit dhe statusin (tregtues, furnizues që furnizojnë me energji elektrike vetëm vendet e konsumit të tyre, datën e tërheqjes, datën e pezullimit, etj), sipas kapitullit III të pikës 3.5 të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike.
Sipas raportimeve që shoqëritë OST sh.a dhe KESH sh.a dërgojnë në ERE respektivisht mbi zhvillimin e ankandëve dhe transaksionet e import/eksportit të energjisë elektrike, rezultojnë se disa kompani tregtare që kryejnë aktivitetin e tyre në sistemin energjistik mungojnë në listën e palëve të regjistruara në faqen e internetit. Sa më sipër shoqëria OST sh.a duhet të përditësojë faqen e internetit me këto të dhëna.
2. Të gjitha kontratat e rregulluara që miratohen nga ERE, me qëllim që të mbrojnë palët kontraktuese nga risku i ndryshimit të çmimit përmbyllës të tregut, sipas Kapitullit V, pika 2.1 e Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike.
3. Të gjitha kufizimet e parashikuara në sistem që mund të ndikojnë mbi shumën e transaksioneve të nominuara nga pjesëmarrësit e tregut (kapitulli VI, pika 4.7 të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike).
4. Një listë që identifikon çdo Sistem Matës për të cilin kërkohet kontroll automatik dhe/ose komunikim, sipas Kapitullit XIV, pika 9.3 të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike.
5. Parashikimin e kërkesës ose ngarkesës pasi të bëhen të disponueshme sipas Kapitullit XVI, pika 5 (iv) të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike.
Parashikimi i kërkesës ose ngarkesës nuk rezulton plotësisht i publikuar në faqen e internetit pasi mungojnë publikimet për periudhën Shkurt – Maj 2013.
6. Parashikimin e gjenerimit ose injektimit pasi të bëhen të disponueshme, sipas Kapitullit XVI, pika 6 (iii) të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike.
Po ashtu edhe sa i përket gjenerimit ose injektimit nuk rezulton plotësisht i publikuar në faqen e internetit për arsye se mungojnë publikimet për periudhën Shkurt – Maj 2013.
7. Programet e lëvrimit për interkonjeksionet (Nominime) sipas procedurës përkatëse të OST-së dhe Rregullave të Tregut, Kapitulli XVI, pika 7 (ii).
8. Informacionin dhe publikimin sipas kapitullit XVI, pika 8 të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike për:
 - (i) Parashikimin e kërkesave për rezerva të llogaritura me formulën e Kodit të Rrjetit;

- (ii) Parashikimin për shërbimet ndihmëse të llogaritura me formulën e Kodit të Rrjetit;
 - (iii) Gjenerimin e disponueshëm – kapacitetin e pritshëm total të disponueshëm të gjenerimit;
 - (iv) Kërkesën maksimale të pritshme dhe kërkesën mesatare orare në MW për çdo muaj në vitin kalendarik;
 - (v) Vlerësimet e humbjeve në sistemin e transmetimit në GWh në bazë javore;
 - (vi) Vlerësimet e kufizimeve të paparashikuara në sistem në GWh në bazë javore;
 - (vii) Detajet mbi çdo situatë të parashikuar kur dhe ku do të kufizohet furnizimi.
- 9.** Publikimin 30 ditë përpara datës së zhvillimit të ankandeve vjetore për vitin pasardhës, të një skeme të përgjithshme për përllogaritjen e kapacitetit total të transmetimit (ATC) dhe të kapacitetit të sigurisë së linjës bazuar në realitetet energjetike dhe fizike të rrjetit, e cila do të jetë e vlefshme për vitin pasardhës sipas pikës 4 të Rregullave për Alokimin e Kapaciteteve të Interkonjeksionit.
- 10.** Vlerën aktuale të Tarifës së Aplikimit dhe Tarifës së Mbikëqyrjes bazuar në pikën 4.4, të Rregullores së Lidhjeve të Reja.

ERE ka kërkuar nga shoqëria OST sh.a zbatimin e kuadrit ligjor për rritjen e Transparencës në Tregun e Energjisë Elektrike.

2.1.4 Monitorimi i CEZ Shpërndarje sh.a

ERE ka ushtruar monitorime të shpeshta lidhur me realizimin e aktivitetit nga CEZ Shpërndarje sh.a pasi gjatë vitit 2013, me Vendim nr. Nr. 5, datë 21.01.2013 ERE vendosi shoqërinë CEZ Shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm. Kryesisht monitorimet e realizuara nga ERE konsistojnë në:

1. Numrin e ndërprerjeve, numrin e konsumatorëve të prekur nga ndërprerjet e energjisë elektrike, numrin e konsumatorëve pa matësa të energjisë elektrike, të dhënat lidhur me SAIDI dhe SAIFI për muajt Dhjetor 2012, Janar – Shkurt 2013
2. Realizimin e Planeve të Investimeve për periudhën Janar - Prill 2013;
3. Realizimi i targetave të humbjeve dhe plani i masave të hartuar nga kompania;

4. Gjendjen aktuale e matsave, kontratat per kontrollin dhe kolaudimin e tyre me kompanitë përkatëse dhe veprimet e tyre në terren;
5. Për trajtimin e situatës emergjente në rrjetin e shpërndarjes;
6. Cash Flow për periudhën Janar – Maj 2013;
7. Shpenzimet e realizuara për periudhën Janar – Maj 2013;
8. Ecuria dhe zbatimi i vendimeve të ERE-s, lidhur me dëmin ekonomik dhe reflektimi i tyre në sistemin e billingut;
9. Ankesat e trajtuara dhe treguesit e cilësisë së vazhdueshmërisë së furnizimit me energji elektrike;
10. Mbi transparencën në Treg të Operatorëve të Energjisë Elektrike.

Në mënyrë më të detajuar:

- Nga monitorimi i kryer lidhur me numrin e ndërprerjeve dhe mënyra e llogaritjes së indikatorëve të cilësisë së shërbimit u konstatua se bëhen përpjekje maksimale për identifikimin dhe riparimin e ndërprerjeve në kushtet e rrjetit të amortizuar, të konsumit me ngarkesa të mëdha dhe të mungesave të shumta në materiale riparimi. Indikatorët e performancës së cilësisë llogariten dhe raportohen vetëm për Tensionin e lartë dhe atë të mesëm. Saktësia e tyre do të mund të monitorohet më ndërtimin e sistemit SCADA i cili akoma mbetet i përealizuar nga kompania.
- Nga monitorimi i kryer nga ERE lidhur me realizimin e investimeve Janar – Prill 2013 u konstatua se Shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a nuk ka realizim investimesh si rrjedhojë e situatës emergjente të deklaruar nga ana e CEZ Shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm.
- Lidhur me targetet e humbjeve dhe planin e masave të hartuar nga kompania, ERE ka konstatuar një tendencë ulje të humbjeve totale deri në 39.52% në muajin Maj 2013. Shqetësues është fakti që është rritur numri konsumatorëve me konsum “0” me rreth 50 000 fatura nga 242 502 në muajin Mars, në 293 027 në muajin Prill. E shprehur në përqindje të numrit të konsumatorëve në total, vërejmë që konsumojnë “0” energji 20.9% e konsumatorëve në muajin Mars dhe 24.9% e konsumatorëve në muajin Prill 2013.
- Nga monitormi i kryer mbi gjendjen aktuale e matsave, kontratat për kontrollin dhe kolaudimin e tyre me kompanitë përkatëse dhe veprimet e tyre në terren, ERE ka udhëzuar:

- Përgatitjen e një studimi mbi gjendjen aktuale të matjes dhe një Plan Veprimi për arritjen e objektivave në drejtim të plotësimit me matje i të gjithë abonentëve si dhe kabinave, transformatorëve e fiderave deri në nivelin e tensionit të ulët.
- Përgatitjen e një studimi të gjendjes së sistemit të faturimit duke vendosur targete dhe afate kohore lidhur me eliminimin e anomalive, saktësimin e bazës së të dhënave, leximin periodik, faturimin etj.
- Saktësimin e propozimit për faturimin me llogaritje në përgjigje të kërkesës së ERE-s për këtë qëllim.
- Ndjekjen dhe raportimin e nivelit të zbatimit të kontratave me të tretët lidhur me kontrollin, verifikimin dhe kolaudimin e matësave si dhe të raportohet niveli i plotësimit të detyrimeve që ka shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm.

➤ Lidhur me monitorimin e kryer nga ERE të situatës emergjente në rrjetin e shpërndarjes rezultojnë se ndërhyrjet e kërkuara nga shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm gjatë periudhës Mars 2013 janë emergjente si:

- Rikonstrukcioni i pjesshëm i fiderit kabllor 10 kv nga nënstacioni i Lezhës në drejtim të Shëngjinit;
- Rikonstrukcioni i linjës 35Kv nga nënstacioni Shkodra 2 në drejtim të Velipojës;
- Ndërtim-montimi i fiderit 20 kv për mbulimin e zonës “Shkëmbi i Kavajës” në drejtim të Golemit nga Nënstacioni i Shkozetit;
- Ndërtimi i Linjës 20kv nga Saranda drejt zonës turistike të Ksamilit;
- Furnizim në rrjet të Tensionit të mesëm të Zonës së Lukovës;
- Zgjerimi i fiderit ajror F-5 20 kv nga Nënstacioni i Sallmonës në drejtim të Maminasit.

Këto janë punime të domosdoshme për rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike të zonave bregdetare të Velipojës dhe Lezhës, si një detyrim publik i CEZ Shpërndarjes, në administrim të përkohshëm.

➤ Lidhur me monitorimin e CASH FLOW për periudhën Janar – Maj 2013, ERE ka konstatuar se: Kompania ka patur tejkalime të disa zërave krahasuar me skedulin e pagesave të miratuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 22, datë

18.02.2013 dhe nga ana tjetër vërehet gjithashtu se disa zëra nuk janë realizuar në nivelin e miratuar nga ERE. Në përgjithësi peshën më të madhe të tejkalimeve të pagesave kundrejt skedulit të miratuar nga ERE e zenë pagesat për energjinë (KESH, OST, import energji e papaguar, import energjie). Këto tejkalime kanë ardhur si pasojë e mospagesave të shoqërisë në të kaluarën.

- Gjatë monitorimit të kryer lidhur me dëmin ekonomik dhe reflektimi i tyre në sistemin e billingut, kompania ka përcaktuar se për periudhën Janar 2011 – Maj 2013 janë regjistruar në total 11.074 ankesa me dëm ekonomik, ndër të cilat janë trajtuar 8.826 raste. Në mjaft raste, trajtimi i këtyre kërkesave është vështirësuar për shkak të pamundësisë së gjetjes së procesverbaleve të vendosjes së gjobave nga ana e strukturave të NTL-së. Të gjitha rastet e prapambetura po rigjykohen nga kompania në mënyrë që abonentët të marrin një përgjigje edhe për ankesat e regjistruara gjatë viteve 2011 – 2012.
- Mbi monitorimin lidhur me ankesat e trajtuara dhe Treguesit e cilësisë së vazhdueshmërisë së furnizimit me energji elektrike për periudhën Janar – Shtator 2013 ERE ka konstatuar se:

Nuk ka patur një angazhim të mjaftueshëm të kompanisë në drejtim të zgjidhjes së problematikave lidhur me ankesat e konsumatorëve.

Vihet re një numër i madh i ankesave për energjinë e pamatur, dëm ekonomik, matje jashtë kushteve teknike, mbifaturim, kontrata fiktive etj.

Vihet re se edhe nga raportimet periodike të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a., treguesit e cilësisë së shërbimit nuk janë paraqitur të detajuar siç kërkohen në rregullore.

Mospranimi i ankesave të konsumatorëve nga shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a (pa shkaqe të arsyeshme).

Moszbatimi i afateve kohore lidhur me trajtimin e ankesave, gjë që ka sjellë një fluks të madh të ankimesve të drejtuar në ERE.

Vihen re se në shumicën e rasteve proces-verbale të vendosura si: dëm ekonomik, matje jashtë kushteve teknike janë pa firmat e konsumatorëve të energjisë elektrike.

Konstatohen shumë raste të mosreflektimit në sistemin e *Billing*-ut të vendimeve të marra nga vetë shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a.

- Në lidhje me monitorimin e kryer nga ERE lidhur me transparencën në Treg të Operatorëve të Energjisë Elektrike për vitin 2013 vërehet se në faqen e internetit të CEZ Shpërndarje Sh.a (në administrim të përkohshëm), nuk janë publikuar sipas kuadrit ligjor pikat si më poshtë vijojnë:
 - ✓ Rezultatet e përpunuara të treguesve të cilësisë së vazhdueshmërisë së Furnizimit me energji elektrike për çdo zonë shpërndarje të klasifikuar brenda 31 Marsit të vitit pasardhës, *sipas nenit 17, pika 3 të Rregullores për Kushtet minimale të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike.*
 - ✓ Informacionet dhe të dhënat për shërbimet e kryera në vitin paraardhës, subjekte të niveleve të cilësisë tregtare të shërbimit, *sipas nenit 36, pika 3 të Rregullores për Kushtet minimale të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike.*

ERE ka kërkuar nga shoqëria CEZ Shpërndarje në administrim të përkohshëm zbatimin e kuadrit ligjor për rritjen e Transparencës në Tregun e Energjisë Elektrike.

2.1.5 Monitorimi i Operatorëve të tjerë të Energjisë Elektrike

Gjatë vitit 2013, ERE ka ushtruar monitorime edhe me shoqëritë si më poshtë vijojnë:

1. ***Shoqëritë “Albanian Green Energy” sh.p.k, “Balkan Green Energy” sh.p.k dhe “Favina 1” sh.p.k.***

Nga monitorimi i kryer në shoqëritë “Favina 1” në Hec “Vithkuq”, shoqërinë “Albanian Green Energy” për Hec “Smokthinë” dhe në shoqërinë “Balkan Green Energy “ (me përzgjedhje) në Hec-et “Barmash”, “Rajan”, “Borsh”, “Muhur” dhe “Arras”, u konstatua se në:

a) Hec “Vithkuq”

Eshtë bërë fuqizimi i kapacitetit të instaluar në dy faza.. Fuqia totale e instaluar mbas dy fuqizimeve është 2,715 MW. Për kryerjen e të gjitha punimeve nga shoqëria “Favina 1” janë shpenzuar rreth 420.000.000 leke.

b) Hec “Smokthinë”

Për riabilitimin e Hec “Smokthinë” është bërë rikonstruksion i pjesshëm i tij. Fuqia e instaluar në këtë Hec është 9,2 MW. Shpenzimet e kryera nga shoqëria “Albanian Green Energy” për riabilitimin e Hec “Albanian Green Energy” janë rreth 3.100.000 USD.

c) Hec “Barmash”

Eshtë bërë riabilitimi dhe fuqizimi i kapacitetit të instaluar. Nga riabilitimi dhe fuqizimi fuqia e instaluar në Hec është 830 KW. Vlera e investimeve për riabilitimin dhe fuqizimin e tij nga shoqëria “Balkan Green Energy “ është 949.193 Euro.

d) Hec “Rajan”

Eshtë kryer ripunimi (rikonstruksion) i plotë dhe fuqizim i tij. Janë zëvendësuar dy ish turbinat ekzistuese 2 x 150 KW (jashtë përdorimit) me dy turbina 1 x 800 KW dhe 1 x 250 KW. Fuqia e instaluar në këtë Hec është 1,050 MW. Vlera e investimit të kryer nga shoqëria “Balkan Green Energy“ për rikonstruksionin dhe fuqizimin e tij është 1.708.598 Euro.

e) Hec “Borsh”

Eshtë kryer riabilitimi (ripunim i pjesshëm) i tij. Eshtë riparuar turbina ekzistuese 250 KW dhe janë montuar panele të reja komandimi dhe disa punime të tjera në veprën e marrjes, kanalit të derivacionit dhe godinës së centralit. Vlera e investimit të kryer nga shoqëria “Balkan Green Energy“ për riabilitimin e tij është 259.241 Euro.

f) Hec ”Muhur”

Eshtë kryer riabilitimi (ripunim i pjesshëm) i tij. Turbina ekzistuese është riparuar dhe është rimontuar si dhe janë montuar panele të reja komandimi. Eshtë zëvendësuar gjeneratori ekzistues (jashtë përdorimit) dhe është montuar një gjenerator i ri 250 KW. Janë kryer rikonstruksione dhe riparime të tjera të pjesshme të centralit. Fuqia e instaluar e centralit është 250 KW. Vlera e investimit të kryer nga shoqëria “Balkan Green Energy “ për riabilitimin e tij është 359.425 Euro.

g) Hec “Arras”

Eshtë kryer riabilitimi dhe fuqizimi i tij. Janë ç'montuar tre turbinat ekzistuese (3 x 400 KW) dhe janë montuar katër agregatë të rinj (4 x 1200 KW) së bashku me panelet e komandimit. Janë rikonstruktuar totalisht veprat e marrjes dhe dy dekantuesit. Eshtë rikonstruktuar baseni i presionit dhe janë kryer riparime të pjesshme në kanalën e derivacionit si dhe është zëvendësuar tubacioni i presionit. Janë kryer punime riparimi dhe përshtatjeje në godinën e centralit. Fuqia e instaluar e centralit mbas fuqizimit është 4,8 MW. Vlera e investimit të kryer nga shoqëria “Balkan Green Energy“ për riabilitimin dhe fuqizimin e tij është 4.379.143 Euro.

2. Shoqëria “Projeksion Energji” sh.a.

Nga monitorimi i kryer pranë shoqërisë “Projeksion Energji” sh.a, ERE ka verifikuar se gjëndja e Hec-eve “Treskë”, “Rehovë” dhe “Carshovë kanë rezultuar si më poshtë vijojnë:

a. Hec “Rehovë”

Hec “Rehovë” i licensuar me fuqi 100 KW nuk u gjet në punë dhe nuk ka punuar që nga muaji Janar 2012.

b. Hec “Treska 1”

Ky Hec është licensuar nga ERE me fuqi 130 KW dhe nuk u gjet në punë. Në të ishin të montuar dy agregate me fuqi 125 KW secili, me të cilët Hec-i ka prodhuar energji deri në muajin Janar të vitit 2013 (sipas të dy ortakëve prezent në monitorim) dhe që nga kjo kohë është mbyllur si rezultat i mosmarrvëshjeve të ortakëve.

c. Hec “Carshovë”

Ky Hec është licensuar me fuqi 70 KW dhe sipas pohimit të dy ortakëve nuk është vënë asnjëherë në punë. Në këtë Hec nuk ekzistonte asnjë lloj pajisje, godina e vjetër e Hec-it ishte relativisht e amortizuar dhe janë bërë disa punime ndërtimi jashtë saj.

ERE ka vijuar të analizojë këtë problematikë duke vërjetur (dhe bërë me dije aksionerët) paraprakisht se problematika në funksionimin e këtyre HEC-eve lidhet me mosmarrvëshjet ndërmjet aksionerëve të “Projeksion Energji” Sh.a. Në bazë të ligjit nr.9072 datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, zgjidhja e këtyre mosmarrvëshjeve kapërcen autoritetin e ERE-s e cila ka përgjegjësinë për zgjidhjen e mosmarrvëshjeve midis të Licensuarve dhe jo midis aksionerëve të një subjekti të licensuar. Mosmarrvëshjet dhe veprimet e aksionerëve që kanë çuar në

keq funksionimin e hidrocentraleve nga kjo shoqëri, bazuar në kallëzimet penale dhe Paditë e aksionerëve ndaj njeri-tjetrit janë gjithashtu objekt gjykimi nga organi i Prokurorisë dhe Gjykata përkatëse.

3. Shoqëritë “Hera” sh.p.k, “ERS-08” sh.p.k dhe “E-Vento Albania” sh.p.k

Nga monitorimi i kryer pranë këtyre shoqërive lidhur me ecurinë e projekteve për parqet eolike u konstatua se:

- Për shoqërinë Hera sh.p.k janë montuar katër anemometra tubolar (dy në rrethin e Pogradecit në Cerrave dhe Vreshtas, dy në rrethin e Korçës në zonën e Kapshticës), që masin parametrat e shpejtësisë së erës në dy nivele lartësie. Investimi i deri tanishëm për Projektin “KAPPET” arrinë në shifrën rreth 1.025.000 EUR.
- Për shoqërinë “ERS-08” sh.p.k është montuar një anemometer me konstruksione, 60 m i lartë, pranë fshatit Peqinaj të komunës Synej të rrethit Kavajë, që bën matjen e parametrave të shpejtësisë së erës në katër nivele lartësie. Investimi i deri tanishëm për Parkun Eolik Kavajë arrinë në shifrën rreth 1.500.000 EUR.
- Për shoqërinë “E-Vento Albania” sh.p.k janë montuar gjashtë anemometra tubolar (dy në komunën Lukovë dhe katër në komunën Livadhja në rrethin e Sarandës), që matin parametrat e shpejtësisë së erës në dy nivele lartësie. Investimi i deri tanishëm për Parkun Eolik Sarandë arrinë në shifrën 1.592.600 EUR.

Këto shoqëri kanë siguruar kontrollin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të montuara prej tyre. Gjithashtu janë evidentuar investime të kryera nga subjektet në fjalë për qëllime të hapjes dhe përmirësimit të rrugëve që kanë bërë të mundur vendosjen e pasjisjeve dhe anemometrat si dhe në vijim sigurimin e kontrollit mbi to.

Kapitulli III

Aktiviteti i ERE në Zhvillimin e Legjislacionit Sekondar dhe Ndryshimet e tjera Ligjore të Ndodhura gjatë vitit 2013

Aktiviteti i ERE-s në Zhvillimin e Legjislacionit Sekondar dhe Ndryshimet e tjera Ligjore të Ndodhura gjatë vitit 2013

Hartimi i Rregulloreve, Udhëzimeve, Marrëveshjeve tip të shërbimit në zbatim të Ligjit nr.9072 datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Ligjit nr. 9946, datë 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, Ligjit nr.138/2013 “Per Burimet e Rinovueshme” Modelit te Tregut të Energjisë Elektrike, përbëjnë një nga përgjegjësitë e ERE –s për plotësimin e kuadrit rregullator të nevojshëm për funksionimin e tregut të energjisë. Veprimtaria e ERE-s gjatë vitit 2013 sikurse edhe në vitet e tjera natyrisht u fokusua edhe ne plotësimin më tej të kuadrit rregullator.

Në çdo rast hartimi, ndryshimi apo shtesa ne kuadrin rregullator të miratuar, ERE është bazuar në parimet e Transparencës (përpara çdo vendimmarrje palët ftohen të njihen paraprakisht me draft rregulloret apo aktet e tjera që ERE përgatit, duke marrë njëkohësisht dhe opinionin e tyre).

1.Aktet nënligjore të Miratuara nga ERE

Gjatë vitit 2013 ERE ka miratuar disa akte nënligjore.

1.1 Miratimi i Rregullores “Mbi Proçedurat e Emërimit të Administratorit dhe Kompetencat e tij”.

Pas vendimit për heqjen e licencës së kompanisë CEZ Shpërndarje, u bë i domosdoshëm hartimi i Rregullores “Mbi proçedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij, në zbatim të nenit 18, pika 4/c të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Kjo rregullore u miratua nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s me vendimin nr. 1, datë 10.01.2013 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 4, datë 29.01.2013 në zbatim të kërkesave të Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” Nr. 9072, datë 22.05.2003.

Në këtë rregullore janë përcaktuar proçedurat që duhet të ndjekë ERE për emërimin e administratorit si dhe të drejtat dhe detyrimet e tij gjatë periudhës së administrimit si në raport me shoqërinë ashtu edhe me ERE-n.

1.2 Miratimi i disa ndryshimeve në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike

Gjatë vitit 2013 nga ana e Bordit të Komisionerëve të ERE-s janë bërë disa herë ndryshime të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike.

ERE në zbatim të neneve 9 dhe 54, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, si edhe në kuadër të miratimit nga Kuvendi më datën 25.11.2011, të disa ndryshimeve në Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, punoi për hartimin e rregullave që lidhen me Tregun e Balancimit. Rregullat u konsultuan fillimisht edhe me grupet e interesit të tillë si:

- Shoqata e Furnizuesve të Kualifikuar Shqiptar,
- KESH sh.a
- CEZ Shpërndarje sh.a
- OST sh.a.

Ndryshimet në këto Rregulla u bënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 18, datë 11.02.2013, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 19, Datë 27.02.2013. Po ashtu gjatë vitit 2013, Rregullat e Tregut janë ndryshuar edhe me vendimin nr. 33, datë 10.04.2013, botuar në Fletoren Zyrtare nr. Nr. 62, datë 25.04.2013 dhe me vendimin nr. 147, datë 24.12.2013, i cili nuk është botuar ende në Fletoren Zyrtare. Këto vendime së bashku me Vendimin nr. 18, datë 11.02.2013 konsistojnë në shtyrjen e afatit të vendimit pararendës që ndryshonte këto rregulla në vitin 2012. (Vendimi nr. 93, datë 16.07.2012 i cili ndryshoi Rregullat e Tregut përsa i përket rregullave të balancimit. Me anë të këtij Vendimi u vendos detyrimi që disbalancat të llogariten me bazë orare dhe faturimi të bëhet me bazë mujore. Gjithashtu u vendos që disbalancat të llogariten të ndara në pozitive dhe negative, gjithashtu çmimi i Energjisë Balancuese llogaritet për çdo muaj si mesatare e ponderuar e çmimeve të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a ose në mungesë të tij të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga FPSH-ja prej Prodhuesve të Vegjël, HEC-eve të rinj konçesionar, të miratuar nga ERE plus 10% të

këtij çmimi, për disbalancat pozitive). Ky afat u shty duke specifikuar se: “Vendimi nr. 93, datë 16.07.2012, do ti shtrijë efektet deri në deri në 30 Qershor 2014. Këto vendime u kushtëzuan nga nevoja që një përpunim i mëtejshëm i rregullave të balancimit të reflektonte realisht specifikat e tregut shqiptar dhe përafrimin me legjislacionin evropian, në vlerësim të zhvillimeve të tregut në një kohë tjetër pas ndryshimeve të mundshme të Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike.

1.3 Miratimi i Skedulimit të Pagesave të CEZ Shpërndarje sh.a (në Administrim të Përkohshëm)

ERE në mbështetje të neneve 8, pika 2 dhe 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Vendimit nr. 5, datë 21.01.2013, “Për vendosjen e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a, në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a., në zbatim të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 4, datë 21 Janar 2013, “Për heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a.”, Rregullores “Për procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me Vendimin nr. 1, datë 10.01.2013, miratoi me vendimin nr. 22, datë 18.02.2013, botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 27, datë 08.03.2013, “Skedulimin e Pagesave të CEZ Shpërndarje sh.a”. Gjatë këtij miratimi nga grupi i punës u gjykua se paraqitja e një skedulimi të tillë do të japë sinjalet e duhura në treg, pasi në këtë mënyrë referuar edhe sa rënë dakort në seancën dëgjimore përkatëse, pritet që aktorët e tregut të cilët kanë bllokuar llogaritë bankare të kësaj shoqërie me anë të urdhrave të ekzekutimit të mund ti pezullojnë ato pas shfaqjes së vullnetit për kryerje pagesash.

1.4 Ndryshimi i Rregullave dhe Proçedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Energjisë së Rinovueshme

Nisur nga kërkesat e subjekteve që operojnë në fushën e prodhimit të energjisë me anë të burimeve të rinovueshme, ERE me vendimin nr. 43, datë 29.04.2013, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 87, datë 24.05.2013, bëri përshtatjen e rregullores së proçedurave të çertifikimit të prodhimit të energjisë elektrike me praktikat që përdoren në Itali, në mënyrë që ky proçes të jetë më i bashkërenduar me Autoritetet Italiane.

Këto përshtatje u bënë duke qënë se nuk kishte një rregullim për rastet e prodhuesve nga burime jo të rinovueshme nën 50 MW, të cilat mund të blejnë energji elektrike nga burime të rinovueshme dhe të cilat kanë të drejtën e përfitimit të certifikatave të gjelbra si dhe duke marrë në konsideratë edhe praktikat e vendeve fqinje apo edhe faktin se ERE në bazë të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“, të ndryshuar, dhe konkretisht neni 8, pika 2, gërma m/iv, autorizohet “*të hartojë dhe miratojë rregulla dhe procedura të veçanta për kualifikimin e centraleve prodhuese, që përdorin burime të rinovueshme të energjisë, si dhe për çertifikimin e energjisë së prodhuar prej tyre me “Certifikatën e garancisë së origjinës” dhe “Certifikatën e gjelbër”*. Po ashtu neni 39 i këtij ligji autorizon ERE për vendosjen e një procesi të ndërsjelltë çertifikimi për prodhimin nga burimet e energjive të rinovueshme, me institucionet homologe të vendeve të tjera nga ku importohet energjia elektrike.

1.5 Miratimi i Metodologjisë së Tarifave (Tap Tariff Code), të propozuar nga TAP AG, sipas Detyrimeve të Përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion”

ERE bazuar në Ligjin nr. 9946, datë 30.06.2008. “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, me vendimin nr. 127, datë 07.11.2013 botuar në Fletore Zyrtare Nr. 187, datë 02.12.2013, miratoi Metodologjinë e Tarifave (Tap Tariff Code), të propozuar nga TAP AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion”

Opinionin e Përbashkët Përfundimtar i rregullatorëve të tre vendeve, në pikën 4.2.1. i ngarkon Autoritetet Rregullatore të miratojnë Metodologjinë e Tarifave të TAP, e cila duhet të sigurojë që tarifat do të reflektojnë kostot efçente, do të jete transparente dhe jo-diskriminuese.

Për sa më sipër, TAP ka paraqitur për shqyrtim, komente e sugjerime pranë tre autoriteteve rregullatore draftin e parë të metodologjisë së tarifave të TAP (TAP Tariff Code) që në datën 24.04.2013.

Më pas TAP ka paraqitur në ERE për miratim në datën 14 Tetor 2013, me nr prot.500/11 versionin përfundimtar të metodologjisë së tarifave të TAP i quajtur ndryshe *TAP Tariff Code* i cili reflektonte komentet e bëra prej të tre Rregullatorëve.

1.6 Miratimi i Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit

Shoqëria OST Sh.a, propozoi për miratim në ERE draft Rregulloren për Alokimin e Kapaciteteve të Interkonjeksionit. ERE pasi proçedoi me botimin në gazetë të këtij propozimi dhe gjithashtu dërgimit për mendim të gjitha palëve të interesuara për këtë rregullore, bazuar në nenin 8, pika 2 dhe 9 e Ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratoi me vendimin nr. 140, datë 22.11.2013, botuar në Fletore Zyrtare nr. 193, datë 12.12.2013, Rregulloren e Alokimit të Kapaciteteve. Me miratimin e kësaj rregullore bëhen hapa përpara përsa i përket alokimit të kapaciteteve ditore, pasi më parë në ankandet ditore alokoheshin vetëm kapacitetet e pa dhëna në ankandet vjetore apo mujore. Ndërsa në rregulloren e re përcaktohet që të alokohen kapacitet që nuk do përdoren sipas deklarimeve të palëve. Kjo rregullore reflektoi gjerësisht rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë mbi rregullat e alokimit të kapaciteteve.

2.Zhvillimet ne legjislacionin primar në Sektorin e Energjisë Elektrike

2.1 Ligj Nr. 138/2013, “Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme”

Gjatë vitit 2013 nga Kuvendi i Shqipërisë është miratuar Ligji nr. 138/2013, “Për Burimet e Energjisë së Rinovueshme.”

Në zbatim të këtij ligji ERE, miratoi aktet nënligjore si më poshtë:

- “Kontratën Tip të Shit- Blerjes së Energjisë ndërmjet FPSH dhe PVE”
“Marrëveshjen Tip për Lidhjen në Rrjet të Gjeneruesve ”
- “Rregulloren për Lidhjen në Rrjet të Gjeneruesve”
- “Metodologjinë e Përcaktimit të Tarifave Fikse të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë”

- “Regjistrin Elektronik të Garancive të Origjinës nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë”
- “Rregulloren e Cilësisë së Shërbimit”,
- “Rregulloren e Procedurave për Aplikim për Garancinë e Origjinës”

Gjatë hartimit të këtyre akteve në mënyrë të veçantë gjatë hartimit të Metodologjisë së Përcaktimit të Tarifave fikse të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë janë ndeshur vështirësi që lidhen me disa paqartësi që kanë të bëjnë me:

Përcaktimin e subjekteve që duhet t’u adresohet kjo metodologji dhe për rrjedhojë edhe vendimet përkatëse të tarifave. Ligji nr. 138/2013 “Për Burimet e Rinovueshme” ka përcaktuar në gërmën rr) të nenit 3, si “Prodhues që kanë përparësi” çdo prodhues të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme me fuqi të instaluar deri në 15 MW për të gjitha centralet e ndërtuara prej shoqërisë i cili përfiton nga i) mekanizmi i tarifës fikse të shitjes (feed-in tariff) dhe ii) që kanë nënshkruar marrëveshje për blerjen e energjisë (PPA) me kompaninë që ka detyrimin të blejë energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme.

Nga ana tjetër deri më tani janë licencuar në përputhje me kontratat e konçesionit subjekte të ndryshme për ushtrimin e aktivitetit të prodhimit nga HEC –et e dhëna në konçesion ku disa prej këtyre subjekteve rezultojnë të kenë në konçesion centrale të cilat e kalojnë limitin e përcaktuar në Ligji nr. 138/2013 “Për Burimet e Rinovueshme”.

Këto subjekte kanë të përcaktuar në kontratën e konçesionit ndër të tjera të drejtën për të shitur energji KESH sh.a me çmime të rregulluara metodologjia e llogaritjes së çmimeve për të cilët tanimë është e papërcaktuar duke ditur që Ligji nr. 138/2013 “Për Burimet e Rinovueshme”, adreson llogaritjen e tarifës për kategorinë e prodhuesve nga centralet deri në 15 MW.

Shqetësuese është llogaritja e tarifës sipas grupeve duke ditur që subjekte të ndryshme që kanë marrë në konçesion më shumë se një central shpesh vihen në punë në intervale kohore të ndryshme ç’ka ndikon në rigrupimin dhe si të tillë në rilllogaritjen e tarifës brenda vitit ndërkohë që tarifatat vendosen një herë në vit.

Për proçedimin me tej në kuadër të përpunimit të Metodologjisë të sipërcituar dhe tarifave përkatëse për këto centrale ERE vlerësoi të nevojshëm qëndrimin e MEI e cila në komunikimin e saj me ERE kërkoi me qëllim sa më mire të interesave të investitorëve, pjestarëve të tregut, dhe të konsumatorëve fundor të energjisë elektrike në përputhje me politikat e qeverisë shqiptare për sa i takon kuadrit ligjor e nënligjor të energjive të rinovueshme, ERE të mos vijoj me proçesin e iniciuar për miratimin e metodologjisë së tarifave përkatëse si dhe tarifave fikse të energjisë për HEC-et me përparësi deri në një qëndrim përfundimtar të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

3. Trajtimi i Proçeseve Gjyqësore

Gjatë vitit 2013, nga ERE janë ndjekur edhe një sërë çështjesh gjyqësore që kanë patur zhvillim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Rezulton se numri i proçeseve gjyqësore që ERE ka ndjekur gjatë vitit 2013 ka qënë thujse i njëjtë me atë të një viti më parë.

Mosmarrëveshjet që janë trajtuar në këto gjykime kanë qënë kryesisht ankimime nga subjektet e liçensuara nga ERE dhe ankesa të qytetarëve (konsumatorëve) për mbifaturim të energjisë elektrike ku ERE është i thirrur si person i tretë.

Çështjet ku ERE ka qënë palë e paditur, respektivisht konsistojnë në:

- **CEZ Shpërndarje sh.a** në lidhje me ankimin e vendimit nr. 108, datë 21.01.2011, “Për Miratimin e Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike të Klientëve Familjarë” dhe i vendimit nr. 109, datë 21.01.2011, “Për miratimin e kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike të Klientëve Jo-Familjarë” – në proçes.
- **CEZ Shpërndarje sh.a** në lidhje me ankimimin e vendimit nr. 31, datë 31.03.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për Miratimin e Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumicë) dhe shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a (Furnizuesi Publik me Pakicë) për periudhën 01.01.2011 – 31.12.2011”- në proçes
- **CEZ Shpërndarje sh.a** në lidhje me ankimimin e vendimit nr. 102, datë 19.07.2012, “Për miratimin e Marrëveshjes së Transmetimit të Energjisë Elektrike midis OST sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a, për pikën 15.3 të Marrëveshjes.”- në

shkallë të parë ky gjyq është fituar nga ana e ERE-s. Pritet ankim i mundshëm nga ana e shoqërisë CEZ Shpërndarje.

- **CEZ Shpërndarje sh.a**, në lidhje me “Konstatimi i Pavlefshmërisë së Vendimit nr. 62, datë 22.07.2011, “Për Miratimin e Kontratës Tip për shërbimin e verifikimit, kontrollit periodik e fillestar të matësave të energjisë, si edhe Vendimit nr. 73, datë 09.08.2011, Mbi ankimimin e CEZ Shpërndarje sh.a të Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 62, datë 22.07.2011 “Për Miratimin e Kontratës Tip për shërbimin e verifikimit, kontrollit periodik e fillestar të matësave të energjisë elektrike.” – e fituar në shkallë të parë nga ana e ERE-s, pritët ankim.
- **CEZ Shpërndarje**, në lidhje me “1. Pezullim i ekzekutimit të Vendimit nr. 128, datë 11.09.2011 “Për proçedimin administrativ për vendosje gjobe ndaj shoqërisë CEZ Shpërndarje”, 2. “Deklarimi i pavlefshmërisë dhe anulimi i Vendimit nr. 128, datë 11.09.2011 “Për proçedimin administrativ për vendosje gjobe ndaj shoqërisë CEZ Shpërndarje” – e fituar në shkallë të parë nga ana e ERE-s.
- **CEZ Shpërndarje sh.a**, në lidhje me Anullim i pjesshëm i aktit administrativ të Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 110, datë 21.10.2011 “Për miratimin e rregullores për kushtet minimale të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike”, publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 165, datë 23.12.2011 – fituar në shkallë të parë nga ana e ERE-s.
- **KESH sh.a** në lidhje me ankimimin e kësaj kompanie të vendimit të ERE-s nr. 118, datë 28.12.2010 “Për mospranimin e ankesës së KESH sh.a për rishikimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 97, datë 07.12.2010, “Për Përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2011.”- E fituar në shkallë të parë nga ana e ERE-s, është ankimuar nga ana e KESH në Gjykatë të Apelit.
- **GEN – I Tirana sh.p.k** në lidhje me ankimimin e vendimit nr. 78, datë 22.10.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s - lidhur me miratimin e lidhjes së kontratave për shit – blerjen e energjisë për periudhën 01.01.2011 – 31.12.2011, midis shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a dhe shoqërive CEZ AS dhe EFT AG. –

Kjo çështje është fituar në shkallë të parë nga ana e ERE-s, pritet ankim i mundshëm i shoqërisë GEN – I Tirana sh.p.k.

Për të gjitha çështjet e ngritura në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe ato të ankimuara pranë kësaj gjykate, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatën Administrative, të gjitha këto çështje kalojnë për trajtim në Gjykatën Administrative.

Kapitulli IV

Veprimtaria e ERE në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit

Në bazë të Ligjit nr.9072 datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë ka vijuar punën në drjetim të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve të energjisë elektrike për të patur tarifa që reflektojnë parimet e vendosjes së tarifave siç përcaktuar në ligj, kushtet e shërbimit, si cilësia, eficiency qëndrueshmëria dhe siguria e furnizimit me energji elektrike të jenë të përshtatshme në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Po ashtu mbrojtja konsumatore është drejtuar edhe në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe të licencuarve, mbikëqyrjes së zbatimit nga kompania e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve tariforë të drejtave të konsumatorëve. Veprimtaria e mbrojtjes së konsumatorit gjatë vitit 2013 kryesisht ka konsistuar në :

1. Trajtimin dhe Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve.

Në bazë të Ligjit nr.9072 datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë ka vijuar punën në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve të energjisë elektrike për të patur tarifa që reflektojnë parimet e vendosjes së tarifave siç përcaktuar në ligj, kushtet e shërbimit, si cilësia, eficiency qëndrueshmëria dhe siguria e furnizimit me energji elektrike të jenë të përshtatshme në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Po ashtu mbrojtja konsumatore është drejtuar edhe në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe të licencuarve, mbikëqyrjes së zbatimit nga kompania e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve tariforë dhe të të drejtave të konsumatorëve në përgjithësi. Veprimtaria e mbrojtjes së konsumatorit gjatë vitit 2013 kryesisht ka konsistuar në :

Trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve

Trajtimi i ankesave në çdo rast ka vijuar të bazohet në parimet e përkushtimit transparencës dhe paanshmerisë sikurse dhe trajtimin brenda afateve ligjore të përcaktuara në legjislacion.

Nga të dhënat e administruara pranë ERE-s konstatohet se numri i ankesave të konsumatorëve për vitin 2013 është i konsiderueshëm por gjithsesi më i ulët se në vitin 2012. Kështu në vitin 2012 janë trajtuar 1720 ankesa ndërsa për vitin 2013 janë trajtuar 1359 ankesa.

Duhet theksuar fakti se ERE jep informacion dhe shpjegime dhe konsultime verbale dhe me e-mail dhe me telefon me shumë konsumatorë të cilët i drejtohen ERE-s lidhur me çdo problematikë mbi faturimet e energjisë elektrike apo në përgjithësi për informacione të tjera që lidhen me shërbimin e energjisë elektrike.

Ky numër i madh i ankesave lidhet me ndërgjegjshimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre që lidhen me shërbimin e furnizimit me energji elektrike këtë e dëshmon jo vetëm kërkimi i këtyre të drejtave por edhe përfshirja e konsumatorëve në procedurën e zgjidhjes dhe trajtimit të ankesave. Nga ana tjetër rregjistrimi i një numri të madh ankesash evidenton gjithashtu për një ulje të cilësisë së shërbimit të furnizimit me energji elektrike.

Ankesat e konsumatorëve kanë patur një spektër të gjerë objektsh të cilat kanë konsistuar kryesisht në shkelje të kushteve të përgjithshme të kontrave të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët familjarë dhe jofamiljarë.

Kontratat e furnizimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë dhe Jo familjarë miratuar me Vendimet e Bordit të Komisionerëve të ERE-s me Nr. 108 dhe Nr. 109, datë 21.10.2011 kanë të sintetizuara raportet e detyrimeve reciproke të konsumatorëve të energjisë elektrike dhe kompanisë “CEZ- Shpërndarje” sha me cilësinë e furnizuesit publik me pakicë.

Lidhur me detyrimet që i atribuohen kompanisë, ERE në referencë të Ligjit Nr .9072, datë 22.05.2003 ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike “ i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij ka analizuar ankesat e konsumatorëve duke konstatuar se pjesa më e madhe e ankesave konsiston në shkeljen e afatit të trajtimit të tyre siç është përcaktuar në pikën 6.10 të licensës së Furnizuesit Publik me Pakicë dhe të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Konsumatorët Familjarë dhe Jofamiljarë.

Në këto akte nënligjore është përcaktuar qartë se kompania do të marrë në konsideratë çdo ankesë dhe do ti përgjigjet me shkrim ankuesit nëse ankesa e tij është trajtuar brenda afatit 15 ditore (sipas nenit 6.10 të *Licensës së Furnizuesit Publik me Pakicë*) dhe në përputhje me afatin e përcaktuar në *Rregulloren e Trajtimit të Ankesave* të miratur nga ERE.

Në tabelën Nr.26 jepet në mënyrë të detajuar totali i ankesave të trajtuara nga ERE. Statusi i këtyre ankesave jepet i detajuar sipas: ankesa të zgjidhura 1050 (ku përfshihen ankesa për të cilat konsumatori ka marrë një zgjidhje përfundimtare); ankesa të refuzuara 43 (ankesa të cilat nuk janë objekt gjykimi për ERE-n) si dhe 266 ankesa të cilat janë në proces).

Analiza tregon se numri i ankesave të refuzuara është rreth 3%.

Table 26 Totali i ankesave të paraqitura në ERE për vitin 2013

MUAJI	TOTALI I ANKESAVE	TE ZGJIDHURA	NE PROCES	TE REFUZUARA
JANAR	142	83	56	3
SHKURT	187	131	55	1
MARS	131	102	25	4
PRILL	126	93	32	1
MAJ	130	106	17	7
QERSHOR	123	109	6	8
KORRIK	122	98	18	6
GUSHT	91	81	9	1
SHTATOR	102	84	15	3
TETOR	90	83	3	4
NENTOR	60	47	11	2
DHJETOR	55	38	14	3
Total 2013	1359	1055	261	43

Shënim: Në statusin e ankesave të zgjidhura raportet janë progresive, në muajt përkatës janë zgjidhur dhe ankesat e muajve të mëparshëm. Në totalin e ankesave shprehen ankesat e paraqitura në ERE të cilat i dërgohen kompanisë për të trajtuar në bazë të udhëzimeve përkatëse. Me statusin e ankesave të zgjidhura janë ankesat të cilat kompania i ka trajtuar në bazë të udhëzimeve të dhëna nga ERE dhe i

është kthyer përgjigje konsumatorit. Ndërsa me statusin e ankesave të refuzuara shprehen ankesat e refuzuara nga kompania duke u konsideruar si të përsëritura dhe trajtuara më parë.



Figure 41 Statusi i Ankesave të trajtuara nga ERE

- Një vend të konsiderueshëm kanë zënë ankesat me objekt “dëmin ekonomik” dhe “energji e pamatur”. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, ERE ka konstatuar se nga procesverbalet e lëshuara nga grupet e kontrollit të humbjeve jo teknike, se në pjesën më të madhe të kontrolleve janë kryer jo në prezencë të abonentit. Kjo procedurë bie ndesh me nenin 14.1 të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë si dhe me nenin III.7.7 të Kodit të Matjes. Gjithashtu kontrollet e ushtruara kanë qënë në bokse kolektive, bokse të cilat nuk janë në pronësi të abonentëve por në administrim të CEZ Shpërndarje. Konstatohen rreth 412 ankesa për “dëm ekonomik” dhe 298 ankesa për “energji të pamatur”.
- *Mbifaturimin* dhe *keqfaturimin* e energjisë elektrike. Në spektrin e ankesave një vend të konsiderueshëm zënë dhe ankesat në lidhje me *mbifaturimin* dhe *keqfaturimin* e energjisë elektrike që janë shkaktuar nga problematika të ndryshme si: mos rakordimi i gjëndjes së hedhur në sistem me gjëndjen reale të matësit, gabime njerëzore nga ana e faturuesve, vonesa në hedhjen e të dhënave të matësve të rinj në sistem. Këto problematika rrisin në mënyrë të konsiderueshme peshën financiare që iu ngarkohet abonentëve duke ulur nivelin e arkëtimeve. Të gjitha

këto shkaqe kanë sjellë që ankesat në lidhje me mbifaturimin dhe keqfaturimin e energjisë elektrike të jenë problematike edhe për vitin 2013. Për të gjitha këto ankesa, ERE ka kërkuar nga CEZ Shpërndarje informacionin e nevojshëm dhe verifikimin në vend të tyre. Më pas i janë dhënë udhëzimet përkatëse kompanisë “CEZ Shpërndarje” sha, duke i caktuar afate për zgjidhjen e tyre. Nga të dhënat e disponuara rezulton se 314 ankesa mbifaturim dhe keqfaturim.

- Ndërprerja e menjëhershme e energjisë elektrike. Një shkelje tjetër është fakti që menjëherë pas vendosjes së “*dëmit ekonomik*”, abonentëve iu është bërë ndërprerja e menjëhershme e energjisë elektrike duke i vënë përballë detyrimit të pagimit të vlerës së “*dëmit ekonomik*” pa e pasqyruar këtë vlerë në faturën përkatëse të energjisë elektrike, gjë e cila bie në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara në Kontratën e Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë, konkretisht me nenin 11.1 të kësaj kontrate ku citohet se “*Në mungesë të pagesës nga Klienti të faturës brenda 30 ditëve nga kalimi i afatit të caktuar për pagesë sipas neneve 9.1 dhe 10, Furnizuesit i lind e drejta që të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të Klientit, pasi e ka lajmëruar me shkrim këtë të fundit 48 orë përpara. Furnizuesi është i detyruar që të bëjë rilidhjen brenda 48 orësh nga kryerja e pagesës nga Klienti*”
- Në bazë të të dhënave që ERE disponon, për pjesën më të madhe të tyre nuk është kthyer përgjigje dhe nuk është bërë sistemimi përfundimtar i gjëndjes reale të leximit të matësit.
- Një problem tjetër i konstatuar është dhe mosrespektimi i afatit 30 ditor për leximin periodik të matësit.
Ankesat që janë paraqitur në ERE dhe në lidhje me problemet e mbifaturimit dhe keqfaturimit të energjisë elektrike, të cilat vijnë si pasojë e mosleximeve periodike të matësive të energjisë elektrike për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike, ashtu siç është përcaktuar dhe në nenin 7.1 të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë.
- Faturime dukshëm të gabuara. Janë verejtur faturime dukshëm më të medha se faturimet mesatare mujore të konsumatorëve (të krahasueshme ose më shumë se trefishi i faturimit mesatar mujor), kompania “CEZ-Shpërndarje”sha, nuk ka zbatuar nenin 12.6 të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë, ku përcaktohet qartë se “*Furnizuesi pezullon faturën dhe realizon me procedurë të përsheptuar verifikimin, anulimin dhe nxjerrjen e faturës së korrigjuar brenda 10 ditëve.*”

- Mos krijimi i aksesit të lirë për leximin e matësve nga ana e konsumatorëve.
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë, neni 7.3 i saj përcakton se *“Brenda datës 31 Dhjetor 2012, Furnizuesi është i detyruar të sigurojë aksesin e Klientit për leximin e lirë të aparatit matës në çdokohë”*. Lidhur me këtë fakt, ERE ka vërejtur se kompania “CEZ-Shpërndarje”sha, nuk ka marrë masat e duhura për zbatimin e nenit 7.3 të Kontratës.
- Kolaudimi i matësve të energjisë elektrike.
Problematikat për kolaudimin e matësve për vitin 2013, ka qënë me e zbehta në krahasim me vitin 2012(rreth 18 ankesa). Kjo, për shkak sepse këto ankesa kanë gjetur zgjidhje nga vetë kompania. Theksojmë këtu faktin se kolaudimi i matësve ka qënë i bllokuar gjatë vitit 2012 dhe të gjithë kërkesat/ankesat që i janë drejtuar “CEZ-Shpërndarje” sha, për verifikimin e saktësisë në matje të aparateve matës të energjisë elektrike nuk janë trajtuar nga kompania gjatë vitit 2012.
- Cilësia e furnizimit me energji elektrike.
Problematike gjithashtu ka rezultuar edhe cilësia e tensionit të furnizimit me energji elektrike. Kjo problematikë është ndeshur më shumë në Komunitat dhe subjekte të ndryshme private. Këto ankesa janë përcjellë në ERE në më të shumten e rasteve nga METE dhe Avokati i Popullit. Problemet me cilësinë e tensionit, janë të njohura dhe të pranuar nga CEZ Shpërndarje” sha (*në administrim të përkohshëm*). Nga ana jonë këto ankesa janë trajtuar duke organizuar seancë dëgjimore, në të cilat i është kërkuar CEZ-it informacion i detajuar lidhur me shkaqet e ndërprerjeve dhe kohëzgjatjen e tyre.
- Faturimi i energjisë elektrike për “matje jashtë kushteve teknike”.
Problematike është paraqitur gjithashtu situata e cila ka të bëjë me ndërrimin e matësve, të cilët janë jashtë kushtit teknik, brenda afateve të caktuara. Mosrespektimi i këtyre afateve ka sjellë ngarkimin e konsumatorëve me energji të faturuar për “matje jashtë kushteve teknike”, faturim i cili nuk është bërë në bazë të legjislacionit në fuqi. Kjo pasi në Kontratën e re për Furnizimin me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë, në Nenin 8, pika 2, citohet se *“nëse Furnizuesi nuk respekton afatin 30 ditor për vendosjen e matësit të rregullt, atëherë përgjegjësia është e Furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje tej këtij afati, do të jetë zero”*.

- Theksojmë faktin se janë ndeshur probleme lidhur me kontrata fiktive të hapura në mënyrë të njëanëshme nga ana e kompanisë. Këto kontrata janë kryesisht të dubluara me kontratat origjinale të klientëve ose janë kontrata të hapura në mënyrë të njëanëshme pa marrëveshje mes palëve. Rreth 38 ankesa të kësaj natyre janë trajtuar nga ERE dhe një pjesë e tyre janë reflektuar në sistemin e Billing-ut.
- Problemet e mbartura nga faturimet aforfe për periudhën 2007 –2009. Vazhdojnë të jenë problematike faturimet aforfe të mbartura prej viteve 2007-2010. Këto ankesa vazhdojnë të mbeten të patrajtuara nga ana e “CEZ Shpërndarje” sh.a, me justifikimin e mungesës së dokumentacionit të plotë nga ana e kompanisë. Flagrante janë rastet, në të cilat edhe pse faturimi i konsumatorëve është bërë dukshëm në kundërshtim me vendimet e miratuara nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s, *“Për miratimin e kohëzgjatjes për faturimin aforfe për abonentet familjarë pa matës të energjisë elektrike” për vitet 2007-2008-2009, nga ana e kompanisë CEZ Shpërndarje nuk janë marrë masa për të bërë anulimet përkatëse. Lidhur me këtë problematikë, për të zgjidhur ngërcin e krijuar si rezultat i mungesës së pajisjes me matësa për konsumatorët nga ana e kompanisë “CEZ-Shpërndarje” sha, ERE në Vendimin e Bordit të Komisionerëve me Nr. 146, datë 24.12.2013 vendosi: *Miratimin e aplikimit të faturimit aforfe për klientët familjare që nuk janë të pajisur me matësa të energjisë elektrike. Për konsumatorët me matësa të dëmtuar dhe jashtë kushtit teknik faturimi aforfe sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi aplikohet për një periudhë jo më shumë se 2 (dy) muaj.**
- Mosrespektimi i afateve të përcaktuara për lidhjen e kontratave të reja. Për këto raste konstatojmë vonesa në lidhjen e kontratave, mos transferim të kontratave për objektet që figurojnë debitorë. Nga ana jone është udhëzuar të bëhet lidhja e kontratave për të gjithë ata subjekte që nuk janë debitorë, udhezim i cili nuk është marrë parasysh nga ana e kompanisë.
- Duket shqetësues fakti i moskreditimit të pagesave të bëra për faturat e energjisë elektrike. Vazhdon të ndihet fenomeni i moskreditimit të abonentëve që megjithëse kanë kryer të gjitha pagesat e konsumit të energjisë, rezultojnë debitorë. Nga dokumentacioni që kemi shqyrtuar, kemi konstatuar se kemi të bëjmë me raste ku konsumatorët i kanë kryer pagesat kryesisht me bankë ose postë dhe në këto raste vërejmë mos rakordimin e faturave të paguara, por kemi edhe raste të kryerjes se pagesave në zyrat e shitjes dhe për të cilat mungon dokumentacioni i kryerjes së këtyre pagesave. Proçedura e ndjekur për këta konsumatore, ka qenë

kryerja e verifikimit në vend të Librezës origjinale apo pagesat e kryera në Arkë apo Bankë, me Sistemin e Billingut të “CEZ- Shpërndarje”sh.a, duke bërë me pas sistemimet e nevojshme.

ERE ka monitoruar dhe konstatuar se, trajtimi dhe zgjidhja e ankesave nga ana e Qëndrave të Kujdesit ndaj Klientit të “CEZ Shpërndarje”sha, rezulton të ketë ende probleme ku tipike vijon të jetë mosdhënia përgjigje brenda afatit të përcaktuar në “Rregulloren e Trajtimit të Ankesave” nga ana e Furnizuesit, të miratuara nga ERE. Mos dhënia e zgjidhjes së këtyre ankesave nga ana e “CEZ-Shpërndarje”sh.a, ka bërë që konsumatorët, në pjesën më të madhe të tyre, të paraqiten në ERE pas kalimit të afatit të kthimit të përgjigjes nga ana e CEZ Shpërndarje për zgjidhjen e ankesës.

Ndërkohë nga ana e “CEZ Shpërndarje”sh.a, është paraqitur në ERE informacioni i paraqitur në tabelën nr.27.

Table 27 Të dhëna Lidhur me Ankesat e Trajtuara prej Kompanisë CEZ Shpërndarje

Ankese/Kerkesat e trajtuara nga CEZ Shpërndarje gjate 2013 sipas zonave dhe statusit					
Zona	Mbyllur	Proces	Refuzuar	Zgjidhur	Total
Berat	9	1117	11	4925	6062
Burrel		284	14	2792	3090
Durres	14	4108	457	10606	15185
Elbasan	60	1189	512	6253	8014
Fier	1	5082	386	6755	12224
Gjirokaster	2	3295	5	3957	7259
Korce	81	946	204	5979	7210
Kukes		120	12	744	876
Shkoder	67	1080	106	5534	6787
Tirane	7	12301	434	31466	44208
Total	241	29522	2141	79011	110915

Sikurse vihet re dhe nga grafiku i figurës -42- prevalon numri i ankesave të zgjidhura për vitin 2013.




Figure 42 Grafiku i Trajtimit të Ankesave pranë CEZ Shpërndarje gjatë 2013

Table 28 Informacion Lidhur me Gjenerimin e Burimit te Ankesave

Ankese/kerkesat e ardhura me shkrese zyrtare ne zyrat gjate 2013 sipas statusit														
	Lloji i pergjigjes	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Sh t	Tet	Nent or	Dhjetor	Total
ERE	Proces		4	1	16	9	2	9		5	116	99	5	266
	Refuzuar		1	4	1						4			10
	Zgjidhur	23	66	148	232	117	95	108	29	72	127	32	1	1050
	ERE Total	23	71	153	249	126	97	117	29	77	247	131	6	1326
CEZ Shperndarje	Mbyllur			1	3			1						5
	Proces	44	1	3	4	6	1	4	5	17	36	147	153	421
	Refuzuar			8	2	4	2	2	4	4	3	1	1	31
	Zgjidhur	141	43	131	170	143	95	123	104	164	102	86	32	1334
	CEZ Total	185	44	143	179	153	98	130	113	185	141	234	186	1791
Av.Popullit	Proces	1								1	1	9	7	19
	Refuzuar		1									1		2
	Zgjidhur		5	3	1	7	2	5	2	5	2	3	1	36
	Av. Popullit Total	1	6	3	1	7	2	5	2	6	3	13	8	57
Total		209	121	299	429	286	197	252	144	268	391	378	200	3174

Table 29 Detajimi i Kërkesave dhe Ankesave pranë CEZ Shpërndarje 2013

DETAJIMI I KERKESAVE DHE ANKESAVE PRANE CEZ SHPERNDARJE 2013														
Tipi	Lloji i pergjigjes	Jan	Shk	Mar	Prill	Maj	Qer	Kor	Gush	Sht	Tet	Nen	Dhje	Total
Ankese	Mbyllur	28	29	13	3	2	4	7	9	8	4	4		111
	Proces	1083	1707	1232	1337	1312	818	1303	1382	1491	1454	1958	2252	17329
	Refuzuar	127	42	61	47	35	27	43	29	27	32	33	45	548
	Zgjidhur	3921	3374	3475	4187	3918	2858	3589	3033	3257	2936	2292	2406	39246
	Ank. Tot	5159	5152	4781	5574	5267	3707	4942	4453	4783	4426	4287	4703	57234
Kerkese	Mbyllur	25	9	6	13	21	19	13	16	4	4	4	1	135
	Proces	543	394	480	536	780	572	832	1044	1195	1593	1832	3098	12899
	Refuzuar	182	101	170	136	261	168	180	141	125	97	27	48	1636
	Zgjidhur	2583	3553	3147	3943	3684	3190	4705	4221	4281	3692	2898	2288	42185
	Kerk. Tot	3333	4057	3803	4628	4746	3949	5730	5422	5605	5386	4761	5435	56855
Grand Total		8492	9209	8584	10202	10013	7656	10672	9875	10388	9812	9048	10138	114089

ERE, ka konstatuar mangësi informacioni në raportimet e CEZ Shpërndarje, për mënyrën e trajtimit të ankesave, për kohën e kthimit të përgjigjes së konsumatorëve dhe për të dhënat e tjera të detyrueshme në marrëdhëniet e shoqërisë me klientët, detyrime këto të përcaktuara si në licensën për aktivitetin e “Furnizuesit Publik me Pakicë të Energjisë Elektrike” ashtu edhe në “Rregulloren e Trajtimit të Ankesave nga ana e Furnizuesit”, të miratuara nga ERE.

2. Informacioni në Faqen Zyrtare të Internetit

Aksesi në rrjet dhe komunikimi nëpërmjet faqes së Web-it, është zhvilluar duke ofruar një pasqyrë më të plotë e më të saktë të informacioneve dhe shërbimeve të ofruara. Nëpërmjet kësaj faqe sigurohet aksesi dhe plotësimi online i formularit të ankesave nga të gjithë të interesuarit, informacion i përditësuar mbi legjislacion primar dhe sekondar në sektorin e energjisë, të gjitha vendimmarrjet e ERE, rregjistrin e të

licensuarve, kushtet e licencimit, informacion të detajuar mbi kontratat e furnizimit me energji elektrike, mbi të drejtat dhe detyrimet respektive të palëve në tregun energjetik. Faqja web-i të ERE-s gjatë vitit 2013 ka vijuar të ofrojë informacione mbi mbledhjet e Bordit, gjithashtu edhe për vendimet përkatëse sikurse dhe për veprimtaritë e ERE-s në nivel kombëtar dhe rajonal.

3. Marrëdhëniet me Publikun Median e Shkruar dhe Vizive

ERE ka garantuar komunikimin me publikun e gjerë nëpërmjet deklaratave dhe njoftime për shtyp, komunikimeve intensive përmes mediave, publikimit të informacioneve që kanë të bëjnë me nivelin e shërbimeve nga pjesëmarrësit në sektorin e energjisë, dhe seancave dhe mbledhjeve publike të Bordit të Komisionerëve.

Për vitin 2013, komunikimi i ERE-s me median e shkruar dhe vizive, ka qënë në dinamikën e vazhdueshme. Ky komunikim është realizuar nëpërmjet pjesëmarrjes në emisione të ndryshme televizive, dhënies së informacionit përmes intervistave të shumta televizive, gazeta dhe revista, mbajtjes sistematikisht në kontakt nga drejtues të ERE, dhe vënies në dispozicion të të dhënave të kërkuara nga gazetarët që mbulojnë sektorin energjetik, konform respektimit të ligjit për informimin publik.

Vlen të theksojmë faktin se, ERE i është përgjigjur pozitivisht kërkesave të vazhdueshme të medias për sqarime rreth çështjeve të ndryshme, sidomos ndaj problematikave të kompanisë “CEZ-Shpërndarje”sh.a, por edhe ndaj zhvillimeve të projektit TAP, ku ERE ka rol të rëndësishëm.

Për vitin 2013, monitorimet në media për çështjet që prekin ERE kanë qënë të shumta, për shkak edhe të situatës së krijuar me CEZ, heqjes së licensës dhe vendosjes së saj në administrim të përkohshëm; raportimeve të CEZ Shpërndarjes në ERE, dhe zhvillimet të rëndësishme të projektit TAP (gazsjellësit). Theksojmë se për vete dinamikën e problematikën e sektorit energjetik në vend, monitorimit të tij, dhe sidomos zhvillimet e fundit lidhur me zbatimin e projektin TAP, është intensifikuar vëmendjen e medias ndaj rolit të ERE-s.

Projektet e shumta, në sektorë të ndryshëm kanë shkaktuar një ndjesi dhe reagim të medias në kohë të shpejtë, kurse drejtuesit e institucionit kanë respektuar median me kërkesat e tyre për ofrimin e informacioneve të ndryshme.

Gjatë periudhës së heqjes së licencave të “CEZ Shpërndarje” sh.a dhe vendosjes së saj në administrim të përkohshëm, kontakte me median janë realizuar gjithnjë e më të shpeshta ku kjo e fundit ka ndjekur e transmetuar direkt vendimarrjet e ERE-s lidhur me heqjen e licensave të CEZ Shpërndarje sh.a, vendosjes së saj në administrim të përkohshëm, përzgjedhjes së administratorit të kësaj kompanie nga ERE. Një interes të veçantë për median ka patur edhe vendimarrja e ERE-s përsa i takon Projektit TAP.

4. Komunikime me Pjesëtarët e Tregut

Gjatë zbatimit të përgjegjësiave dhe detyrimeve që burojnë nga legjislacioni bazë i sektorit të energjisë, me qëllim ekuilibrimin e interesave të shtetit, konsumatorëve dhe investitorëve, ERE ka vendosur një bashkëpunim me pjesëtarët e tregut në sektorin e energjisë elektrike për një koordinim më të mirë dhe transparent të tregut të energjisë. Bashkëpunimi kryesisht është realizuar nëpërmjet konsultimeve dhe takimeve me operatorët e tregut të energjisë elektrike të tillë si KESH, OST, CEZ Shpërndarje, Furnizuesit dhe Tregtarët. Një tjetër formë komunikimi ka vijuar të jetë përpunimi dhe dhënia në një kohë të shkurtër e informacionit të kërkuar nga subjektet e interesuara lidhur me çështjet e tregut të energjisë elektrike, legjislacionit dhe zbatimit të detyrimeve që burojnë prej tij.

5. Seancat Dëgjimore

Me qëllim dhe në referencë të zgjidhjes së ankesave, trajtimit të mosmarrëveshjeve midis të licensuarve dhe në procesin e hartimit të akteve nënligjore, si dhe në përputhje me parimin e transparencës së saj ERE, bazuar në “Rregulloren e Praktikës dhe Procedurave”, ka organizuar një sërë seancash dëgjimore. Rreth 46 seanca dëgjimore janë zhvilluar për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave duke bërë një grupim të problematikave të hasura. Qëllimi i këtyre seancave ka qënë ballafaqimi i shqetësimeve të gjithë aktorëve të tregut, dhe konsumatorëve të energjisë. Në këtë kuadër janë dhënë udhëzime nga ana e ERE-s, udhëzime të cilat janë të detyrueshme për pjesëmarrësit e tregut, për zgjidhjen e problemeve të konstatuara me konsumatorët apo ne mosmarrëveshjet ndërmjet të licensuarve.

Rreth 15 seanca dëgjimore janë organizuar me aktorët kryesorë të tregut të energjisë të tillë si “KESH”, “OST” dhe “CEZ-Shpërndarje”, AEES, të cilat kanë patur për objekt konsultimet për aktet rregullatore apo trajtimin e problematikave të ndryshme, te tilla si: propozimet për ndryshimet në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike; lidhur me shlyerjen e detyrimeve që kanë subjektet ndaj njeri-tjetrit dhe realizimi i një skedulimi të pagesave (KESH, CEZ Shpërndarje sh.a, EFT, Energji Ashta dhe AEES); problematikat lidhur me procedurat e importit të zhvilluara nga KESH sh.a; mbi propozimin e OST për Rregulloren e Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit; diskutime në lidhje me masat për situatën emergjente në rrjetin e shpërndarjes etj.

Një vëmendje e rëndësishme i është kushtuar seancave dëgjimore të zhvilluara ndërmjet kompanisë CEZ Shpërndarje sh.a dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të cilët janë ankuar kryesisht për mbifaturime, për faturimet në ambientet e përbashkëta: faturim të parregullt; faturimet e konsumatorëve me anomali; kontratat fiktive etj.

Seanca të tjera dëgjimore janë zhvilluar ndërmjet të licencuarve me objekt kryesisht: kontestime gjatë procedurave të licencimit; mbi draft marrëveshjen e shërbimit të transmetimit me OST; mbi mospagesat e KESH sh.a ndaj prodhuesve të vegjël dhe pezullimit të procedurave të vendosjes së sekuestros për llogari të KESH sh.a; mosmarrëveshjet ndërmjet KESH sh.a dhe Energji ASHTA për koordinimin e kaskadës në lumin Drin; mbi procesin e vulosjes së aparateve matës, përmbushjes së detyrimeve të prapambetura të zhvilluar midis CEZ Shpërndarje sh.a, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe HTT sh.p.k.

Gjatë këtyre seancave dëgjimore të zhvilluara në ERE, është siguruar një pjesëmarrje e gjerë si nga Ministria përgjegjëse për Energjinë, Autoriteti i Konkurrencës, përfaqësues të Kompanive publike, Shoqatat e Konsumatorëve si dhe subjekte të interesuara.

Lidhur me këto seanca ERE, në zbatim të nj procedurë transparente duke evidentuar dhe analizuar problematikat e vërejtura iu ka bërë të ditur të interesuarve qëndrimin e saj duke dhënë dhe rekomandimet përkatëse.

6. Treguesit e Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes dhe Shitjes së Energjisë Elektrike

Table 30 Treguesit e Cilësisë së Vazhdueshmërisë së Furnizimit me Energji Elektrike 2013

TREGUESIT E CILESISE SE VAZHJUESHMERISE SE FURNIZIMIT ME ENERGIJE ELEKTRIKE 2013																						
		SHKAKU I NDERPRERJES				NUMRI I Konsumatoreve te			Nderprerje te Planifikuara					Nderprerje te PaPlanifikuara				SAIFI	SAIDI	CAIDI	D1	
		Nderprerje e Planifikuar	Force Madhore	Pergjegjesi e paleve te treta	Pergjegjesi e CEZ	GJITHSEJ	ZONE URBANE	ZONE RURALE	Nr. Konsumatoreve te prekur GJITHSEJ	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone URBANE	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone RURALE	Nr konsumatoresh X Kohe	KOHEZGJATJIA (ore)	Nr. Konsumatoreve te prekur GJITHSEJ	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone URBANE	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone RURALE	Nr konsumatoresh X Kohe					KOHEZGJATJIA (ore)
Janar	Total TL	8	5	22	108	1,163,467	589,633	573,834	28,040		28,040	50,210	13	617,099	175,606	441,493	2,931,015	1,194	0.6	2.6	4.6	4.7
	Total TM	65	30	11	2,495	1,163,467	589,633	573,834	71,353	10,947	60,406	190,342	167	3,410,422	648,073	2,762,349	11,755,606	19,558	3.0	10.3	3.4	3.4
Shkurt	Total TL	24	6	27	130	1,163,467	589,633	573,834	275,681	71,423	204,258	2,090,795	119	909,619	319,019	590,600	1,671,401	370	1.0	3.2	3.2	1.8
	Total TM	25	82	22	2,474	1,163,467	589,633	573,834	28,707	5,409	23,298	91,759	4	3,050,142	560,278	2,489,862	16,534,983	29,351	2.6	14.3	5.4	5.4
Mars	Total TL	9	10	24	119	1,163,467	589,633	573,834	22,115	1,303	20,812	31,556	13	913,976	337,034	576,942	2,155,737	553	0.8	1.9	2.3	2.4
	Total TM	13	97	41	2,689	1,163,467	589,633	573,834	12,887	4,543	8,344	29,666	1	3,501,967	785,813	2,726,154	7,768,458	13,689	3.0	6.7	2.2	2.2
Prill	Total TL	52	5	40	81	1,163,467	589,633	573,834	205,329	65,648	139,681	587,014	138	662,733	236,649	426,094	1,961,756	460	0.7	2.2	2.9	3.0
	Total TM	84	35	76	2,545	1,163,467	589,633	573,834	63,738	12,344	51,394	252,697	238	3,307,152	941,707	2,360,475	5,384,590	9,577	2.9	4.8	1.7	1.6
Maj	Total TL	71	4	42	85	1,163,467	589,633	573,834	328,423	109,318	219,105	940,785	198	812,370	289,355	523,015	2,148,049	434	1.0	2.7	2.7	2.6
	Total TM	218	177	66	3,543	1,163,467	589,633	573,834	326,668	89,373	237,295	592,032	459	5,079,517	1,309,866	3,770,550	8,914,706	13,424	4.6	8.2	1.8	1.8
Qershor	Total TL	26	7	24	99	1,176,737	596,000	580,737	179,799	18,977	160,822	1,269,073	177	846,401	324,782	521,617	1,784,106	351	0.9	2.6	3.0	2.1
	Total TM	134	62	70	2,606	1,176,737	596,000	580,737	169,257	158,283	519,951	240,537	235	3,968,419	1,140,951	2,827,468	4,246,079	6,032	3.5	3.8	1.1	1.1
Korrik	Total TL	78	41	15	139	1,176,737	596,000	580,737	265,681	104,586	161,296	689,043	209	660,418	124,362	536,356	2,404,494	692	0.8	2.6	3.3	3.6
	Total TM	126	133	20	2,692	1,176,737	596,000	580,737	172,184	27,989	144,192	293,207	239	3,892,193	1,068,158	2,821,764	4,381,573	8,618	3.5	4.0	1.2	1.1
Gusht	Total TL	78	41	15	139	1,176,737	596,000	580,737	265,681	104,586	161,296	689,043	209	660,418	124,362	536,356	2,404,494	692	0.8	2.6	3.3	3.6
	Total TM	132	257	21	3,084	1,176,737	596,000	580,737	162,656	30,950	131,706	276,807	249	4,531,259	1,113,785	3,417,474	7,737,329	9,509	4.0	6.8	1.7	1.7
Shtator	Total TL	53	38	0	164	1,176,737	596,000	580,737	192,630	40,580	152,050	552,450.4	231.44	1,018,795	248,609	770,186	2,511,906.5	835.35	1.0	2.6	2.5	2.5
	Total TM	238	170	26	3,108	1,176,737	596,000	580,737	281,235	51,973	229,462	958,551.3	815.05	4,683,497	1,438,446	3,246,051	7,784,117.86	9,700.2	4.2	7.4	1.8	1.7
Tetor	Total TL	51	190	19	122	1,176,737	596,000	580,737	164,109	42,458	121,643	403,633	112	1,033,894	274,495	759,399	3,187,967	829	1.0	3.1	3.0	3.1
	Total TM	211	45	9	2,767	1,176,737	596,000	580,737	232,982	37,613	195,419	613,160	631	4,927,817	1,832,241	3,095,758	7,412,548	8,273	4.4	6.8	1.6	1.5
Nentor	Total TL	56	15	50	91	1,176,737	596,000	580,737	180,825	40,465	140,360	561,898	146	786,690	194,753	591,937	3,043,209	890	0.8	3.0	3.7	3.9
	Total TM	143	63	36	2,895	1,176,737	596,000	580,737	164,202	30,548	133,654	408,026	392	3,890,446	750,832	3,139,611	7,065,483	11,204	3.4	6.4	1.8	1.8
Dhjetor	Total TL	35	5	63	129	1,176,737	596,000	580,737	88,354	9,784	78,570	209,484	93	1,262,296	362,127	900,169	4,697,402	1,334	1.1	4.2	3.6	3.7
	Total TM	154	74	17	3,013	1,176,737	596,000	580,737	190,719	38,587	152,082	402,345	346	3,994,530	927,140	3,126,507	6,205,780	8,897	3.6	5.6	1.6	1.6

Enti Rregullator i Energjisë ka miratuar një sërë aktesh me qëllim specifikimin e treguesve të cilësisë së shërbimit të ofruar konsumatorëve.

Çdo muaj CEZ Shpërndarje raporton treguesit e indikatorët e Cilësisë së Shpërndarjes të cilat janë grupuar në tabelën Nr.30 dhe të pasqyruar e sintetizuar dhe në tabelën Nr.31.

Vazhdueshmëria e shërbimit të transmetimit të energjisë në linjat e Tensionit të Mesëm gjatë vitit 2013, e matur sipas indikatorëve përkatës të energjisë, është karakterizuar nga një numër total prej 37094 ndërprerjesh. Këtu përfshihen edhe ndërprerjet e parashikuara.

Në tabelën që vijon jepen të dhënat përkatëse:

Table 31 Treguesit e Cilësisë të Pasqyruar e Sintetizuar

Tab. 1 Ndërprerje viti 2013

SHKAKU I NDËRPRERJES Viti 2013				
Total TM	Nderprerje e Planifikuar	Force Madhore	Pergjegjesi e paleve te treta	Pergjegjesi e CEZ
		1 543	1 225	415

Të dhënat: CEZ

Ku TM: Tension i Mesëm

Tab. 2 Ndërprerje të planifikuara

Numri i Konsumatorëve të prekur dhe kohëzgjatja (ndërprerjet në Tension të Mesëm (TM))					
Total TM	Konsumatorë të prekur GJITHSEJ	Konsumatorete prekur Zone URBANE	Konsumatorë të prekur Zone RURALE	konsumatorë X Kohe	KOHEZGJATJA TJA (ore)
		1 876 588	498 559	1 887 203	4 349 130

Sic shihet edhe nga tabela më sipër gjatë vitit 2013 janë prekur në total një numër prej 1.876.588 konsumatorësh me një kohëzgjatje totale prej 3.775 orësh.

Tab. 3 Ndërprerje të paplanifikuara

Numri i Konsumatorëve të prekur dhe kohëzgjatja (ndërprerjet në Tension të Lartë (TL))					
Total TL	Konsumatorë të prekur GJITHSEJ	Konsumatorete prekur Zone URBANE	Konsumatorë të prekur Zone RURALE	konsumatorë X Kohe	KOHEZGJATJA TJA (ore)
		48 237 361	12 517 290	35 784 023	95 191 254

Në tabelat sa sipër bie në sy që konsumatorët më të prekur si nga ndërprerjet e planifikuara dhe ato të paplanifikuara janë konsumatorët e zonave rurale. Konsumatorët e prekura në këto zona janë mbi trefishin e konsumatorëve të zonave urbane.

Tab. 4 Raportet dhe kohezgjatjet për klient në Tension të Mesëm

Total TL	SAIFI	SAIDI	CAIDI	D1
	konsumatorë të prekur nga ndërprerjet/ Kons.Gjithsej	orë ndërprerje gjithsej/Konsumatorë Gjithsej	Orë ndërprerje gjithsej/Kons. Te prekur nga ndërprerjet	Kohëzgjatja totale për një klient te prekur nga ndërprerjet e paplanifikuara
	43	85	25	25

Ku SAIFI: System Average Interruption Frequency Index

Ku SAIDI: System Average Interruption Duration Index

Ku CAIDI: Customer Average Interruption Duration Index

Pavarësisht se ERE ka ushtruar monitorim periodik të informacioneve dhe ka kryer sondazhe për mënyrën e evidentimit dhe llogaritjes së tyre përsëri saktësia e raportimeve do të çalojë deri në vendosjen e sistemit SCADA për Shpërndarjen.

Ashtu siç shihet në tabelë nuk mund të llogariten treguesit e cilësisë në Tension të Ulët.

Kapitulli V

Marrëdhëniet Ndërinstitucionale dhe Ndërkombëtare të ERE-s

1. Veprimtaria Ndërinstitucionale dhe Ndërkombëtare e ERE-s

Një rëndësi të veçantë edhe gjatë vitit 2013 ju kushtua marrëdhënieve ndërinstitucionale brenda vendit dhe marrëdhëniet ndërkombëtare multilaterale dhe bilaterale. Për vitin 2013 është punuar shumë që ERE të përfaqësohet denjësisht në arenën ndërkombëtare dhe në forcimin e rolit të saj pranë institucioneve ku aderon.

Kryesisht ERE ka ndarë informacione dhe qëndrime me Kuvendin e Shqipërisë, Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës, Ministrinë e Integritit, Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Popullit, si dhe institucione të tjera të cilat operojnë në republikën e Shqipërisë veprimtaria e të cilëve lidhet në një masë të caktuar me çështje të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

1.1 Marrëdhëniet e ERE-s me Kuvendin e Shqipërisë

Për vitin 2013 ERE sikurse dhe më parë ka vazhduar të ndjekë në mënyrë intensive bashkëpunimin, me Kuvendin duke realizuar një informim periodik dhe duke pasqyruar hap pas hapi veprimtarinë institucionale në zbatim të vendimit të Byrosë së Kuvendit No 29 datë 09.02.2008 “Për ngritjen e Shërbimit të Monitorimit të institucioneve që raportojnë dhe informojnë Kuvendin”. Në kuadër të këtij vendimi punonjësi i autorizuar përgjegjës për kryerjen e këtij shërbimi pranë ERE-s ka ndjekur nga afër dhe është njohur në mënyrë të detajuar me veprimtarinë e ERE-s, si dhe ka asistuar në mbledhjet e Bordit të Komisionerëve.

Nga ana e tij Kuvendi i Shqipërisë është informuar mbi zhvillimet aktuale në sektorin e energjisë, ku përveçse është bërë paraqitja e Raportit vjetor në Kuvend, ERE ka dërguar informacion në drejtim të çështjeve të mprehta që kishin të bënin me Tregun e Energjisë, me procesin e post-privatizimit, heqjes së dy licencave të Kompanisë CEZ Shpërndarje dhe vendosjes së saj në administrim të përkohshëm, si dhe për çmimet dhe tarifat e energjisë elektrike.

Gjithashtu ka vijuar edhe gjatë këtij viti dhënia e informacioneve të kërkuara nga deputete të Kuvendit.

1.2 Marrëdhëniet e ERE-s me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI)

ERE ka bashkëpunuar dhe bashkërenduar një pjesë të punës së saj me MEI-n gjatë vitit 2013 për zgjidhjen e shumë problemeve dhe sfidave të ndryshme të ndeshura gjatë procesit të rregullimit të sektorit të energjisë në Shqipëri.

ERE ka kontribuar qoftë përmes propozimeve të dala prej saj apo përmes dhënies së opinionëve të ndryshme të propozuara, por edhe nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në Grupet ndërinstitucionale të Punës për rishikimin e Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike, të Ligjit të energjive të rinovueshme, të Projekt-Ligjit të Konçesioneve. Pjesëmarrje si anëtar gjatë procesit të privatizimit të Hidrocentraleve Bistrica 1,2 dhe Hidrocentraleve Ulëz, Shkopet.

Intensivisht ERE ka komunikuar me MEI në lidhjen me proceset që duhet të vijojnë në kuadër të vendimeve të ERE për heqjen e licensave të kompanisë CEZ Shpërndarje po ashtu dhe problemeve të ndryshme të lindura gjatë vitit 2013.

ERE do të vazhdojë ta vlerësojë dhe do ta ketë një ndër përparësitë e saj bashkëpunimin me MEI-n. Gjithashtu ERE ka qënë anëtare e rregullt e Grupit të punës të ngritur nga ana e MEI-t për Plotësimin e Pyetesorit të BE-së mbi Kapitullin e Energjisë.

1.3 Marrëdhëniet e ERE-s me Ministrinë e Integritit

Për vitin 2013 ERE ka vijur komunikim dhe bashkëpunim me Ministrinë e Integritit në lidhje me Komitetin e Stabilizim Asociimit, për përditësimin e informacioneve në lidhje me Planin kombëtar, për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit për periudhën 2010-2014. Në kuadër të kësaj ERE ka rishikuar aktet e parashikuara në PKZMSA dhe ka kontribuar për plotësimin e kërkesave që vijojnë nga Direktivat e BE-së. Këto kërkesa vijnë si rrjedhojë e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe për plotësimin e Direktivës 54/2003.

1.4 Marrëdhëniet e ERE-s me Autoritetin e Konkurrencës

ERE i ka bazuar marrëdhënien e saj me institucionin e Autoritetit të Konkurrencës në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet ERE-s dhe Autoritetit të Konkurrencës që prej datës 17.01.2007. Përgjatë vitit 2013 është bashkëpunuar ndërmjet dy institucioneve tona për shmangien e shkeljes së konkurrencës nga ana e operatorëve, gjithashtu duke krijuar dhe rregulla konkurruese në mbrojtje të interesave të konsumatorëve. Institucioni jonë ka kërkuar rregullisht mendimin nga ana e Autoritetit për aktet nënligjore që lidhen me zhvillimin e tregut të energjisë përpara se këto të miratohen nga ERE.

ERE ka infomuar Autoritetin e Konkurrencës mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ky insitucion në lidhje me sektorin e energjisë elektrike. Nga ana e saj ERE i ka dërguar të gjitha aktetet e saj nënligjore Autoritetit të Konkurrencës për dhënien e një mendimi përpara miratimit të tyre, si dhe ka marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga ky institucion. Komunikimi, shkëmbimi i informacionit dhe të dhënave ndërmjet të dy institucioneve do të vijojnë dhe në të ardhmen, duke u bazuar në vullnetin e gadishmërisë së ndërsjelltë.

1.5 Marrëdhëniet e ERE-s me Avokatin e Popullit

Si bazë e marrëdhënieve të ERE-s me Avokatin e Popullit është angazhimi i përbashkët institucional në drejtim të mbrojtjes së konsumatorëve fundorë të energjisë elektrike në përputhje me përgjegjësitë që respektivisht kanë sipas legjilsacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve. Në kuadër të kësaj, ERE është kujdesur të mbaj marrëdhënie të afërta institucionale me Avokatin e Popullit duke realizuar dhe takime të përbashkëta në drejtim të shkëmbimit të mendimeve dhe dhënies së sqarimeve të nevojshme për cilësinë e shërbimeve të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve dhe për ankesat në lidhje me faturat e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve.

2. Marrëdhëniet Ndërkombëtare

ERE ka si prioritet të saj përfaqësimin sa më dinjitoz të vendit në aktivitete rajonale dhe ndërkombëtare, me qëllim që të ketë një përputhje dhe harmonizimin të praktikave të saj me praktikat e vendeve të BE-së. Pjesëmarrjen në aktivitetet ndërkombëtare është konsideruar nga ERE si një element që i shërben forcimit institucional, rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj. Për këtë arsye mund të përmendim aktivitetin

dhe rolin e ERE-s në anëtarësimin dhe pjesëmarrjen aktive në organizatat ndërkombëtare, në oganizmin e konferencave ndërkombëtare, në bashkëpunimin me insitucionet e tjera për organizmin e eventeve ndërkombëtare, workshopeve apo takimeve multilaterale dhe bilaterale.

Gjatë vitit 2013 institucioni jonë ka punuar në menyrë intensive për realizimin e bashkëpunimeve të frytshme në dobi të sektorit energjitik të vendit. Duke patur këto prioritete të qarta, ERE u anëtarësua vitin e kaluar pranë Unionit Internacional të Gazit (IGU), dhe ka vazhduar marrëdhëniet multilaterale me organizatat ndërkombëtare si ERRA, MEDREG, USAID, Sekretariati i Energjisë Vjenë etj. Gjithashtu ERE ka mbajtur marrëdhënie bilaterale me institucione të tjera Rregullatore si motra, si dhe ka realizuar një pjesëmarrje aktive në konferencat dhe aktivitetet ndërkombëtare lidhur me energjinë.

2.1 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare

- ERE si anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Enteve Rregullatore të Vendeve të Europës Juglindore dhe EuroAzisë (ERRA) merr pjesë në takimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kryetarëve të ERRA-s, takimet e dy Komiteteve të përhershme të ERRA-s, atij të Liçensimit e Monitorimit dhe atij të Tarifave e Çmimeve, si dhe të Grupit të Punës mbi çështjet ligjore që zhvillohen në vendet anëtare të ERRA-s.
- ERE si anëtare e Shoqatës së Rregullatorëve të vendeve të Mesdheut (MEDREG) për energjinë elektrike, ka marrë pjesë në takimet e grupeve të punës për energjitë e rinovueshme dhe çështjet e gazit, si dhe takimet e Asamblesë së Përgjithshme të saj. Mbas takimit të fundit të Asamblesë së Përgjithshme, ERE do të organizoj takimin e radhës të Komitetit drejtues të MEDREG. Kjo është një mundësi e vlefshme në drejtim të njohjes së mundësive dhe potencialeve energjetike të Vendeve të Mesdheut dhe vendosjes së një klime mirëkuptimi dhe bashkëpunimi të rregullatorëve të këtyre vendeve për çështje të ndryshme të interesit ndërmjet tyre.
- ERE ka bashkëpunuar me USAID në projektin e përbashkët afatgjatë të përkrahur nga vetë USAID, ku janë përfshirë përfaqësuesit e rregullatorëve të rajonit dhe

kompanitë e sistemit të shpërndarjes të rajonit. Gjithashtu për vitin e ardhshëm ERE ka planifikuar zhvillimin e bashkëpunimit me Rregullatorë të Shteteve të Bashkuara si aktivitete partnershipi.

- ERE në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë gjatë vitit 2013 ka marrë pjesë aktive në Forumet e Energjisë së Athinës dhe aktivitetet e Komunitetit të Energjisë të organizuara nga Sekretariati i Vjenës. Gjithashtu ERE ka marrë pjesë aktive duke bashkëpunuar dhe në mënyrë intensive me Sekretariatit e Energjisë së Vjenës. ERE ka ndjekur në mënyrë të rregullt takimet e Grupeve të Punës për çështjet e konsumatorëve, të energjisë dhe tregut rajonal të saj, si dhe gazit natyror. Institucioni jonë ka dërguar gjithnjë informacionin dhe draft- vendimet e marra prej nesh në lidhje me legjislacionin, për mendim dhe konsultim në Sekretariatit e Energjisë Vjenë. Për realizimin e një pune sa më të mirë ERE ka zhvilluar takime të përbashkëta me Sekretariatit për sa i përket një zgjidhjeje sa më të mirë të problemit me CEZ, për realizimin e një tregu të përbashkët me Kosovën, për Rregulloren e Alokimit të Kapaciteteve .Vlen të theksohet që ERE ka marrë pjesë dhe në trajnimet dhe workshopet e organizuara nga ky Sekretariat për cilësinë e shërbimit, mbrojtjen e konsumatorit, paketën e tretë legjislative dhe modelet e tregut të energjisë dhe gazit natyror. Përfaqësuesit e Sekretariatit të Vjenës kanë qënë gjithnjë aktiv në përkrahjen e ERE-s për zgjidhjen e problemeve të hasura gjatë vitit 2013.

Institucioni jonë ka përfituar shumë nga këto aktitete dhe nga eksperiencia e rregullatorëve me të përparuar europianë, për harmonizimin e legjislacionit, praktikave dhe procedurave me qëllim krijimin e një tregu të përbashkët rajonal të energjisë, transparent, konkurrues, jo diskriminues dhe me akses të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit.

2.2 Presidencja e ECRB-s në vitin 2013

Në prill të 2013 në takimin e Bordit të Rregullatorve të Komunitetit të Energjisë Z. Shkëlqim Bozgo anëtar i Bordi të Komisionerëve të ERE-s u rizgjedh me unanimitet votash President i Bordit të Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB) për një mandat tjetër një-vjecar me të drejtë përsëritje dhe për një vit tjetër. Në cilësinë e presidentit ai drejtoi të gjitha mbledhjet që zhvilloi (ECRB) dhe kontriboi në mbarëvajtjen e punës së tij. Në dhjetor të vitit 2013 mbas dorëheqjes si anëtar i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Z.Shkëlqim Bozgo dha dorëheqjen dhe si President i ECRB-s.

2.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s

Marrëdhëniet bilaterale të ERE-s për vitin 2013 kanë pasur si synim forcimin e kapaciteteve institucionale të saj dhe vendosjen e bashkëpunimeve sa më të frytshme në dobi dhe përmirësim të sektorit të energjisë në vend. ERE ka punuar në drejtim të bashkëpunimit bilateral bazuar në marreveshjet bilaterale, ku mund të përmendim takimet të ndersjellta me qëllim shkëmbimin e eksperiencës për tarifën, legjislacionin dhe ceshtjen e tregut të përbashkët.

Për thellimin e bashkëpunimit me vendet e rajonit, ERE ka oraginzuar dhe takime me Rregullatorin Malazez për të diskutuar mbi projektet e përbashkëta dhe projektin e gazesjellësit IAP.

Po kështu është vendosur një marrëdhënie e ngushtë bashkëpunimi me Rregullatorin e Austrisë (E-Kontrol) me fushë bashkëpunimi përveç energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror. Gjatë vitit 2013 janë intensifikuar në mënyrë të mëtjshme dhe marrëdhëniet bilaterale me Rregullatorin Italian (AEEG) dhe atë Grek (RAE). Ky bashkëpunim ka bërë të mundur realizimin në kohë të vendimit final (FID) të projektit TAP dhe për vitin që vjen do të planifikohen veprimtari konkrete për të përfituar nga eksperiencia e Rregullatorit Italian në sektorin e gazit natyror dhe sektorin e shpërndarjes. ERE gjithashtu ka bashkëpunuar dhe mbajtur marrëdhënie të afërta me institucionet rregullatore të rajonit e më gjerë, ku mund të përmendim Rregullatorët e Kosovës, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të zi, Turqisë, Francës etj.

2.4 Pjesëmarrja në Konferenca dhe Aktivitete Ndërkombëtare

Gjatë vitit 2013 ERE i ka kushtuar një rëndësi të madhe përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së saj në konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare. Interesi i ERE-s ka qënë shumë i lartë për t'u njohur me eksperiencat europiane në sektorin energjistik dhe me gjerë në shkallë botërore nëpërmjet pjesëmarrjes së saj në aktivitete ndërkombëtare. Ndër aktivitetet më të rëndësishme mund të përmendim Forumet Europiane për Energjinë dhe Gazin, Konferencat Europiane dhe të Europës Juglindore për Energjitë të rinovueshme, Forumin Botëror të Rregullatorëve në Toronto, Konferencat e organizuara për çështjet e gazit në vendet e rajonit, si dhe në workshopet e organizuara mbi rolin e rregullatorëve në çështjet e energjive të rinovueshme, eficiencës së energjisë, mbrojtjes së konsumatorit dhe

sigurisë së furnizimit. Një takim i rëndësishëm ka qënë dhe pjesëmarrja e ERE-s në asamblenë e përgjithëshme të MEDREG ku u theksua forcimi i rolit të rregullatorëve në vendet e tyre respektive.

Kapitulli VI

Administrimi i Burimeve Financiare dhe Burimeve Njerëzore të ERE-s

Edhe për vitin 2013 përsa i takon fushës së Burimeve Njerëzore është zbatuar me përpikmëri Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005” Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar me ligjin nr.86/2012 date 18.09.2012 dhe Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 ”Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik” i ndryshuar me ligjin nr.85/2012 date 18.09.2012.

Janë plotësuar deklaratat e interesave private periodike/vjetore nga të 10 zyrtaret (që janë subjekt i këtij detyrimi), sipas afateve kohore të parashikuara nga ligji.

Gjithashtu kemi marrë pjesë rregullisht në trajnimet e organizuar nga ILDKP.

Në zbatim të Vendimit nr. 181, datë 05.05.2008 të Kuvendit të Shqipërisë për miratimin e strukturës dhe organikës është zbatuar me përpikmëri Ligji Nr. 9584 datë 11.07.2006, ”Për pagat shpërblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, si dhe Vendimi nr. 589, datë 17.07.2013 ”Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të këshillit të ministrave, kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit” si dhe Vendimin nr. 610, datë 24.07.2012 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 717, datë 23.06.2009 të këshillit të ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore “të ndryshuar.

Në vijim të Ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 ” Për Sektorin e Energjisë” i ndryshuar, për përzgjedhjen, emërimin dhe promovimin në detyrë të personelit është zbatuar ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 i “Statusit të nëpunësit civil”

1.Administrimi i Burimeve Financiare të ERE-s

Në fushën e administrimit dhe financës janë zbatuar me korrektësi aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse për administrimin e financave të ERE-s, përfshirë ligji nr. 9072 datë 02.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 për “ Prokurimet Publike”, i ndryshuar, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe akte te tjera ligjore.

Janë zbatuar të gjitha afatet kohore në lidhje me kryerjen e prokurimeve të fondeve publike, në përputhje me ligjin e prokurimeve.

Gjithashtu, është kryer inventarizimi i pasurisë që ERE ka në administrim. Për sa i takon fondeve monetare, ato sigurohen nga pagesat e rregullimit që ERE ka vendosur për të liçensuarit. Për vitin 2013 të ardhurat e planifikuara nga pagesat e rregullimit janë realizuar 74.45%.

Bilanci i shpenzimeve të kryera nga ERE, si pjesë e përmbushjes së detyrimit ligjor për të garantuar një punë normale të institucionit, si edhe më parë kanë konsistuar në përmbushjen e nevojave më të domosdoshme që ka pasur ERE gjatë vitit, kurse me kryesorët mund të përmendim:

Pagat e personelit, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimet mbi të ardhurat, për të cilat institucioni ynë ka shlyer të gjitha detyrimet dhe nuk është debitor.

pagesat për Konsulencë

Publikimet për informim të opinionit publik

Pagesat për shlyerjet e detyrimeve të shërbimeve si ujë, energji elektrike, telefon për të cilat institucioni ynë gjithashtu nuk është debitor, shpenzime për shërbime të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës si dhe amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara etj.

Tarifat e primit te sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike, si dhe taksat vjetore të regjistrimit të automjeteve.

Gjithashtu janë kryer procedurat e prokurimeve në kuadër të blerjeve të vogla (si pjesë e Komisionit të blerjeve Vogla) në zbatim të legjislacionit të prokurimeve elektronike për fondet publike.

Veprimtaria ekonomiko-financiare e ERE-s gjatë vitit 2013 është audituar nga një ekspert kontabël i regjistruar dhe i liçensuar për këtë aktivitet bazuar në ligjin nr. 10091, date 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”. Në vijim të këtij paragrafi paraqitet raporti përkatës i ekspertit kontabël.

PJESA IV

Kapitulli I

Raporti i Auditimit nga Eksperti Kontabël për Vitin 2013

Emertimi dhe Forma ligjore
NIPTI
Adresa e Selise

Ent Publik
K 51717024 I
Rr"Gjergj Fishta" nr.10 Tirane

Data e krijimit
Nr__i Regjistrit Tregtar

Veprimtaria kryesore

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit nr.2)

dhe Ligjit NR.9228, DATE 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

VITI 2013

Pasqyrat Financiare jane individuale	Po
Pasqyrat Financiare jane te konsoliduara	Po
Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne	lek
Pasqyrat Financiare jane te rumbullakosura ne	Jo (te plote)
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare	Nga 01.01.2013 Deri 31.12.2013
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare	03.02.2013

ENTI RREGULLATOR I ENERGJITIKES		Pasqyrat Financiare te Vitit 2013		Leke	
AKTIVET		Shenime	2013	2012	
I	AKTIVET AFATSHKURTRA				
1	Aktive monetare		16,158,613.56	13,298,319.40	
(i)	Depozita ne banke dhe llogari te tjera	512	16,158,613.56	13,298,319.40	
(ii)	Para ne dore (Arka)	531	0		
2	Derivative dhe aktive te mbajtura per tregt.				
(i)	- Derivativet				
(ii)	- Aktivete e mbajtura per tregetim		0	-	
	Totali 2				
3	Aktive te tjera financiare afatshkurtra				
(i)	Llogari/Kerkesa te arketueshme(klient)				
(ii)	Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme	482	21,516,700.00	26,584,802	
(iii)	Instrumenta te tjera borxhi tat.fitim				
(iv)	Investime te tjera financiare				
	Totali 3		21,516,700.00	26,584,802	
4	Inventari				
(i)	Lendet e para				
(ii)	Prodhim ne proces				
(iii)	Produkte te gatshme				
(iv)	Mallra per shitje	351			
(v)	Te tjera inventar		4,475,886.09	3,973,813.63	
(v)	Parapagesat per furnizime				
	Totali 4		4,475,886.09	3,973,813.63	
5	Aktivet biologjike afatshkurtra				
6	Aktivet afatshkurtra te mbajtura per shitje				
7	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra				
	Totali i Aktiveve Afatshkurtra (I)		42,151,199.65	43,856,935.03	
II	Aktivet afatgjata				
1	Investimet financiare afatgjata				
(i)	Pjesmarrje te tjera ne njesi te kontrolluara				
(ii)	Aksione dhe investime te tjera ne pjesemarrje				
(iii)	Aksione dhe letra te tjera me vlere				
(iv)	Llogari/Kerkesa te arketueshme afatgjata				
	Totali 1		17,291,244.52	20,532,103	
2	Aktive afatgjata materiale				
(i)	Toka				
(ii)	Ndertesat		8,285,115.52	9,100,218	
(iii)	Mjete Transporti		3,687,919.00	4,609,899	
(iv)	Aktive te tjera afatgjata materiale (me vl.kontab)	2182	5,318,210.00	6,821,986	
	Totali 2		17,291,244.52	20,532,103	
3	Aktivet biologjike afatgjata				
4	Aktivet afatgjata jomateriale				
(i)	Emri i mire				
(ii)	Shpenzimet e zhvillimit				-
(iii)	Aktive te tjera afatgjata jomateriale				-
	Totali 4				-
5	Kapital aksionar i papaguar				
6	Aktive te tjera afatgjata				
	TOTALI I AKTIVEVE (I + II)		59,442,444.17	64,389,038	

Pasqyrat Financiare te Vitit 2012		Leke	
PASIVET DHE KAPITALI		Shenime	
		2013	2012
I	PASIVET AFATSHKURTRA		
1	Derivativet		
(i)	- Derivativet		
(ii)	- Aktivitet e mbajtura per tregetim		
2	Huamarrjet		
(i)	Huat dhe obligacionet afatshkurtra		
(ii)	Kthimet/Ripagesat e huave afatgjata		
(iii)	Bono te konvertueshme		
	Totali 2	-	-
3	Huat dhe parapagimet		
(i)	Te pagueshme ndaj furnitoreve	404; 4671	123,550.00
(ii)	Te pagueshme ndaj punonjesve	421	2,803,524.00
(iii)	Detyrime tatimore sig.shoq	431	673,465.00
(iv)	Detyrime tatimore TAP	442,447	913,938.00
(v)	Kreditore te tjere		1,391,800.00
	Totali 3		5,906,277.00
4	Grantet dhe te ardhurat e shtyra(pag.rreg.)		21,516,700.00
5	Provizionet afatshkurtra		
	Totali i pasiveve afatshkurtra (I)		27,422,977
II	PASIVET AFATGJATA		
1	Huat afatgjata		
(i)	Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare		
(ii)	Bonot e konvertueshme		
	Totali 1		-
2	Huamarrje te tjera afatgjata		
3	Provizionet afatgjata		
4	Grantet dhe te ardhurat e shtyra		
	Totali i pasiveve afatgjata (II)		-
	TOTALI I PASIVEVE (I + II)		27,422,977
III	KAPITALI		
1	Aksionet e pakices (perdoret vetem ne pasqyrat financiare te konsoliduara)		
2	Kapitali qe i perket aksionereve te shoqerise meme (nerdoret vetem ne PF te konsoliduara)		
3	Fondi pasuror i institucionit	101	32,019,467.17
4	Primi i aksionit		
5	Njesite ose aksionet e thesarit (negative)		
6	Rezerva statusore		
7	Rezerva ligjore	106	
8	Rezerva te tjera		
9	Fitimet e pashperndara		
10	Fitimi (Humbja) e vitit financiar		
11	Totali i Kapitalit (III)		32,019,467.17
